

STAVRI PONE

NUK ISHTE VETËM ËNDËRR

Roman

Shtëpia Botuese TIRANA

Redaktor: VLADIMIR BAKO

Piktor: VEHAP KOKALARI

Libri botohet me sponsorizimin e Z. VIKTOR HYKOLLARI,
president i firmës "AGROKOMERC".

Kopirajti (c) është i autorit

Kreu hyrës

Që në fillim dua t'ju them se këto që do të lexoni nuk i ka shkruar ndonjë shkrimtar por unë, Mirton Lumani, gjimnazist i vitit të katërt. T'ju them të drejtën, kur fillova të shkruaja këto faqe, nuk më shkonte në mendje se një ditë do të mund të botoheshin. Se i shkrova për vete, pak a shumë në formë ditari. Jo si ditar i mirëfilltë, sepse në to mungojnë datat dhe kronologjitë, për të cilat nuk e kam çarë kokën. Mua më ka interesuar thelbi i

ngjarjeve, jo syprina e dukurive.

Në këto faqe do të gjeni gjithçka që kam jetuar, përjetuar e medituuar gjatë asaj kohe të trazuar, kur po fillonte një epokë e re pas diktaturës së gjatë.

1

Këto shënime kam filluar t'i mbaj aty nga mesi i semestrit të dytë, në prag të dorëzimit të kërkesave për degët që do të ndiqnim pas gjimnazit, pikërisht atë ditë prilli kur mora 4 në fizikë. Javën e kaluar kishim bërë një detyrë me shkrim dhe kishte të ngjarë që edhe atje të kisha marrë 4. Sa për të akoma s'dija gjë, po për katrën e sotme ç'teatër bëri mësuese Mariana, mor i dashur! U hidhërua shumë, medemek, gjë që e vinte në dukje duke bërë ecejake nëpër laborator e duke thyer copëra shkumësi. Përpara se të më thoshte të ulesha më porositi të qëndroja pas orës së fundit se donte të bisedonte me mua.

Në laborator unë gjithmonë zë vend pranë dritares. Në të djathtën time zakonisht rri Elona Bitri, ajo bukuroshja me sytë bojë kafe, gjithnjë të habitur, me flokët të dendur e të çelur e me atë trup të mbushur, të freskët e të lakueshëm si një hardhi e njomë. Apo s'të ka dhe një gjoks të bukur; ai kanalthi i bardhëremë i gjirit të lë pa mend, për besë, kur i hapet paksa bluza tek shkruan. Pa le kofshët, o zot! Me një formë që të trullosin.

Sa herë ndodhem ngushtë në mësim - me një fjalë kur veshët i ndiej të përcëlluar, si fjala vjen sot - unë i hedh sytë nga Elona. Më sakt nga gjoksi i saj, me shpresë se mos e shoh ndopak të zbuluar, por edhe nga kofshët. Kur ia shoh të zbuluara nuk i rezistoj dot ngasjes për t'ia prekur me dorë, si padashur. Ajo, po qe se është e sigurt se nuk na sheh njeri, nuk lëviz. Ama pak të dyshojë ma heq dorën, gjithnjë e skuqur në fytyrë.

Edhe tani, me t'u ulur në vend, pas rrebeshit që kisha pasur me mësuese Marianën, si pa dashje i vura dorën mbi gjurin e bardhë. Nuk lëviz, por kur nisa ta rrëshqitja paksa më lart, gjithnjë nën kindin e fundit, ma hoqi dorën butë, duke më hedhur edhe një vështrim qortues. U ngërdhesha lehtë, me atë mimikën që ma njihte mirë. Ajo vuri buzën në gaz.

Aleko Boçka, i ulur pas meje, diçka më thoshte me pëshpëritje. Ishte një nga djemtë që më pëlqenin më shumë në klasë. Ktheva kokën

dhe e pyeta ç'kishte. Pse ke ardhur fishek, më tha. Mund të të kisha ndihmuar. Dhe më shikonte me keqardhje. Me shumë keqardhje. Prapa atyre lenteve të trasha të syzave. Me ata sy të zinj, që i shkëlqenin nga zgjuarsia. Qe nxënësi më i mirë i klasës, terribël. Jo vetëm i klasës, po mbase i tërë shkollës. Sikur e thithte me syza mësimin. Syzat i kishte të shëmtuara sa s'bëhet, e mua prapë më pëlqente ajo fytyra e tij e ligur, e përvuajtur, gjithë mirësi. Vdiste të shoqërohej me mua. Nuk ia prishja, ndonëse nuk kisha atë shokun më të ngushtë. Se ç'i pëlqente të kishte shok një kobure si unë, s'e merrja vesh. Se unë jam arapçi e i rrëmbyer, që shpesh, për gjëra mjaft serioze ia këpus aq kot sa të gjithë i lë pa mend. Nejse, me tipin tim do të njiheni më vonë, tani e kam fjalën tek Alekoja. Qe shpirtmirë dhe vuante kur unë e djallosja në mësim. Edhe për të tjerët i vinte keq, po më shumë për mua.

Duke pëshpëritur e uli kokën më shumë. Pikërisht atë çast i pashë një kryq në qafë, në fillim gjysmëm epastaj të tërin. Ishte një kryq i verdhë, që i kishte dalë mbi jakën e trikos golf të rrjepur si mos më keq.

Mbeta pa mend nga habia. M'u bë se mbante në qafë jo një kryq, por një minë. Ai duket e kuptoi pse po e shikoja me ngulm, sepse vuri dorën shpejt te kryqi dhe e futi nën triko.

- Rrotë! - i pëshpërtia. - Hiqe fare, zhduke! Ke luajtur mendsh?

- Qetësi ju atje! - na tërhoqi vëmendjen mësuese Mariana.

U ktheva nga aparaturat, që zinin mesin e laboratorit, po nuk vonoi shumë e u ktheva prapë nga Alekoja.

- E hoqe?

Më bëri shënjë të kthehesha përpara. Mësuesja i dha fund me pyetjet e nxënësve dhe nisi shpjegimin. Nuk kishte mësuese më të mirë se ajo për të shpjeguar - po qe se e kishte mendjen në mësim, ai sikur të futej vetë në kokë. Edhe eksperimente bënte, me aq sa ishte e mundur, se laboratorin e kishim të varfër. Edhe tani nisi nga eksperimentet. Mori disa thjerrëza e gypa, ndezi dy llampushka dhe filloi të demonstronte se si përthyeshin rrezet e dritës, ç'kënde formonin e kështu. Mua, megjithatë, mendja më fluturoi. Fillova të mendoj për Elona Bitrin, që e kisha në krah. Tamam-tamam jo pikërisht për të, po për Bledar Guxhollin, bukuroshin e klasës, me të cilin ajo kishte filluar të shoqërohej ca si shumë kohët e fundit. Me atë farë tipi që mbahej më të madh. Sepse gjithnjë përpigëj të nxirrte veten në pah e të krekosej. Tip që të ngrinte

zorrët përpjetë, të thuash të drejtën.

Ai ishte ulur në krahun tjetër të Elonës dhe se ç'i tregonte poshtë bankës. Qe po ajo revistë që na kishte treguar mua e Agron Dervishit ca ditë më parë, një revistë e huaj me ilustrime, femra e pamje të bukura. Kishin shkuar prapa shkollës për ta parë, në atë rripin e ngushtë midis saj dhe murit të lartë që e ndante nga rruga, një hapësirë e pistë, gjithë hedhurina e nevojra të thata e të freskëta, po ku rriteshin e harliseshin pa pyetur fare për pisllekun bimë të egra si dhe një fik, më krenari midis tyre. Ja, atje e kishim parë atë revistë. Me ato pamje që zor se i merrje për të vërteta e që të bënë të çmendeshe pikërisht pse qenë të vërteta.

Ja, kjo m'u kujtua kur pashë Elonën tepër të përqendruar në ato çka po i tregonte Bledari. Sesi ktheva kokën pas kur vura re se edhe Ilir Karaj, një tip edhe më i padurueshëm se Bledari, kishte zgjatur kokën për të parë. Me ç'dukej nuk po mund të pikaste gjë, se në fytyrë i kishte rënë hija e një mërzie të thellë. Megjithatë nuk hoqi dorë, u zgjat edhe më shumë por Bledari, që ishte ulur përpara tij, e pa dhe e shtyu me inat.

Iliri u tërhoq duke u ngërdheshur, por dukej sheshit se qe bërë spec. Gjithnjë i dukej se askush nuk e përfillte. Në laborator vazhdonte të kumbonte zëri plot intonacione i mësueses:

- ... Sa më konvekse të jetë një thjerrëz rrezet e dritës... - Befas toni i të folurit të saj ndërroi krejt: - Ç'bëni ju aty?!

Ndërkohë nxitoi drejt bankës së Bledarit. Ky u mundua ta fshihte revistën, por ishte vonë, në pak sekonda ajo ishte në duart e mësueses.

- Shumë keq! Guxholli, më vjen shumë keq që pikërisht ti... - Ajo e kishte pikë të dobët Bledarin dhe përpiquej t'ia kursente qortimet, duke luftuar me nervozizmin që përgjithësisht e kishte mjaft shpërthyes. - Në vend që ta kesh mendjen në mësim na shikon të tilla bukurira - këtë fjalë e theksoi si me tallje - borgjezësh... Shumë keq!

Ajo shfletoi dy a tri faqe; ndërkohë ne shikonim faqen e fundit, ku një vajzë e bukur me minifund kishte ngritur një rën këmbë për të hyrë në një veturë. Mariana e përplasi revistën me zhurmë në tryezën e saj pa i ndërprerë fjalët:

- Ju e dini që revista të tilla janë kategorikisht të ndaluara. Ju këshilloj të mos luani me zjarrin...

- Shumë e drejtë, zysh, - u dëgjua zëri i hollë i Ilir Karajit

që buçiti si bori e çjerrë. - Paçavure të tilla borgjeze-revizioniste...

U kthyem nga ai. Iliri me ç'dukej do të vazhdonte, po mësuesja e ndërpreu:

- E qartë, - tha ajo. - Por tani nuk do të bëjmë mbledhje, këtë mund ta shikoni në organizatën e rinisë.

Kur ra zilja morëm frymë të lehtësuar. Mariana thirri Bledarin dhe vazhdoi qortimet. Ai dëgjonte kokulur, gjoja i penduar, por në fakt shtirej. Në fund ajo ia ktheu revistën. Me të dalë nga laboratori një tufë djemsh e vajzash të klasës iu sulën Bledarit duke iu lutur t'i hidhnin një sy.

- Bah, jeni në vete?! - bërtiste Blerdari me revistën pas shpine. - Në asnjë mënyrë!

Dhe krekosej sikur kushedi ç'kishte në dorë. Me siguri ato çaste e pandehte veten për hero.

Edhe kur hymë në klasë zallamahia nuk pushoi. Disa diskutonin nëse duhej t'i shikonim revista të tilla apo jo. Më të shumtët thoshin se s'kishte asgjë të keqe po qe se revista s'kishte teprime, pra po qe se s'kishte asgjë pornografike, kurse një pjesë lëkundeshin. Miranda Kolluri, sekretarja e Rinisë, filloi të na moralizonte se patjetër nuk duheshin parë, pasi në çdo revistë të huaj kishte teprime. A s'ishin teprime reklamat, veturat, vilat, plazhet luksoze, mallrat ushqimore të paketuara aq bukur, videot, magnetofonët e të tjera si këto? Ato mund t'i siguronin vetëm një pakicë, të pasurit, kurse pjesa dërrmuese e popullsisë, të varfrit, as që mund t'i ëndërronin. I shkela syrin Alekos. Ma ktheu me buzëqeshje duke tundur dorën në formë rrethi: le të grijë... Ç'të bëjmë?

Pas Mirandës, që gjithnjë fliste sikur hante shirita magnetofoni - siç shprehej një shoku im për këta tipa, Ardit Cani - filloi të grinte Agron Dervishi, ky ngadalë e shtruar, tamam si filozof:

- Ç'e duan të varfit luksin? - ia këputi ai dhe unë e Aleko Boçka prapë u pamë sy më sy. - Ç'i duhet proletarit vetura apo vila, ka para të shpenzojë për to? Ai është i lumtur me një jetë të thjeshtë, po qe se e ka siguruar dhe atë...

- I ziu ai! - tha Alekoja dhe ne ia dhamë të qeshurit. Agroni u turbullua, shikonte hutueshëm sa njërin, tjetrin. - Sikur të vinte të jetonte këtu... - Vazhdoi Alekoja, po mua m'u shkëput vëmendja se atë kohë hyri me nxitim Elona, që u ul në bangën time, e para nga muri. U çudita, se pak më parë, në laborator, ishte ulur me

Bledarin, siç bënte shpesh kohët e fundit. Semestrin e parë po, gjithnjë rrinim bashkë. E pashë me bisht të syrit, dukej e bardhë si mermeri.

- Po ti ç'i shkon pas avazit? - i thashë për Bledarin. - Ngatërrohesh kot.

- Po vetëm sa i hodha një sy... Semos kushedi ç'qe.

- Mirë, po si kujtojnë të tjerët, se! Elona, me ato gjëra...

Jo, s'mund t'ia kujtoja, s'duhej t'ia kujtoja një ngjarje tjetër lidhur me Bledarin dy a tri javë të shkuara. Kishim pasur pushim në kimi atë orë dhe të gjithë ndodheshin në oborr. Unë isha futur në klasë për të marrë diçka në çantë, bukën, më duket, dhe kur hyj brenda Bledari dhe ajo rrinin të ulur në bankën e dytë, duke parë të përqendruar diçka. Shkova te banka ime dhe padashur sytë më shkuan tek ajo që i kishte gozhduar të dy. Qe një një kalendar i huaj me piktura. Bledari më ftoi vetë t'i hidhja një sy kalendarit, po unë pashë vetëm faqen që po shikonin ata.

Ishte një pikturë e Dalisë. Një fragment shkretëtire, një tryezë me dy gota e dy pjata bosh në plan të parë dhe tej, në largësi, dy kalorës duke u larguar, ata që me siguri kishin qenë ulur në atë tryezë luksoze, ku qelqi si kristal dhe porcelani farfuritës vetëtinin trishtueshëm. Në plan të mesëm një zezak i ri, kockë e lëkurë, ishte ulur në gjunjë me duart a drejt kalorësve, a drejt qiellit, si duke u lutur. Pikturë e hatashme, për besë, që të prekte deri në lot. Kishte aq vërtetësi në të, aq dritë dhe shkëlqim, po edhe një brengë aq të thellë sa të çmendte. E kisha kundruar vetëm për pak sekonda, por duket edhe aq kishte qenë e mjaftueshme për të më shkaktuar atë përshtypje. Ndofta s'do të qe dashur më shumë kohë.

Krenaria s'më kishte lejuar të shikoja edhe faqet e tjera. Le që isha treguar dhe hipokrit, se duke dalë u thashë, "Ç'janë këto kotësira!" Ja, kjo ngjarje m'u kujtua tek pashë Elonën të ulur krah meje. Pra s'ishte hera e parë që Bledari i tregonte revista të huaja e dreqi e di ç'tjetër. Sa për vete as që çaja kokën se më prishej morali, nuk e besoja fare një gjë të tillë, por nuk doja që Elona të ngatërrohej me këto gjëra. Një revistë, pikturë, kartolinë e madje edhe një letër e ardhur nga jashtë, ishin bomba me sahat, sikurse edhe kryqi që Alekoja mbante në qafë. Unë mund t'i shikoja natë e ditë gjëra të tilla, edhe kryq kisha qejf të mbaja, veç të isha i bindur që s'kisha pranë asnjë dëshmitar. Punë dreqi me mua, me të tjerët tregohesha i rreptë, madje mund t'iu bëja edhe moral

kundër bindjes sime të thellë, kurse vetes, po të ndodhte të bija në kontakt me gjëra të tilla, nuk i bëja kurrfarë qortimi apo morali. Thjesht kënaqesha pa e çarë kokën. Thua të ishte dyfaqësi kjo? Apo dyzim personaliteti, siç kisha dëgjuar një herë dajën t'i thoshte një shokut të tij në vesh tek shkoja njëherë me ta në plazh? Dreqi e di ç'ishte, dija që hollë-hollë është e tmerrshme t'i bësh moral një shoku. Në fund të fundit e ke treguar veten se ç'është di, kurse s'di asgjë. Pra je një ekzibicionist i rafinuar, tinëzar, shumë më i poshtër se ai i hapuri, që të paktën nuk fshihet. Vërtet është punë dreqi t'i bësh shokut moral. Edhe pse një gjë e tillë është normë, madje nder. O Zot, të mendosh thellë se ç'gjëra nderohen të vjen të çmendesh.

2

Mësuesi i astronomisë, Seferi, ende s'po vinte dhe në klasë vazhdonte zhurma. Elona, krejt e heshtur, nxori librin. U mata ta nxirrja edhe unë, por dora më mbeti në ajër. Sepse pikërisht atë çast, bashkë me Seferin, mësuesin e astronomisë, hyri në klasë edhe Arshi Krodhja, mësues i punës me dru dhe sekretar i organizatës-bazë të Partisë. Dhëmbë-kalë, buzë-lëkurë, hundë-gogozhare, flokë-irriq. Nën vetullat si të sajuara me qime derri zinin vend një palë syza me skelet metalik, me xhamat të trasha një gisht. Përmes këtyre thjerrëzave rrezet e dritës përthyeshin në disa kënde. Mirëpo drita jo sikur hynte në sytë e tij, siç është ligji i natyrës, po sikur dilte, e acartë dhe përvëluese. Sa për mësues Seferin s'kisha ç'thoshja, qe normal nga të gjitha anët, vetëm që vinte ca si i fjetur. Nuk kishte faj, qe në prag të pensionit.

Mirëpo tani që hyri në klasë i shoqëruar nga Arshiu m'u duk krejt ndryshe nga herët e tjera, i prishur në fytyrë, madje i llahtaritur. Me siguri diçka jo e mirë do të kishte ndodhur, përderisa vinin të dy.

Ne ende s'ishim ulur kur mësues Seferi, me regjistrin në dorë, tha duke iu marrë goja:

- Para se të fillojmë m-mësimin... sh-shoku Arshi ka për t'ju thënë diçka...

- Kush është Aleko Boçka? - pyeti Arshiu duke na rrezatuar të gjithëve nga njëri cep i klasës në tjetrin e duke u ngritur paksa

në majat e këmbëve. Ishte i vetmi mësues që nuk i mbante mend fare emrat e nxënësve.

Për disa çaste në klasë nuk pipëtiu as miza. Krejt instinktivisht ktheva kokën nga Alekoja. Ishte bërë limon në fytyrë.

- Unë, - mezi belbëzoi Alekoja.

- Ëhë, - ia bëri Arshiu dhe shtoi: - Eja këtu.

Alekoja, i mpirë, doli përpara klasës. Kokën e mbante nga dera. Unë, që e kisha afër, e shikoja mirë sesi i dridheshin gjunjët.

- Kthehu këtej! - e urdhëroi Arshiu. - Dhe duke zgjatur dorën drejt tij, vazhdoi: - Më jep atë që ke në qafë.

Sikur më ra tavani në kokë! E kishte fjalën për kryqin. Si kisha harruar t'ia kujtoja Alekos prapë për ta hequr? O Zot, u luta me vete, ishalla e ka hequr! Që Arshiu të mbetej me gisht në gojë.

- Çfarë? - mezi belbëzoi Alekoja.

- Atë që ke në qafë, nuk dëgjove?! - Në fytyrën thatime të Arshiut lodronte një farë ankthi, si ai i gjahtarit kur matet të vrasë një rosë. - Hajde, ma jep!

Krejt pa dashur Alekoja vuri dorën te qafa. Fytyra, nga e zbehtë pak çaste më parë, iu bë e rubintë.

- S'kam gjë, - u përpoq të mos e jepte veten.

- Po, mirë, e shohim... - tha Arshiu dhe, i shpejtë si skifter, me një rëndësi të madhe e kapi nga krahu kurse tjetrën ia futi rrufeshëm mu brenda golfit të rrjepur, ku nisi ta lëvizte me shkathtësi, thua se po e therte. Alekoja rrinte si i ngrirë, tamam si një zog spurdhjak i hipnotizuar nga gjarpri, që kisha parë një herë në televizor. Brenda pak sekondash Arshiu ia hoqi dorën nga qafa; në të pamë të vetëtinte kryqi i verdhë bashkë me zinxhirin e këputur. Arshiu as që ishte kujdesur që të paktën ta zbërthente. Klasën e përshkoi një mërmërimë.

- Ç'është kjo?

Alekoja uli kokën.

- S'dashke të flasësh? Ju të tjerët e shikoni?

I varur në dorën e ngritur kryqi lëkundej lehtë duke vetëtitur. Gjithë klasa shikonte me sy të mpitë, të zgurdulluar.

- Hë pra, flisni! - u nxeh Arshiu. - Apo s'keni sy?

- Kryq është, - u hodh Bledari. - E shohim.

- Bukur, kryq është. Po a lejohet ta mbajnë në qafë njerëzit tanë? Aq më tepër nxënësit? Një shoku juaj? Ç'mendim ke ti? - iu drejtua Bledarit.

- Gabim ka bërë, - tha Bledari me një farë indiference.

- Vetëm kaq?

- Ç'të them tjetër? S'duhet mbajtur, dihet ajo.

- Sigurisht! - u nxeh Arshiu. - Por duhet ta argumentoni pse. Hajde, flisni ju të tjerët! - e ngriti zërin edhe më shumë.

U ngritën e folën disa, që po ato fjalë përsëritën, pa argumentuar asgjë, siç donte Arshiu. Flisnin pa u ngritur nga vendi, si nëpër dhëmbë, më shumë të trembur, sesa ngaqë i ndienin ato që thoshnin. Pastaj, krejt papritur, u krijua një pauzë e rëndë, e shkaktuar nga errësimi i shikimit të Arshiut, që sa vinte e shtoej.

Gjithçka mbeti amull deri kur po krejt papritur ngrihet Ilir Karaj që nisi ta turrte gjatë e gjerë. Siç e kishte zakon ia nisi me atë tonin e tij që të ngrinte nervat duke thënë se veprimi i Alekos ishte skandaloz, në kundërshtim me mësimet e Partisë, një veprim që sfidonte edukatën marksiste-leniniste që merrnim në shkollë dhe që e bënte pluhur e hi zbulimin se feja është opium për popullin dhe se ideologjia fetare është reaksionare, regresive e plot nga këto.

Arshiu e dëgjonte i kënaqur, duke pohuar me kokë. Më në fund Ilir Karaj u ul duke fshirë buzët me mëngë. Gjithnjë i jargavitëshin drejt, kur fliste gjatë.

Kujtuam se Arshiu do t'i jepte fund asaj meseleje kur, për tmerrin tonë, ai ia nisi edhe vetë një ligjërate të gjatë e të mërzitshme, pa thënë asgjë më shumë nga Ilir Karaj, vetëm se ndryshe nga ai, i mbiu në gojë "Partia kështu, shoku Enver ashtu". Na çmendi duke dërdëllitur sesi ky gjeni kishte arritur të shpartallonte fenë dhe dogmat fetare, gjë që s'kishte ndodhur në asnjë vend tjetër të botës. S'do të jetë e largët koha, përfundoi ai, kur edhe vendet e tjera do të ndiqnin shembullin tonë për ta zhdukur një herë e mirë murtajën fetare nga planeti.

Duke e mbajtur frymën pezull, siç duket për të thënë ndonjë fjalë të fundit, u kthye krejt papritur nga mësuesi i astronomisë:

- Edhe ju, shoku mësues, duhet të punoni më shumë për edukimin ateist të nxënësve. Ideologjia e partisë ka më rëndësi se shkenca për yjet dhe për qiellin, madje, pa atë ideologji, ajo nuk vlen.

Seferit i erdhi e papritur, u skuq e u zverdh e mezi belbëzoi:

- Po, e drejtë! Ne jo se... Unë gjithnjë e kam pasur parasysh që mësimet e Partisë... ndonëse është e vështirë t'i zbatosh në çdo mësim...

- Në çdo mësim, shoku Sefer! - foli rreptë Arshiu. - Vija e Partisë duhet t'i përshkojë të gjitha shkencat si pe i kuq. Se është alarmante kur një nxënës...

- Po, po, sigurisht...

- Prit! - u ckërmit Arshiu. - Se kur së pari ju, mësuesit e shkencave të natyrës, nuk jeni të aftë të argumentoni se ligjet e Galileut, të Keplerit, Njutonit... mbështeten vetëm në idelologjinë marksiste-leniniste, vajhalli për nxënësit! Qartë?

- Po, po, patjetër, - bërbëliti Seferi duke vërtitur regjistrin nëpër duar.

- Kështu. Pra, të dashur nxënës, po i japim fund këtij diskutimi të pakëndshëm por tepër të vyer. - Dhe ti, - iu drejtua Alekos, nesër do të sjellësh prindërit. Këtë, - tha për kryqin, - do t'ua dorëzoj atyre. - Këtu bëri një pauzë të shkurtër, e duke na u drejtuar të gjithëve, shtoi: -

- Pavarësisht nga ky diskutim, ju si organizatë rinie do ta diskutoni më thellë këtë problem dhe do të mbani qëndrim. Qartë, Miranda?

Miranda Kolluri, sekretarja, u çua nga vendi si me sustë. Ishte edhe anëtare e byrosë së rinisë së shkollës. Fytyrë-puçrranjoze, flokë mustaqe-misri lidhur bisht kali, sy-hirrë, gjoks-petë, ajo gjithnjë më ngjallte krupën.

- Si urdhëron, shoku Arshi! Që sot.

- Në rregull, - tha Arshiu, dhe pa shtuar gjë, hapi derën dhe doli. Alekoja ende vazhdonte të rrinte në këmbë. Kur dera u mbyll, klasa zuri të gumëzhinte. Seferi mezi u përmend, uli Alekon në vend, por nuk i bëhej të fillonte mësimin, aq i turbulluar qe. Krejt automatikisht këmbëu disa replika me dy a tri prej nesh, u ul në tryezë e zuri të merrej me regjistrin.

Gjithë ç'ishin përçark zunë ta bombardonin Alekon me pyetje: Jo po ç'e kishte vënë atë kryq, a e dinin të shtëpisë e kështu me radhë, deri kur Gentiana Harizi, ylli i klasës e mbase dhe i shkollës, i bëri atë pyetjen më të sikletshme, atë që të gjithë e kishim mbajtur të struktur në nënvetëdije pa e nxjerrë në sipërfaqe e për ta artikuluar me fjalët: kush ia kishte parë atë kryq dhe i kishte treguar Arshiut?

- Ku ta di unë? - ngriti supet Alekoja.

- Dëgjoni, - foli kërcënueshëm Aladin Dulja, - o të tregojë vetë ai që e ka spiunuar Alekon, ose përndryshe, po e zbulova unë, kam për t'ia thyer brinjët!

Aladini ishte gjiganti i shkollës, 1,95 i gjatë, me shpatullat sa të demit, gallof, i ngathët, por me muskujt që i dilnin nën lëkurë si toptha sustash. Për një farë kohe ishte marrë me peshëngritje. Në mësim ishte tapë, me një fjalë si të mos i hapte librat, si të rrinte dhjetë orë mbi to, në kokë asgjë nuk i hynte. Pesat i merrte nga që mësuesit e kishin frikë. Më kishin treguar se vitin e kaluar kishte ngritur peshë, me një dorë, mësuesin anglishtes. Megjithatë nuk qe i keq, dreqi, vetëm se krejt avdall. Sidoqoftë një gjë ishte e vërtetë: po të ta vinte syrin se do të të zhdëpte, drurin kishe për ta ngrënë se s'bën.

Hodha sytë instinktivisht nga Ilir Karaj, se ai s'ia përtonte për çfarëdolloj spiunllëku, po nga fytyra e tij si e lyer me dyllë nuk pikasa gjë. Mbase dhe nuk kishte qenë ai spiuni.

- Fillojmë, - u shkund mësues Seferi. - Yjet xhuxhë, yjet e bardhë dhe yjet e dyfishtë...

- Dëgjuat? - buçiti prapë zëri i Aladinit. - Nëqoftëse tregon vetë ka rrethana lehtësuese...

- Ç'ke, Aladin? -iu drejtua me të butë Seferi.

- Po ja, presor, - iu përgjigj Aladini duke u ngritur këmbë, i madh si ari. - Po ju them të gjithëve, - rrotulloi kokën rreth e përçark klasës, - se po nuk tregoi vetë ai që ka spiunuar Alekon, unë do t'ia marr shpirtin! Mund të vazhdoni, presor.

Seferi vazhdoi të fliste për yjet, por askush nuk dëgjonte.

- Pushoni! - u dëgjua zëri i Mirandës, e cila me siguri kujtonte se si sekretare e Rinisë që ishte, vinte fill pas mësuesit nga autoriteti.

- Mbylle, moj zërrhale! - ia ktheu Aladini. - Apo e ke mizën ti!

Miranda i dha kokës përpjetë me mospërfillje. Babanë e kishte sekretar të parë të një rajoni, gjë me të cilën dhe mburrej haptazi. Kur e dëgjonin shumë veta, sidomos, ia niste: "Babi më gjeti biletë për aksh koncert, dje ishim te shoku filan (anëtar i Byrosë Politike...) nesër do të shkojmë në Berat të hamë drekë" e plot llogje si këto. Të ngrinte zorrët kur fliste për të atin, po kur ia niste për Partinë, vend e pa vend, për të mirat që i kishte sjellë popullit, të vinte ta ngjishje pas murit.

Më në fund qetësia u vendos dhe mësues Seferi vazhdoi. U ktheva nga Alekoja dhe i buzëqesha. Pashë se i dridhej mjekra, kurse një bisk floku nga krrela e zezë ballore i ishte ngjitur mbi vetullën e majtë. Ndofta nga lotët, se i hiqte syzat dhe i fshinte herë pas

here.

U ktheva përpara duke menduar për të. Do ta kishte vënë vallë atë kryq të uruar (kryqin nuk guxoj kurrë ta shaj) ta kishte ditur në ç'telashe do të futej? Apo, po të mos e kishte vënë, do t'i kishte ndodhur ndonjë fatkeqësi edhe më e madhe?

As orën e fundit, që kishim anglisht, nuk u përqendrova dot në mësim. Dihet, kur merr katër apo je dëshmitar i ndonjë ngjarjeje të papëlqyer, nuk të bëhet. Kështu më ndodhte edhe në gjimnazin tjetër, ku mësoja më parë. Se, që ta dini tamam, në këtë gjimnaz kam ardhur në fillim të këtij viti shkollor. Në gjimnazin tjetër fillova të bija në matematikë e fizikë, dhe babai më solli këtu. Nga që në këtë shkollë, me demek, niveli i mësimit është më i lartë. Kurse unë nuk i gjej ndonjë ndryshim nga ajo ku isha më parë; le nxënësit, po as mësuesit nuk janë aspak më të mirë. Gjithë puna është, them unë, te reklama: kësaj shkolle i është bëri ca si shumë reklamë.

Po s'është vetëm puna tek emri i shkollës që babai më solli këtu. Hollë-hollë ai s'pyet shumë nëse një shkollë ka nam të mirë apo jo. Mor le të ketë shkolla edhe namin më të keq, për babanë ka rëndësi që diplomën - punë e madhe se mban vulën e asaj shkolle - ta kem me nota sa më të mira.

Kur ra zilja e orës së fundit ndoqa Alekon me sy dhe nxitova ta arrija. Korridorin, si gjithnjë, që i errët, pasi edhe poçat e llampave, edhe çelësat, janë të thyer. Nëpër anët shikon grumbuj plehrash. Në murin e djathtë, ngjitur me të cilin ecja, pashë një njollë në formë konike që zbrite deri poshtë. Me siguri dikush kishte urinuar përpara se të binte zilja. Punë dreqi, korridor më të pistë se të kësaj shkolle s'më kishin zënë sytë. Pa le të hyje në WC, të zinte lemeria, duhej kundragazi që të mbaroje punë.

E arrita Alekon dhe nisa të zbrisja shkallët në një hap me të. Ai ende s'e kishte marrë veten nga tronditja.

- Dëgjo, - e pyeta, - kush thua se mund të të ketë spiunuar?

Më hodhi një vështrim të topitur përmes xhamave të syzave, që sikur ia zgjeronin dimensionin e pikëllimit. Psherëtiu dhe vetëm ngriti supet.

- Veç meje kush ta pa kryqin?

U mendua një grimë.

- Po Elona, Gentiana... Edhe Bledari.

- Bledari?

- Po. Po as tek ai nuk dyshoj.

- Po Ilir Karaj ose Miranda? Thua e ka parë ndonjë prej tyre?

- Nuk e di. Prit... Iliri e pa pardje, kur kishim fizkulturë.

M'u përfytyrua Alekoja i zhveshur për fizkulturë: trupvogël, kockanjar, tip karkaleci me syza. Dhe me atë shprehjen e përjetshme të pikëllimit ngaqë nuk arrinte dot asnjë normë. Një herë, tek përpigjej të kapërcente kaluçin e vogël, mbeti i ulur në cepin e tij si t'i ishin ngjitur bythët, pa guxuar të zbriste.

Alekoja. Terribël në të gjitha lëndët, përveç në fizkulturë. Portret i admirueshëm dhe i dhimbshëm.

- Aleko, - e pyeta - ku e gjete atë kryq?

Më hodhi një vështrim edhe më të pikëlluar.

- Ishte i mamasë. E kishte mbajtur kur ishte e re, se atë kohë lejohej. Ç'është e vërteta... ajo nuk donte, po mua më hipi: do ta vë. Ajo u alarmua, kishte frikë. Unë e sigurova se askush nuk do të ma shikonte. Kur pa që s'dëgjoja ta hiqja, më puthi dhe më tha: "Të dhëntë fat!" - Më pa në sy e rrudhi buzët. - Po nuk më dha...

Diçka i vetëtiu në sy dhe ktheu kokën mënjanë. I vinte zor. Morali i rrënjosur ushtronte trysninë e tij të tmerrshme. Sidomos ndaj njerëzve si unë, që jam me "biografi të mirë". I dukej se edhe unë, thellë në veten time, do ta përçmoja po të merrja vesh se besonte, apo që respektonte fenë. Me mua, sidomos, u ruhej bisedave politike. I ati kishte bërë dhjetë vjet burg për agjitacion e propagandë. E kishin futur kur Alekoja ishte gjashtë vjeç dhe kishte dalë para dy vjetësh. Kishte qenë përgjegjës i vatrës së kulturës në një fshat, shkruante artikuj për kulturën në gazetën lokale por edhe drama e skeçe. Dënimin e kishte bërë në Spaç, një burg që thoshin se ishte i llahtarshëm.

Pak gjëra më kishte treguar për të atin, po edhe unë s'e pyesja. Më dukej se do ta lëndoja. Tani punonte bojaxhi në komunalen e një lagjeje.

- Ti e dije që të mbash kryq është me zarar - e qortova. - Pse s'pate kujdes?

- Eh, iku ajo. Më mirë të mos e kisha vënë fare.

- E vure se beson, apo kot?

- Është diçka e koklavitur... Nganjëherë më duket se besoj, nganjëherë jo.

Oborri i shkollës thujse ishte i zbrazët. E përçolla deri te porta, unë gati për t'u kthyer në laborator, ku më priste mësuese Mariana (sa bezdi e kisha takimin me të!) kurse ai i lirë për të shkuar në shtëpi. Megjithatë sikur s'i bëhej të ikte, si të priste

diçka përfundimisht ngushëlluese nga unë. Ç't'i thosha?

Gjelbërimi i harlisur i pemëve në anën e djathtë të oborrit, karshi fushës së basketbollit, i bënte sfidë murit gjysmë të shkatërruar me tulla, gjithë myk e ndyrësira rrëzë tij. Gjelbërim kokëfortë, shpresëdhënës. Në qiellin e ngushtë midis ndërtesave të vjetra, edhe kaltërsia e thellë refraktare dukej kokëfortë dhe sfiduese, edhe pse e kërcënuar nga tufa të mëdha resh si prej lesh xhami, ngjyrë argjendi të lëbyrur. Për një grimë ndjeva dhimbje tek pashë atë kaltërsi të kërcënuar.

3

Alekoja iku. Duke ecur drejt shkollës një vajzë, që s'e njihja, më thirri nga një dritare e katit të dytë dhe më tha se më kërkonte zysh Lumturia, mësuesja e marksizmit. U habita, e pyeta mos e kishte gabim, por ajo nguli këmbë.

U nisa me nxitim për në laboratorin e fizikës për t'i thënë mësuese Marianës nëse mund të më priste pak, se më kërkonte edhe mësuese Lumturia.

Shkallët i ngjitja dy e nga dy. Në katin e tretë, ku është laboratorin e fizikës, bëri ballë Agroni Dervishi, shoku im më i ngushtë. Dukej në ankth, si t'ia kishte fshikur fytyrën hija e një misterit. Kur ngjita shkallaren e fundit më tërhoqi anash parmakut, gjithnjë pa m'i ndarë sytë.

- Ç'është? - e pyeta.

- Dëgjo... - Vështroi një herë rrotull e pastaj, si t'i nxirrte fjalët me ngërç, vazhdoi:

- Di gjë ti?

- Për çfarë?

- Për... për... Vërtet nuk di gjë?

- Për çfarë, pra?

E hetova në fytyrë, dukej si të kishte dalë nga ndonjë varr. Errësira e korridorit të gjatë, që i ngjante një tuneli makabër, me ndriçimin e dobët të dritares pa xhama mu në fund të tij, sikur ia shtonte edhe më shumë atë zbehtësi vdekjeje që i kishte rënë në fytyrë. Që kurse e njihja - qysh nga ditët e para të shtatorit, kur me t'u njohur qemë bërë miq - nuk e kisha parë kurrë në atë gjendje. Përgjithësisht nuk ishte tip gazmor, po kjo zyrtësi që i kishte rënë të ngjallte një farë frike. Zakonisht fliste pak dhe

arsyetonte në mënyrë praktike, pa guxuar të bënte ndonjë gjë që ne të tjerët edhe ia lejonim vetes. I ati ishte kryetar i komitetit ekzekutiv i një rajoni po Agroni nuk mburrej. Përgjithësisht nuk mburrej asnjëherë, siç bënte, fjala vjen, Bledar Guxholli, që një e më dy kërkonte t'i nxirrte plot merita vetes e familjes.

Nuk po ia ndaja sytë, pa m'u duruar të ma tregonte enigmën që e mundonte. Nuk kisha as kohë, dreqi ta hajë!

- Dëgjo, - zuri të fliste prapë ai - thonë se sonte do të bëhet një demonstratë në sheshin "Skënderbej"... Ke dëgjuar gjë?

- Çfarë demonstrate?

- Po... kundër pushtetit, Partisë... Kështu flitet.

Ngriva. Qe diçka trulllosëse, tej së besueshmes. Menjëherë m'u kujtua se përpara dy a tre muajsh pikërisht Agroni më kishte thënë se në Shkodër qe bërë një përpjekje për të rrëzuar statujën e Stalinit. Nuk e kisha besuar; vetëm pasi e dëgjova edhe nga të tjerë, e besova. Po çastin kur më kishte folur Agroni s'e harroj kurrë. Më kishte treguar se policia ishte sjellë egërsisht, kishte rrahur dhe arrestuar qindra veta. Thoshin se i kishte organizuar një prift. E kisha dëgjuar i tromaksur, si të mos guxoja të merrja frymë. Por mbaj mend se pas një grime isha mbushur me frymë si kurrë ndonjëherë, thua se mushkëritë më kishin fituar një përmasë të re. E jo vetëm kaq, po sikur edhe diçka tjetër qe zgjeruar brenda meje, mbase befas qe rritur embrioni i një dëshire instinktive që disa buste përjetësisht të patundshëm t'i shikoja të rrëzuar. Pse e kam pasur këtë dëshirë as unë nuk e di. Mbase nga që kurrë nuk kam qenë i bindur për meritat e njerëzve të cilëve u ishin ngritur, si fjala vjen Stalinit. Për të kisha parë në televizionin italian, por edhe kisha lexuar (në fshehtësinë më të madhe, ta pret mendja) se ai s'kishte qenë tjetër veçse një diktator, gjë që s'ia kisha pohuar kurrkujt.

Ja, këto m'u kujtuan atë çast. Fundja në errësirën e natës një grusht njerëzish mund ta hedhin një bust, thashë me vete, po si mund të bëjnë demonstratë? Ajo mund të bëhej vetëm publikisht, madje ky ishte dhe qëllimi i saj. Si do të guxonin?

- Kush të tha? - e pyeta me ankth, duke ndier një si rrezëllim të çuditshëm në tru.

Fytyra e tij u tkurr pak.

- Nuk mund të ta them. Nuk fyhesh, ë?

- Jo, pse? - ia bëra unë, por në të vërtetë u fyeva. S'ke ç'i bën, nganjëherë fyhesh si dreqi dhe thua se nuk je fyer. Ç'është

kjo, mirësjellje apo hipokrizi?

- Po gjithandej flitet, - nxitoi të shtonte Agroni. - Kujtova se edhe ti ke dëgjuar...

- S'di, asgjë, të betohem. Po kush do ta bëjë?

- Ata, pra, që nuk janë dakord... Që janë kundër nesh, Partisë... Ndonjë grusht kokëkrisurish, nga ata që kanë dalë nga burgu. Ka për t'i përllarë policia fët e fët.

E kapa nga krahu. Mësuese Marianën, që më priste, e kisha harruar krejt. Isha si në ethe.

- Agron, më thuaj gjithçka di. Të betohem, tani po e dëgjoj për herë të parë...

- As unë nuk di më shumë. Veç atij që më tha kaq sa të thashë, në mëngjes, duke ardhur për në shkollë, dëgjoja djem të panjohur që i thoshin njëri tjetrit "Në orën gjashtë, ë? Shfaqja është lënë për më gjashtë." S'ka pak që unë e Bledari i dëgjuam këto edhe nga një grup çunash të shkollës.

Tutje, në thellësi të korridorit, u dëgjua gërvima e një dere. U përmenda. Në dritën e mugët të dritares fundore u vizatua silueta e dikujt. E njoha, ishte Bledari.

- Mirton, presorja po të pret! - thirri.

- Dëgjo, - më tha Agroni me të shpejtë, - unë nuk të kam thënë asgjë, mirë? Domethënë nuk të kam pyetur për asgjë...

- Mos ki merak. Dëgjo, më prit pasdite në shtëpi.

Më tha se në shtëpi do të ishte dhe iku. Unë u nisa me hapa të shpejtë për në kabinetin e fizikës. Bledari i kishte dhënë fund punës duke ndihmuar mësuesen dhe po vishte xhakoventon. Midis tryezave pashë Marianën, të cilën e njoftova se sapo më kishte kërkuar edhe mësuese Lumturia. Ajo, pa m'i hedhur fare sytë, më tha se s'prishte punë, mund të shkoja më parë tek ajo.

U nisa me hapa të shpejtë për në kabinetin e Historisë së Partisë, apo më mirë për në tempullin ku na mësonin marksizëm-leninizmin. Sa hyja në atë kabinet më përshkonte një ftohtësi e akullt, si t'i ngjitej lëkurës një lëndë rrëshqinore e bezdisshme, e shkaktuar nga një ndjesi e turbullt se për diçka ishte fajtor, se diçka s'e kishte kryer si duhet, apo se ende kishte shumë për të bërë për t'iu afruar sadopak atyre njerëzve të lavdishëm, portretet e të cilëve, të vëna nëpër korniza, mbushnin muret gjithë bojra. Qe një ndjesi e papërcaktuar fshikulluese apo, ca më keq, e ndieje veten si të zhveshur përpara syve të ftohtë të klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe heronjve të tjerë të Partisë. Sy të ftohtë,

zhbirues, vlerësues e të pamëshirshëm; ata dhe vetëm ata e dinin se në ç'raport qëndroje ti ndaj parimeve. Parimeve. Më kishte ardhur në majë të hundës ajo fjalë. E megjithatë, në atë kabinet, ajo ishte e shenjtë, strumbullari i gjithçkaje.

Dera e kabinetit ishte e hapur. Zemra më rrahu fort. E kisha si sëmundje, gjithnjë në derën e atij kabineti sepse më rrihte zemra. Aq më tepër që mësuesja nuk më kishte thënë përse më donte. Kur ndonjë mësues më thërret pa më thënë përse unë shqetësohem, qoftë dhe kur më thërret një mësuese me të cilën e kam mirë, si bie fjala mësuese Lumturia. Vallë do të më pyeste për kryqin e Alekos apo demonstratën? Ndofta donte të dinte se ç'dija unë?

Edhe pse dera që e hapur trokita si për zakon. Sytë më shkuan pa dashur tek maketi i kasolles së Galigatit, i cili më pëlqente vërtet, pasi më ngjante me një dekor teatri kukullash. Përsëri më flakëroi mendja te thashethemja për demonstratën dhe sepse m'u duk që demonstruesit do të vinin edhe këtu, vetëm për t'i vënë zjarrin atij maketi. Edhe portreteve nëpër mure. Mësuese Lumturia më kishte thirrur të më kishte gati për ndihmë.

Ajo po shkruante; kur më pa lëshoi stilografin dhe më bëri shenjë t'i shkoja pranë. Kishte fytyrë fisnike, flokë të zbardhur dhe vështrim të ngrohtë. Vetëtimthi m'u përvijua pyetja: vallë ka dyshuar ndonjëherë mësuese Lumturia në drejtësinë e vijës së Partisë?

I qëndrova përballë duke pritur të më thoshte pse më kishte thirrur. Ah, u kujtova - për referatin. Prej kohe na kishte ngarkuar të shkruanim nga një referat me temë të lirë nga kapitujt e moralit. Unë e nja dy të tjerë nuk e kishim dorëzuar. I pata thënë se do t'ia sillja sot, por as sot s'mund t'ia jepja, sepse s'e kisha bërë.

- Mirton, besoj e more me mend pse të thirra.

- Po, presore, për referatin.

- E solle?

- Jo, - i thashë duke e ndier se po skuqesha. - Harrova. Jua sjell nesër.

- Mos harron prapë?

- Jo, - iu përgjigja duke marrë frymë i lehtësuar, edhe pse e kisha gënjyer. Shyqyr që nuk më kishte pyetur për kryqin e Alekos apo për demonstratën. Sidomos për këtë të dytën. Ndonëse prapë do ta kisha gënjyer, do t'ia thosha se nuk dija asgjë. Me ç'pashë ajo nuk kishte dëgjuar gjë, sepse do ta kishte reflektuar shqetësimin.

Isha i sigurt se ideja se mund të bëhej demonstratë kundër regjimit do ta kishte tronditur më shumë se t'i kishe thënë: toka për disa ditë do të bëjë pushim, s'do të rrotullohet. Edhe në gjimnazin tjetër kisha vënë re se mësuesit e marksizmit janë më dogmatikë. Mbase dhe gaboja, kush e di?

Në kohën që po bëhesha gati të dilja ajo, krejt papritur, më pyeti pse kisha filluar të bija në mësim. Dhe s'ma hiqte vështrimin nga fytyra. Në sytë e saj kishte ftesë të singertë për t'i treguar të vërtetën. Edhe pse singëriteti i saj më preku, nuk më bëhej t'i hapësja.

- Pse pra, Mirton?

- Si t'jua them... Jo se kam ndonjë shkak.

- Ke qenë ndër më të mirët, - vazhdoi. - Me siguri diçka ke, apo jo?

- Jo, presore. Është e vërtetë se nuk po mësoj sa duhet, po jo se kam ndonjë gjë.

- Në rregull, - tha. - Mirë, shko, veç nuk do ta quaj të mbyllur këtë bisedë.

Këto fjalë i tha me qortim, por butë, me një buzëqeshje të trishtuar. E përshëndeta dhe dola.

Në kohën që isha duke u futur në laboratorin e fizikës Bledari ishte duke dalë. Tip i çuditshëm, s'linte rast po u ofruar ndihmë mësuesve. Ndodhte që ndonjë të hynte në klasë pa regjistër apo pa ndonjë mjet, Bledari merrte vrapin t'ia sillte. Kurse kur vinte puna për të ndihmuar ndonjë nga shokët, s'e bënte kurrë.

Më kaloi pranë dhe i hapa rrugë. Ai, papritur, më kapi nga krahu dhe duke më afruar fytyrën, më pyeti me zë të ulët nëse dija ndonjë gjë për demonstratën.

- Asgjë, - i thashë shkurt.

E pashë që nuk më besoi. Edhe pse më brente kureshtja nuk ia zgjata. Ai mund të dinte më shumë se Agroni, po tipave si ai është mirë t'u rrih larg. Të shesin kur të duash, janë të fryrë nga egoizmi dhe adhurimi për veten. Me një fjalë që tip egzibicionisti, kishte për borxh të mburrte edhe zorrët e veta. Në shoqëri nuk që i keq, në biseda që tërheqës e nganjëherë ndante me tjetrin edhe pikën e fundit të birrës, ama narcizizmi i tij të tërbonte. Sidomos përpara mësuesve, po edhe vajzave. U bëra gati të hyja në laborator po ai prapë më mbajti.

- Dëgjo, - më tha, - vërtet nuk di gjë?

- Jo, pra! - ia preva prapë shkurt dhe hyra në laborator.

Mësuese Mariana rrinte te dritarja, pranë tryezës, nga ku dukej një pjesë e oborrit dhe rruga. Me të më parë të hyja më pyeti me ton patetik:

- Ç'pate, mor djalë, pse përsëri i papërgatitur?

Mirëpo nga shprehja e fytyrës të dukej se jo që nuk i vinte keq, po sikur në thellësi të vetes i ishte bërë qejfi për këtë. Ktheva kokën mënjanë, pa iu përgjigjur.

Ajo u ul në tryezë, nxorri nga sirtari një kokërr portokalli dhe me këmbën mbi këmbë nisi ta qëronte. Nisa t'i kundroja fytyrën, që e kishte simpatike, me një tegel pushi të hollë mbi buzën e sipërme. Më zgjati gjysmën e portokallit, nuk ia mora.

- Po si, do të vazhdosh të më zhgënjesh? Se as në detyrën me shkrim nuk je paraqitur mirë. - Ndërkohë nxorri nga sirtari detyrën time me shkrim. - Merre, - më tha. - Dy katra radhë...

I thashë se nuk do t'i shkoja më i papërgatitur.

- Tregoja edhe babait, - më tha duke bërë me kokë nga fleta. Edhe për notën e sotme. Apo t'i them vetë?

- Si të doni, - thashë.

- Një njeri si ai nuk duhet zhgënjyer kurrë, - vazhdoi ajo. - Me aq pasion për shkencën. - Fuste thelat e portokallit në gojë dhe përtypej hijshëm, me vështrimin nga dritarja. - Apo s'është kështu?

- Po, - ia ktheva mekanikisht.

Nga dritarja hynte një dritë gazmore, që të bënte të ndiheshe pa peshë, dhe më erdhi keq që në ato çaste ndodhesha në atë laborator gjysmë të errët, me portretin e Enverit në krye dhe me atë të Njutonit në fund. Kurse jashtë kishte aq dritë dhe kaltërsi. Majat e pemëve në të djathtë të oborrit lëkundeshin lehtë, thua se i tregonin të fshehta njëra-tjetrës. Herë pas here në to uleshin tufa zogjsh, që edhe ata sikur sillnin e merrnin mesazhe. Edhe tani u shkëputën dy harabela. Shkëputja, fluturimi i lirë... Nuk di pse më sëmboi zemra.

- Diçka ke, Mirton, apo jo? Se në semestrin e parë ke qenë te nënta. Po të doje edhe dhjetën e merrje. Si ta shpjegoj këtë rënie?

O zot, edhe mësuese Lumturia po kështu. Nuk e kisha ditur se mësuesit u torturokan kur një nxënës bie në mësime. Priste t'i përgjigjesha, po s'më vinte të flisja. Ndërkohë sesi më shkuan sytë te një torbë e vendosur te cepi i murit, që nga forma dukej se qe me portokalle. Portokallet në atë stinë ishin gjë e rrallë, kështuqë me sa duket ose ia kishte sjellë peshqesh ndonjë nga prindërit, ose të paktën ia kishte gjetur. Mbase nuk bëja mirë që

dysvoja kështu, por kisha dëgjuar se ajo nuk i refuzonte "ndere" të tilla, madje ua kërkonte prindërve. Për "ndere" mësuesve kisha dëgjuar të flisnin edhe prindërit e mi, sidomos pas ardhjes në këtë shkollë. E thoshin hapur që edhe Marianës, edhe Besës, asaj të matematikës, u duheshin bërë "ndere".

Po mbase s'e kishin fjalën për ndere materiale, për dhënie peshqeshesh e këso gjërash, siç kishte plot prindër që e bënë, duke i blerë notat e fëmijëve, po për ndere që kishin të bënë me profesionet e tyre, pra me diçka më fisnike. Se im atë është mjek, kurse mamaja farmaciste. Ata s'kishin si të mos e dinin se dhënia e peshqesheve ishte diçka e ulët, fyese. Për mësuesin po se po, por edhe për prindin. Unë do të isha tërbuar ta dija se prindërve të mi do t'u shkonte goftë dhe nëpër mend për t'u bërë peshqeshe mësuesve, apo ryshvete, po të përdorim një fjalë më realiste.

- Do t'i vësh vetë në dijeni prindërit? - më pyeti mësuesja.

- Po.

- Me babanë tënd jemi marrë vesh që për të qenë 9 nota jote përfundimtare, duhet të hysh në provim me 8. Ndryshe nuk mund të ta nxjerr dot 9, më kupton?

- Po.

- T'ia thuash edhe këtë.

- Po.

Ajo heshti, dhe heshti aq gjatë sa fillova të ndiej mërzi. Duket edhe ajo e ndjeu se s'kishte ç'më thoshte më dhe më tha se mund të shkoja. E përshëndeta dhe dola gati me vrap.

Mesdita kishte kohë që kishte kaluar. Dy biseda me dy mësuese njëra pas tjetrës! Megjithatë asnjëra nuk ma kishte bllokuar trurin aq shumë, madje as ngjarja me kryqin e Alekos, sesa pëshpëritja se mund të bëhej demonstratë. Në mendjen time kjo fjalë po merrte një kumbim të ri, të çuditshëm, që nuk i ngjante aspak kuptimit që kishte mbartur deri tani. Madje edhe më të ndryshëm nga ai që mbartte kur përdorej për të treguar copa nga realitetet e vendeve të tjera, demonstrata politike, kundër aparteidit, kundër armëve bërthamore e kështu me radhë. Jo, në mendjen time ajo merrte një kuptim të përbindshëm, diçka që të kujtonte apokalipsin. Diçka më shumë se e pabesueshmja. Mendim trulllosës. Ëndërr. Tmerr. Por një tmerr i bukur. Bukuri e tmerrtë.

Ndjeva se po më dhimbte koka. Dhe befas më bubulloi pyetja: po sikur vërtetë të bëhej demonstratë, unë ç'do të bëja?...

Nuk munda të përgjigjesha. Nuk dija sesi. Ndaj u përpoqa ta

largoja mendjen prej saj. Për më tepër se ideja për të do të qe një bllof, kokëshkrepje e dikujt. Diçka irreale. Unë s'kisha punë me të. Kisha hallet e mija. Lidhur me shkollën, mësimet, degën që do të ndiqja në universitet, po qe se do ta kisha atë fat. Demonstrata nuk i përkiste fjalorit aktiv ose, dhe në i përkiste, nënkuptonte një veprim të kundërligjshëm, antishtetëror. Kishte gati pesëdhjetë vjet që në Shqipëri nuk bëheshin demonstrata, por manifestime të bujshme pro regjimit. Kuptim të mirë mbartte dikur, kur organizohej kundër mbretit apo pushtuesit. Me një fjalë i përkiste së shkuarës, arkivit, qe e vdekur, brenda një sarkofagu krejtësisht të pahapshëm. Kurse ja, pas kaq vitesh, ajo sfidonte vdekjen, ringjallej, thyente mermerin ku kishte qenë e ngujuar dhe hovte flatrahapur dhe e egërsuar, për të sfiduar edhe sistemin e sotëm, për të përfshirë edhe të gjallët në vallen e saj. Sikurse edhe dikur, ajo ndrynte transparencën, guximin, sfidën, hovin, frikën, ankthin, bukurinë e së panjohurës, tensionin e diçkaje tmerrësisht tërheqëse por edhe tmerrin e vetëvrasjes...

4

Vazhdoja të ecja si nëpër tym. Një si zog i egër nisi të më rrihte brenda krahërorit. Demonstratë kundër pushtetit! Po kush do të ishin sfiduesit?

Në Poloni kishte vite që bëhej një luftë aktive, demokratike, kundër sistemit komunist, e filluar me grevën e Gdanskut, po ec të merrje vesh nëse kjo luftë kishte synime për të mirë apo për të keq. Nocioni "revizionizëm" na ishte pompuar thellë duke na penguar të gjykonim me qartësi. Tamam si ai virusi te kompjuterat, që ua bën lëmsh të gjitha llogaritjet. As lëvizjet e fuqishme me dy gishta lart në vendet e tjera të Evropës Lindore nuk kisha arritur t'i kuptoja. Bile as gjakderdhjen në Rumani, bashkë me vrasjen e Çausheskut, nuk kisha arritur ta kategorizoja si duhet. Im atë fliste me neveri për të, sikurse edhe për largimet masive nga Gjermania Lindore në Çekosllovakia me synimin për të kaluar në Gjermaninë Perëndimore. Gazetat, radioja, televizioni, i gjithë opinioni shoqëror, shtetëror dhe partiak, ishin kundër lëvizjeve të tilla.

Unë për vete nuk kam bindje të caktuara politike. Ndryshimet më pëlqejnë, dua të ndodhin sa më shumë por, edhe pse i dëshiroj me

shpirt, mendja e ka të vështirë të dalë jashtë asaj strukture të paracaktuar e të ngurosur, brenda së cilës isha lindur e rritur. Ndryshimet i dëshiroj pavetëdijshtë, më zien gjaku për to, ëndërroj për to por si jashtë arsyes, anës racionale, si të ishte përgjegjës për atë ëndërrim një shqisë që nuk ka të bëjë me arsyen, madje që e sfidon atë. Sepse, të ishte për arsyen, apo botëkuptimin, si i thonë shkencërisht, atë e kisha të mbërthyer në qindra rrathë hekuri e skeletesh tashmë të ngrirë, të rrahur qysh në fëmëni nga prindërit, radioja, gazetatat, fjalimet e udhëheqësve, mbrëmjet e fatosëve e pionierëve, madje që në kopsht ku revista "Yllkat", të cilën na e lexonte edukatorja rregullisht, ishte e mbushur tejmbanë me figurën e udhëheqësit dhe me vjersha e këngë vetëm për të. Si mund të dilte arsyeja ime sa hap e mbyll sytë jashtë indit të saj kockor, jashtë asaj lëkure botëkuptimore që ishte bërë mish e gjak me të?

Nëse gëzohesha kur dëgjoja për ndryshime, qoftë edhe për ndryshime radikale që s't'i rrokte mendja, gëzimin ma sillte pavetëdija, lëmshi i turbullt i parandjenjës së diçkaje të re, gjë që s'kishte të bënte me arsyen apo, po qe se do të mundte, ky lëmsh i turbullt magjepsës do ta bënte copë e çikë arsyen nëse kjo do të bëhej pengesë që ajo parandjenjë ekstraracionale të realizohej. Me një fjalë tek unë më shumë vlonin instinktët e njeriut primitiv, atavizmat e pavdekshme të të cilit nxirrnin krye sa herë që arsyeja donte të përjashtonte çdo lloj gjallimi tjetër shpirtëror për ta pasur të paprekur domenin e saj, sesa njeriu i vetëdijshtë që ngrihet në demonstratë. Mirëpo bindjet kanë të bëjnë me arsyen, jo me instinktët, me lëmshet e turbullta të parandjenjave e me të tilla si këto, kështu që nuk isha i zoti të mendoja asgjë të qartë për çka më kishte thënë Agroni. Një gjë e them me siguri - sistemin tonë komunist as e adhuroja e as e idealizoja, siç bënin shumica, të cilët të çanin veshët me ato sloganet e pandryshueshme deri në neveri - por as e mohojta. Thjesht mendoja se një mori gjërash mund, dhe duhet, të ndryshonin, po gjithnjë brenda tij. Jashtë tij arsyeja ime nuk depërtonte dot.

Për kapitalizmin kisha mendimet më të turbullta ndonëse, gjithnjë pavetëdijshtë, ato shpesh ishin dhe tepër joshëse, sikurse edhe ato për revizionizmin, ku më dukej se njerëzit ishin më të lirë se tek ne. Gjithë ç'doja unë ishte të kishim më shumë liri. Gjë që, siç thashë, e ndjeja më shumë pavetëdijshtë sesa racionalisht pasi, është vërtet për t'u çuditur, por subkonshienca

zë një vend tepër qendror tek unë. S'ke ç'i bën, atavizëm stërggjyshor! Në vrullet e mija shpirtërore hynin stuhi të tëra dëshirash për liri. Një muzikë "rok", një këngë e "Skorpions"-ave, e "Ejs ov Bejs"-ave apo një film amerikan më dalldiste, ndonëse "arsyeshëm" duhej t'ia ndaloja vetes rreptësisht dëgjimin apo shikimin e tyre. Kështu më thoshte im atë, kështu mësuesit, kështu kongreset e Partisë e mijëra zëdhënës të tjerë.

A ishin të drejta e legjitime "stuhitë" e mija apo barrierat që i pengonin ato, për këtë s'kisha qenë kurrë i qartë. Më i qartë ka qenë shpirti, lëmshi i ëndrrave, reale apo të turbullta, që dalldisej, kurse mendja gjithnjë e paqartë, e mbështjellë në mjegullnajën e tyre. Ajo ishte e qartë vetëm në kodin e saj të programuar. Të automatizuar. Mendja dhe shpirti im, sigurisht dhe i shumë të tjerëve, gjendeshin në një korrelacion të çuditshëm antagonizmi që shpesh krijonte dhimbje.

Ajo që më ngashënjente te sistemi kapitalist, apo edhe revizionist - ndonëse këtë të dytin s'e kisha pasur kurrë të qartë se ç'sistem qe - ishte liria e njerëzve për t'u hapur udhë pasioneve. Pasionë që më rrëmbenin, por që i frenoja dhe i fshihja. Që thellë në vete doja t'u hapja udhë edhe unë, të kapllohesha prej tyre. E kam fjalën për pasionë fisnike. Nëse kërkohej që ndryshimet të vinin në emër të tyre, unë do t'i pranoja me gjithë shpirt. Më shumë se çdo gjë urreja ngrirjen, që na kishte hyrë deri në palcë. Ishte ajo që na kishte bllokuar edhe arsyen. Le të vinte pra, më në fund, shkrirja. Le ta sillte kush të donte, veç ta sillte. Dhe kishte qenë pikërisht lajmi që më kishte dhënë Agroni që më kishte nxitur të arsyetoja. Që më kishte vënë në lëvizje jo vetëm lëmshin e instinkteve dhe parandjenjave, por edhe atë të arsyes. Më në fund, pra.

Vazhdoja të ecja trotuarit të rrugës së Dibrës i zhytur në këto mendime kur befas, teksa po i afrohesha stacionit të autobusit ku do të hipja, u ktheva në realitetin tim imediat: si dreqin do t'u thosha prindërve që kisha marrë dy katra? Ky lajm do ta trondiste babanë, por edhe mamanë do ta pikëllonte pa masë.

Im atë do si e si që unë të bëhem mjek, siç është edhe vetë. Kurse unë jo. Më ngrenë nervat ata trupat që shoh në librat e tij, skelete, gjymtyrë, mushkëri e ku di unë. Më vjen të përzier, t'ju them të drejtën. Kur sëmurem e më çojnë për t'u vizituar, tmerrohem. Babai s'më viziton vetë, më çon te ndonjë shok. S'ka më frikacak se unë nga mjekësia. Ju mbase thoni si është e mundur të

mos e duash mjekësinë kur babanë e ke mjek, e madje mjek të shquar, po ja që kështu është. Babanë mund ta kesh mjek, madje edhe të shquar, e prapëseprapë të mos e kesh qejf mjekësinë.

Dola te "Selvia" dhe vazhdova të ecja përgjatë trotuarit të majtë për të shkuar te stacioni i autobusit. Në kohën që do të kaloja Rrugën e Barrikadave më erdhën në vesh ca si klithma e shungullima të largëta e të vazhduara, që herë fashiteshin e herë dëgjoheshin më fort. Në fillim m'u dukën si sirena zjrrfikësesh, por shpejt e kuptova që s'qenë të tilla, pasi vinin më të fuqishme, më të egra e inatçore. Ato sikur kumtonin diçka ogurzezë me përmasa të mëdha. Ulërimat u shtuan sa të rrëqethnin trupin e shpejt dolën në pah edhe lëshueset e tyre, një autokolonë e gjatë kamionësh me karrocëritë të mbushura me ushtarë a me policë repartesh speciale a drejtë e di se ç'ishin.

Kaloi një numër i pafund, gjithë tërsëllemë e trandë, sa trotuari ku qëndroja dridhej, për t'u zhdukur brenda pak çastesh, duke lënë pas fjollat e tymit të zi dhe vibracionet e drithmave në zemrat e njerëzve që u ndodhën përgjatë rrugës. U zhdukën kamionët, po jo ulërimat, të cilat vazhduan deri sa përsëri nisën të dëgjoheshin si piskama të holla.

Njerëzit rrinin si të ngrirë. Në fytyrat e tyre lexohej hutimi dhe një lloj alarmi i përzier me frikë, që shprehej në pyetjen: "Ç'po ndodh? Ç'do të ndodhë?"

Nuk i hipa autobusit po shkova deri te sheshi "Skënderbej" në këmbë. Kamionët ishin përhapur në të gjithë sheshin. Pranë njëres makinë rrinte një oficer me pamje të ashpër; një tjetër se për çfarë i bërtiste shoferit.

Sheshi, megjithatë, llamburiste nga drita e qashtë, e lëbyrtë, e asaj pasditeje prilli. Xhamat e Pallatit të Kulturës shkëlqenin verbueshëm, njerëzit lëvrinin rreth e rrotull krejt të habitur, kurse ndonjë veturë e rrallë shkiste si me frikë përmes "Ifave". Teksa kundroja tërë atë hapësirë plot dritë e lëvizje, edhe pse lëvizja që gati si e ngrirë, zemra befasi m'u përpëliti: "Ifat" m'u dukën si ca buburrecë të frikshëm e krejt jashtë kohës. Përsëri m'u përhi turbull në mendje kumti i zi që sikur paralajmëronte prania e tyre. Vallë ç'ogur që?

I hipa autobuzit të Tiranës së Re duke u shtyrë mes njerëzve, që dhe ata, të heshtur, nuk ua ndanin sytë kamionëve të mbushur me ushtarë.

Mezi e mora vesh se kisha mbërritur në stacionin tim. Hera e

parë që koha më rrodhi aq shpejt, se shkollën tani e kisha vërtet larg. Kur zbrita ora ishte rreth treshit.

- Ej, garip, fillove të na mbahesh për profesor? - dëgjova një zë të njohur. Ishte Ardit Cani, një shok feminine që e kisha pasur edhe shok klase deri vitin e kaluar. Këtë vit e kishin përjashtuar nga shkolla sepse e kishin zënë duke shkëmbyer kaseta me këngë të huaja. Njëra ishte e Bitëllsave. O zot, të të përjashtojnë nga shkolla pse dëgjon Bitëllsat!

U shkëput nga muri ku rrinte mbështetur dhe më erdhi pranë. Mbante një xhakovento bojëqielli, shall me lajlelule, pantallona xhins dhe këpucë atlete. Në mjekër dhe në faqe i nxinte pushi, flokët i ishin gafrruar keq rreth qafës. Tani që nuk shkonte në shkollë bridhte andej këtej pa punë.

- Eja të pijmë nga një birrë, - më tha dhe më tërhoqi nga krahu. Nxori paketën e ma zgjati, po nuk mora cigare. Nganjëherë edhe e ndizja, po aty kisha frikë mos më shikonte babai. I thashë se nuk doja birrë, ishte kohë dreke dhe në shtëpi më prisnin. Nuk m'u nda, eja dhe eja.

Filluam hidh-e-pritet, siç bënim dikur: Ke hyrë në punë? Po tallesh, mor trap? Punë leshi, ku ka punë? Po paret për birrë ku i ke gjetur? Ah, për kaq? Pa gjë fare nuk jam, de!

Më futi në bufenë aty pranë dhe solli dy birra.

Gëzuar! Ke humbur fare, as darkave s'del. Nuk kam kohë fare. Nga ty ç'kemi? Jam njohur me një shitëse bulmeti, një dërdënge. Shkoj dhe e ndihmoj në mëngjes për qumështin dhe djathin, kështu që s'dal pa gjë. Bukur. Shumë bukur. Dëgjo, ç'bëhet andej nga ju?

Më pyeti duke më parë në një mënyrë disi enigmatike.

- Asgjë, - i thashë pa marrë vesh ku donte të dilte. - Ç'të bëhet?

- Garip, u trembe? - Qeshi dhe pa dashur më hodhi tymin e cigares në fytyrë. - Më fal, - më tha. - Veç mua që s'ke pse më fshihesh, ia njohim dhëmballët njëri tjetrit. - Afroi fytyrën fare pranë simes. - Flitet se do të kërcasë.

- Diçka kam dëgjuar, - i thashë, dhe në çast e ndjeva përsëri atë zogun e egër të më flatëronte me tërbim në gjoks.

A thua se vërtet, Ardit?... Nuk e di... Ah, ku ma gjen! Vetëm të fillojë! O Zot, të fillojë! Me dy automatikë njëherësh do t'i grija disa! Siç na kanë grirë tërë jetën! Kaq urrejtje ke? Si të mos kem? Po s'ke faj që ma bën këtë pyetje. Je rritur si veshka mes dhjavit. Madje kush e di, më urren mua që urrej. Jo, atë mos e thuaj, Ardit.

Po shpërthimin tënd nuk e ndiej, të them kot? Thuaj ç'të duash, bebush, po diçka do të ndodhë. Diçka e madhe. Dhe së shpejti. Të lutem, mos më thuaj bebush. Nuk jam më bebush. Mirë, shpirt, mirë. Veç thuaj edhe ti se diçka do të ndodhë. Më jep edhe ti një fije shprese. Se dua të besoj me gjithë shpirt por diçka më pengon. Kam frikë të besoj me gjithë shpirt. Kam frikë të besoj se betoni do të çahet. Se do të dalim nga bunkerit. Kam frikë. Po më mirë e lëmë këtë bisedë se është bërë pëllëmbë e spiunë! Me mësim si ia kalon? Çka. Kam rënë ca. Më vjen keq. Se sido që të venë punët shkolla është flori. Sidomos për ty. Se aftësitë e tua rrallëkush i ka. Po dhe unë s'kam qenë keq me mësim, ë? Jo. Edhe ti ke qenë as. Me gjithë mend e kam, i mrekullueshëm ke qenë. Sidomos në hartime. Hartimet e tua askush nuk i bënte...

Pashë se u prek, dhe sikur iu lëngëzuan sytë.

- Eh, iku ajo kohë... Tani bredh si zarbo. Më përjashtuan kot, Toni. Që ua lërofsha nënat! Vetëm pse shkëmbeja kaseta me atë Dritanin, kuqon, ti e njeh. Në fakt atë zunë, po atë e falën, kishte miq...

Shtrëngoi dhëmbët dhe gati u përplot. Edhe tek unë diçka u drodh, a u lëngëzua. Mbase më rrodhi një lot i padukshëm? Thjesht më erdhi keq për Arditin, apo qe diçka që shkonte shumë më përtej keqardhjes për të? Edhe në ekranet e syve të Arditit diçka përshkënditej, dhimbja apo urrejtja?

- Mirton, diçka po lëviz, dreqi ta hajë, nuk e ndien? Ç'thonë në shkollën tuaj për ngjarjet në Rumani?

- Ka që thonë se i treguan vendin një diktatori, ka të tjerë që e quajnë një lajthitje, një kundërrevolucion të llojit të Hungarisë.

- Po për mundësitë këtu ç'thonë? Ë?

Sytë e tij bojëkafe, me bebëzat si dy gjilpëra, sikur i shpuan sytë e mi.

- Mbase njerëzit nuk guxojnë të vendosin paralelizma...

- Nuk guxojnë, posi! Lesh! Guxojnë që ç'ke me të! Kujt i ka vajtur thika në kockë guxon, mor trap! Ti mbase jo. Se ti kalë karroce ke qenë! Me pallëmet që të ka vënë babai anash syve s'ke parë kurrë ç'ndodh anash... Se ty s'të ka dhëmbur koka për asgjë, edhe qumësht dallëndysheje ke pirë.

- E pse m'i thua këto? Do të më fyesh? Vërtet për të tillë më njeh?

- Në të vërtetë njerëz si ty janë anash lojës. As prishni, as

ndreqni. Si ti, si yt atë, si shumë të tjerë. Po ka ca të tjerë që qëndrojnë shumë më lart se yt atë - ata që prishin. Që duhen shembur. Dhe që do të shemben. - Rrëmbu gotën e birrës me vrull. - Hajde, gëzuar! Për paralelizmat, që shkojnë që ç'ke me të! Ti qull nuk je, të njoh mirë, po fajin ta kanë palldëmet.

Desha t'i përgjigjesha se palldëme të gjithë kishim, kush më të mëdha e kush më të vogla, por heshta. Zjeja edhe nga dëshira për ta pyetur se ç'dinte ndonjë gjë konkrete për demonstratën, po prapë heshta. Nuk guxoja. Zinxhiri mund të tirrej gjatë dhe unë i kisha frikë zinxhirët. Jo kush të tha, jo si ta tha. E dija që më donte dhe kurrë nuk do të më shiste, po gjithsesi... Ne mund t'i hapeshim për çdo gjë njëri tjetrit, mund të nxirrnim edhe të palarat e familjeve në shesh, po nuk mund të hapeshim kurrë për gjëra që kishin të bënin me vënien në pikëpyetje të drejtësisë së ngurosur. Tema të tilla ishin tabu. Tabutë janë të mallkuara, torturuese. Duhet t'u bindesh ligjeve të tyre, ndryshe ato të gjakosin. Në prani të të tjerëve unë nuk kam dashur kurrë, ose më mirë nuk kam guxuar, të futem në diskutim për to. As tani me Arditin. Edhe pse po dukej se një farë flladi tjetër kishte filluar të frynte. Që ndihej në frymën e një pritjeje amorfe, të ethshme, të papërshtueshme me fjalë. E megjithatë nuk mund t'i hapësja. Por ai tha vetë:

- Do të kërcasë, i dashur! Se s'bën! Dhe mbase që sonte. Si thotë ajo kënga që mësonim dikur në shkollë: "Se mjaft në robëri, o e mjera Shqipëri..."

U drodha dhe pashë rrotull. Jo, askush nuk po na përgjonte. Dy tre burra pak më tej pinin raki e bisedonin shpenguar. Pashë prapë nga Arditi. Në sy i fekste një dritë e ethshme.

- Ardit, më shkoi vonë, - i thashë. - Singerisht, nuk mund të rri dot më.

- Edhe pak, të lutem. Mos ma prish. Edhe nga një birrë.

Dhe pa pritur përgjigje shkoi te banaku nga u kthye me dy birra të tjera.

- Ardit, po është shumë për ty...

- Nuk jam dhe aq keq, de! Nxjerr diçka.

- Me atë shitesen e bylmetit? Apo vazhdon me ato "punëra"?

E kisha fjalën për ca shitblerje të fshehta me turistë apo marinarë të huaj në Durrës. Nja dy herë e kishin marrë në polici, po për mungesë provash, e kishin lëshuar.

Ai rrudhi buzët.

- E ç'do të dalë nga bulmeti? Dollari dhe marka peshojnë, bebush.

- Po do ta pësosh! Do të të rrasin brenda ndonjë ditë.

- E pastaj? Nga një burg i madh në të voglin nuk ka shumë ndryshim, apo jo?

Ngriva. S'e kisha dëgjuar kurrë atë krahasim. Diçka krisi brenda meje. Ndjehesha i trullosur, veç jo nga birra. Ai zogu i egër nisi përsëri t'i rrihte flatrat me tërbim brenda kafazit të kraherorit. Për një çast ai u identifikua me fjalën ndryshim. A mbase edhe me fjalën përmbysje, nuk e di. Kjo ishte edhe më e egër. Vrastare, ndofta. Pashë përsëri rrotull. Qetësi. Ata burrat që pinin pak më tej qenë larguar. Pranë banakut qëndronte shitësja e përgjumur.

- Ardit, pse nuk përpiqesh të gjesh ndonjë punë?

- Ç'punë leshi? Hamall? Në minierë? Të më bjerë bretku për një rrogë të qelbur? E di ti sa marrin jashtë në këto punëra?

Përsëri brenda meje jehoi një çangë e frikshme. Diçka dija, po aty s'qe vendi për biseda të tilla. Madje, për biseda të tilla s'ishte vendi kurrkund. Edhe ajo ishte një nga tabutë.

- Jashtë... Po ne jemi këtu, dreqi ta hajë.

- E di. Edhe ata që pastrojnë bajgat e kuajve, mor shpirt, andej mbushin xhepat me dollarë, me marka... Po ti nuk di asgjë, ja, ta them unë!

- Ardit, i japim fund? Mbase dhe nuk e di, ç'të bëj? Të lutem, i japim fund se do iki. S'rri dot më.

- E shoh, paske vendosur të bëhesh djalë për kokën e djalit. Ai ndezi prapë një cigare. - Mirë, flasim për gjëra të tjera. Me vajzat si ia kalon andej? E ke zëvendësuar Selmën?

E kishte fjalën për Selma Berklin, një shoqen tonë të klasës me të cilën, sidomos vitin kaluar, isha shoqëruar shumë.

- Ç'flet? Se mos kushedi ç'kisha me Selmën.

- Mor po lëri ato! Dëgjo, ka më të bukura se Selma atje?

Doja ta shmajta atë bisedë, se mund të më mbante edhe një orë. Bisedave për femrat as unë nuk iu rezistojta dot. Aq më tepër me Arditin, që ishte i tmerrshëm për to. Kur ndodheshim grup çunash, ai ishte strumbullari. Sajonte ca gjëra për punë femrash, sa të gjithë ngeleshim gojëhapur.

- Seksi është gjë e madhe, bebush, - tha ai. - Vetëm që ne nuk e kuptojmë. S'kemi idenë se ç'është, hiç, prashisim kot.

- Ardit, mos të të mbetet hatri, po iki, - i thashë, dhe e kisha me gjithë mend. S'mund të rrija me të deri në darkë, edhe pse qejfi

ma kishte. Me të mund të rrija deri në mëngjes pa u mërzhitur fare.

- Si të duash, i dashur. Veç ta dish se këto kohë më je larguar. Fundja nga unë mund të largohesh, s'prish punë, veç erës që do të fillojë të fryjë mos i bëj bisht. Mos rri në bisht, merr vesh? Ti s'ke qenë kurrë nga të fundit. Edhe pse ke bërë jetë, qerrata!

- Ardit, prapë?...

- Mos u fyej, o trap... O alabaku im i dashur. - M'u afrua, më hodhi dorën në sup dhe nuk m'i shqiste sytë. - Dëgjo, ndonjë ditë do të të marr në Durrës me motor. E kam mësuar shkëlqyeshëm tani.

- Ku do ta gjesh?

Unë vdisja për një motor, ëndërr e kisha.

- Sekret profesional, trap! Mos ki merak, shpejt do t'i kemi në dorë horizontet. Do të bëjmë aventura sa të duash. Eja, se po të përcjell.

I thashë të pinte edhe birrën time që kisha lënë përgjysmë dhe dola. Ai lëshoi drejt meje një lumë epitetesh sharëse, siç e kishte zakon.

5

Nxorra çelësin dhe hapa derën. Më goditi në hundë aroma e njohur e shtëpisë. Dreka ishte gati mbi tryezë, por nuk më hahej, ndofta nga birra që sapo kisha pirë. Megjithatë vendosa të haja, më shumë për t'iu shpëtuar pyetjeve të bezdisshme të mamasë, e cila vë alarmin po të mos hash. Ngroha gjellën, mish me patate, e përzieva me makaranat dhe hëngra shpejt e shpejt.

Sa nisa të ngrija pjatat erdhi babai. E njoha nga mënyra si i binte ziles. Hoqi pardësynë dhe hyri në kuzhinë. M'u tkurr zemra tek mendova se duhej t'i tregoja për katrat që kisha marrë në fizikë. E kisha aq të rëndë, dreqi ta hajë. Më mirë t'i tregoja për njërën, për atë të detyrës me shkrim. Edhe për atë mund të mos i tregoja, po kisha hall mos i telefononte Mariana, a i kishte telefonuar, dhe ia kishte thënë. Në gjimnazin tjetër më kishte ndodhur një gjë e tillë.

- Do të hash drekë, babi?

- Hëngra në spital. Lusi nuk ka ardhur?

- Jo.

Lusi ishte motra e vogël, pyeste nëse kishte ardhur nga shkolla. Ai mori gazetën dhe i mbështetur në divan nisi t'u hidhte një sy

titujve. Prisja me gjak të ngrirë që të më bënte atë pyetjen e zakonshme, të paevitueshme, se si ia kisha kaluar në shkollë. Me një fjalë mos kisha marrë ndonjë notë. Mirëpo me ç'dukej nuk kishte ndërmend, vetëm lexonte. Pa ditur ç'të bëja zura t'i kundroja fytyrën. Një fytyrë ekspresive, me mollëza paksa të dala, me vetulla të dendura e flokë të bardhë. Çudi sa shpejt ishte thinjur, ndofta nga studimet. S'kisha parë njeri më të dhënë pas studimit se ai. Studionte deri natën vonë, madje edhe herët në mëngjes. Me siguri për të vazhduar konsultën e një nate më parë për ndonjë rast të vështirë.

- Po hë, ç'kishin nga shkolla? - më pyeti si kalimthi ndërsa ktheu faqen e gazetës.

Jo, ishte e pamundur t'i shpëtoje një çasti të tillë. Kapërdiva pështymëm dhe me një fytyrë të akullt, me demek sikur e ndjeja thellë pikëllimin, u përgjigja mbyturazi:

- Në fizikë... S'arrita dhe aq... Edhe keq nuk u përgjigja, por...

Edhe pa e parë e dija ç'shpkehje i mori fytyra. E kisha mësuar përmendësh. Madje dhe e imitoja. Kur isha vetëm, sigurisht. Kur isha vetëm, nuk e di pse, nga të gjitha imitimet që bëja - se unë jam një imitues i tmerrshëm - më pëlqente të imitoja babanë kur befasohej nga diçka.

- More notë?

- Nuk e di. Jo, e di, më duket katër, po nuk di a e vuri në regjistër...

- Ke marrë katër?!

- Në fakt për katër nuk u përgjigja, o ba...

Dreq, thashë me vete. Në fakt... Ishte shprehja që urreja më shumë, po s'di si më doli. Ai hodhi gazetën me nervozizëm dhe i vuri të dyja grushtet mbi tryezë.

- Paske marrë katër?! - Përplasi grushtin mbi tryezë dhe me nervozizmin në rritje vazhdoi: - Kjo është të çmendesh! Kjo është idiotizëm! Ç'dreqin të ka hipur kështu? Sofokliu a ka ardhur? A ka bërë mësime me ty?

- Po.

Sofokliu ishte një mësues pensionist që vinte në shtëpi një ose dy herë në javë për të më ndihmuar në matematikë e fizikë dhe që babai e paguante mirë.

- Po atëhere si shpjegohet?

- Kishim një kapitull përsëritje dhe...

- Dhe çfarë? Kur ke përsëritje duhet të marrësh katër? Mor je në vete?

Ta dinte që edhe në detyrën me shkrim kisha marrë katër rrezik të çmendej. Nuk fola. Nuk di pse m'u kujtua përsëri demonstrata. Vallë kishte dëgjuar babai për të? Si zor. Po edhe të kishte dëgjuar nuk do t'i kishte kushtuar pikë rëndësie, do ta quante o punë kalamanjsh, o punë të marrësh. Babai ishte me parime të hekurta, dhe stabilitetin e adhuronte.

- Të tha gjë mësuesja pasi të vuri katrën?

- Më mbajti pas mësimit. Po të betohem, babi, për katër nuk isha... - Dhe vërtet e kisha atë bindje.

- Mbylle! - ulëriti. - Mund të kishe marrë edhe gjashtë, e pastaj? Nxënës i gjashtës je? Ajo ka bërë mirë që të ka vënë katër. Në vend që të turpërohesh vete e më bën komente! Kokëderr! Teveqel! Si do ta përmirësosh atë notë? E merr dot dhjetën tani, mor trudalë, që të hysh në provim me tetë e për të dalë nga provimi me nëntë? Pse na i përmbys planet? Tërë ato mundime që po heqim për notat e tua mesatare? Pse, more kokëgdhë, more që s'di ç'të të them...

Në derë u dëgjuan trokitje të forta. Duhej të qe Lusi. Shkova dhe hapa derën. Ishte vërtet ajo, e bërë spec, gati t'ia plaste të qarit.

- Kam një orë që trokas, - më tha. - Je shurdhuar?

Vura gishtin në buzë pa iu përgjigjur. Ajo hyri në kuzhinë si me hap rreshtor, i tha babait "mirëdita" dhe u ul në divan. Kur kthehej nga shkolla e kur babai ishte në shtëpi, ajo shkonte drejt e tek ai, kurse sot, duke e parë gjendjen të acaruar, qëndroi mënjane, duke i hedhur sytë herë nga babai e herë nga unë.

- Lusi, më bëj një kafe, - i tha ai. - Se ky xhevahiri po na bën derr, po na shkallmon nga trutë!

Lusi kërceu me shkathtësi e u sul në aneks.

- Do të bisedoj vetë me të, - vazhdoi të fliste babai, duke e pasur fjalën për mësuesen. Toni qe më i ulët, po jo më pak i acaruar. - Edhe me Sofokliun. Po nuk e takova do t'i thuash të më marrë në telefon.

- Kush, Sofokliu?

- Sofokliu, po kush? Kot nuk e paguaj. Në goftë se ke vendosur të mos mësosh, s'ka kuptim të të trajtoj si zotëri, se nuk i kemi paret tepër!

Për disa minuta, deri sa piu kafen, vetëm turfulloi, pa më thënë

asgjë. Pastaj u ngrit papritur, i shkoi dorën Lusit në flokë dhe tha se do të dilte e mund të vonohej, kurse mua të hapja librat e të plasja trutë mbi to. Lusi iu hodh në qafë; ai e puthi me nxitim dhe doli në korridor, me Lusin që i ishte varur për beli.

Me të ikur babai, mora frymë i lehtësuar. Piva ndonjë gisht kafe që kishte mbetur në filxhanin e tij dhe mbështeta kokën mbi të dyja duart.

- Toni, vërtet ke marrë katër? - më pyeti Lusi.

- Të duhet gjë ty?

Ajo ktheu kokën mënjanë, e prekur.

- Merr katra, merr, se të ka lezet!

- Ej, Lusi! - ia bëra gjoja me inat, po në të vërtetë më erdhi për të qeshur. Pa ma varur ajo u ngrit dhe bëri të dilte nga kuzhina. Ajo qe e tmerrshme për të të mos ta varur kur zëmërohej. Ishte e sjellshme, tepër e sjellshme, ama kur prekej dinte të të injoronte, si fjala vjen tani. Po qe se ia prisje shkurt, ashtu ta kthente.

- Ku shkon?

- Ku më do qejfi.

- Shiko, po u solle kështu, nuk të çoj të dielën në teatrin e kukullave!

- Punë e madhe! Më çon mami.

- Domethënë u zëmërove. Unë të pyeta, kurse ti...

- Ti u zëmërove.

- Ke të drejtë, - i thashë. - Ç'është e vërteta, e këputa një katër në fizikë.

- Në fizikë, që të vjen edhe mësuesi në shtëpi?! - Këto fjalë i shoqëroi me një gjest të veçantë të kokës.

- Po e mora pa dashur...

Ishte vonë për ta rregulluar shprehjen - ajo ia plasi gazit.

- Desha të them aksidentalisht, merr vesh? Kujtdo mund t'i ndodhë. E, mirë, mjaft qeshe! Se do të zëmërohem me gjithë mend. Dëgjo, ç'do të bësh, do të dalësh të luash? - Kisha hall të më linte vetëm që të ndizja një cigare, aq më kishte hipur. Mund ta pija dhe në dhomën ku mësoja, po ajo e kishte zakon të fuste hundën atje çdo minutë.

- Jo, do të vizatoj.

- Ti sa erdhe nga shkolla, të lodhen sytë.

Ajo mbante syza, gjë që prindërit e kishin pikë të dobët. Kurse mua më pëlqente, i shkonin. Ia kishte blerë babai jashtë shtetit.

S'kisha parë fëmijë që t'i shkonin syzet aq shumë sa Lusit.

- Jo, do mbaroj vizatimin që kam filluar. Do ta shikosh?

Fëmijë më të thekur për të vizatuar s'kisha parë. Kushedi sa kuti ma lapsa, flamastra e pastele kishte. Edhe një piring me fletore vizatimi. Sa herë që babai shkonte jashtë shtetit me shërbim - dhe ai shkonte shpesh - gjithnjë do t'i sillte kuti me lapsa e ngjyra. Nga këto i sillte edhe dajë Sokoli, që bënte si i çmendur pas saj.

- Dëgjo, tani do të filloj të mësoj, ti e dëgjove babin.

As që ma vuri veshin, hapi çantën dhe nxori fletoren. E hapi, ma vuri përpara dhe më pyeti si më dukej. Qe një peisazh me kodra të tarracuara, kulla tensioni dhe një traktor. Dukej edhe traktoristi. Te vizatimet e fëmijëve gjithnjë gjej diçka naive e të bukur, por te Lusi kjo binte në sy. Të shikoje traktoristin të vinte për të qeshur e megjithatë kishte qejf ta shikoje.

- Bukur, - i thashë. - Tani dil të luash.

- Akoma s'e kam mbaruar, se kam edhe zogjtë nëpër tela.

Ajo mbylli fletoren dhe doli duke kërcyer. Shkova në dhomën time, domethënë ku mësoja e flija. Të nesërmen s'kisha fizikë, po në orën pesë do të vinte Sofokliu. E kisha tmerr ardhjen e tij. Ai kot që vinte se po të doja e thaja matematikën dhe fizikën, por babait i kishte humbur besimi, ndaj dhe e kishte marrë.

Me librin e fizikës në dorë u ula të mësoja. Për çudi, me të hapur librin më iku dëshira. Punë dreqi me mua, në vend që qortimet e babait të më nxitnin, sikur kishin bërë të kundërtën. E ndjeja ç'më gërvishte, të merresha me etydet që më kishte dhënë regjisor.

Ç'janë këto etyde dhe ky regjisor, do të thoni ju. Përpara se t'jua them, dua t'ju sqaroj se dëshira ime është të bëhem aktor. Më sakt, aktor komik. Këtë dëshirë e dinë edhe prindërit, por ata nuk duan. Sidomos babai. I është ngulur në mendje që unë o të bëhem mjek, siç është vetë, o s'ka. Është i çuditshëm im atë, kur i ngulet një gjë në kokë s'ka perëndi që ia shkul.

Këto po mendoja ndërsa ndalova përpara raftit të mbushur me libra e që zë tërë faqen e murit. Libra për mjekësinë në shqip e në gjuhë të huaja. Që sa herë i shikoja ndjeja atë frikën instinktive që ju kam thënë.

Një pjesë fare të vogël të raftit, sirtarin e poshtëm nga e djathta, e zinin librat e mi të shkollës bashkë me disa vepra artistike. Midis tyre edhe pjesë teatrale, drama e komedi, të autorëve tanë dhe të huaj. Proza më pëlqen, po më shumë më pëlqejnë pjesët teatrale. Dihet që teatrin, domethënë pjesën e vënë në

skenë, e kanë qejf shumë vetë, por leximin e saj pak e kanë qejf. Unë vdes edhe për ta lexuar, pa le për ta parë në skenë. Po qe se aktorët janë të mirë, sigurisht. Dhe po qe se regjisori e ka kuptuar pjesën. Kur është kështu, unë luaj mendsh për ta parë atë pjesë.

Që ta dini tamam, fshehurazi prindërve unë marr mësim për mjeshtërinë e aktorit te një regjisor, Xhezair Kazazi e quajnë, i cili është shok feminije me dajën tim. Daja ka bindje se unë kam talent dhe po të futem në prova, me siguri fitoj. Po kështu mendon edhe regjisori. Kurse unë nuk jam dhe aq i bindur, ndonëse përpiqem. Sa talent kam nuk e di, po që e kam pasion teatrin për këtë jam i bindur.

Herën e fundit Xhezairi më kishte dhënë dy etyde, njërin nga "Familja e Peshkatarit", atë pjesën ku në vend të partizanit të plagosur përpara xhandarëve del Petriti me kokë të lidhur, dhe tjetrin nga "Hamleti", atë episodin ku Hamleti, ndërsa është duke qortuar të ëmën, vret Pollonin që rrinte prapa perdes, duke e marrë për mbretin. Unë vetë kisha zgjedhur një etyd tjetër nga "Hamleti", atë pjesën te varrezat, ku Hamleti monologon me kafkën e Jorikut, gaztorit të Pallatit. Ky monolog më pëlqen shumë. Hamleti pak flet aty, po shpreh shumë. E di që është e vështirë ta arrish atë episod, duhet mimikë, timbër zëri dhe gjerësi ndjenje, po mbase e arrij. Unë as Xhezairit s'i kam thënë se mund të paraqitem në prova me këtë etyd. Për të cilin, për të krijuar efektin e duhur, kam gjetur dhe një kafkë. Jo të vërtetë, por prej allçije.

Në fakt isha përpjekur të gjeja një të vërtetë, po s'kisha mundur. Një ditë shkova në varreza duke kërkuar gjithandej. Rojtari, që kishte filluar t'i ndiqte me dyshim lëvizjet e miya, më afrohet dhe më pyet ç'kërkoj. Ndonjë kafkë, i them. I dashur, ç'i kërcyen sytë kur dëgjoji atë përgjigje. Ç'e do? Për mësim, përse tjetër? Dua t'i mësoj kockat, se jam student për doktor. Ah, ashtu? Ai u mendua pak. Tani për tani s'kemi, duku më vonë. Ama të sjellësh një shkresë nga shkolla, ndryshe s'ta jap. S'më mbeti tjetër veç të kërcitja e të ikja.

Punën e kafkës prej allçije ma shtiu në mend Tomi, kllouni i cirkut, që edhe ky është shok feminije me dajën dhe Xhezairin. Porositi një shokun e tij skulptor dhe ma solli. Kafka kishte dalë aq e mirë sa s'e dalloje nga e vërteta.

Në kohën që e nxora dhe po bëhesha gati të hidhesha tek "Hamleti" dëgjova zërin e Lusit:

- Toni, po vjen presori!

Dola në korridor. Profesori më përshëndeti dhe u bë gati të hynte në dhomë, siç bënte gjithnjë.

- Presor, e di si është puna? - ia nisa unë. - Kam një dhimbje të tmerrshme koke, ka mundësi të mos bëjmë mësim?

- Posi jo, - tha ai pa e prishur qejfin. - Veç të lutem firmos pak këtu.

Nxorri nga xhepi një bllok ku mbante shënim datat kur vinte në shtëpi. Në bazë të tyre babai e paguante, mjafton të paraqitej që të merte paratë. Firmosa dhe ia ktheva bllokun. Më përshëndeti tërë mirësjellje, duke ngritur paksa kapelen, dhe doli.

Me t'u kthyer në dhomë më rrezëlliu kujtimi i një i imazhi të ngjashëm me imazhin e një ëndrre. Qe një ndjesi e mprehtë dhe disi e hidhur, e shoqëruar me një pickim diku pranë zemrës. M'u deshën disa çaste për t'u kujtuar plotësisht se ç'qe ai imazh: fjalët që kisha dëgjuar për mundësinë e një demonstrate. Nga kjo dhe u kujtova që i kisha thënë Agronit të më priste në shtëpi.

U vesha, i këputa edhe Lusit dokrrën se më dhimbte koka e se do të dilja të freskohesha dhe e mbajta frymën për te shtëpia e Agronit.

Lagjja ku banon Agroni është plot me shtëpi të vjetra, të ngjeshura pranë njëra tjetrës pa frymëmarrje, me rrugët e mbushura me grumbuj plehrash, me degë pemësh që varen mbi muret e barkosura prej qerpiçi, me notinë e rëndë të egrasisë e të kalbjes, me plot njolla drite të një dielli të vrarë në ato vende ku rrezet e tij arrijnë të depërtojnë. Tek ecja atyre rrugëzave të sklerotizuara, të spërdredhura si nëpër labirinthe, ku në çdo hap mund të ndeshje në qorrsokak, mendoja për njerëzit që banonin në ato shtëpi të ulëta, të rrëgjua nga pesha e kohës - shoferë, minatorë, tekstilistë, shitësa, mësues etj. etj. - që gdhiheshin e ngryseshin në një monotoni të llahtarshme, mendoja për fëmijët e tyre, djem e vajza të moshave të ndryshme, pra edhe të rinj të moshës sime, që jetonin nëpër ato skuta të zymta, në ato kuvli prej balte të tharë, të errta e gjithë lagështirë, duke jetuar vetëm me ëndrra, të cilat mbase qenë pak më me dritë se ato të prindërve të tyre për një jetë më të mirë e më të bukur, ëndrra nate, që u çanin gjumin më dysh nëpër ato zgëqe ku flinin ngjeshur me njëri tjetrin, po edhe ëndrra dite, teksa rrinin poshtë pemëve, poshtë pjergullave të hardhive të veremosura që e thanin rrushin ende pa u pjekur, apo në dritaret e ngushta nga ku, po qe se arrije të shikoje një copë qiell, do ta

quaje veten me fat. Një copë qiell që më shumë do t'i trishtonte se gëzonte. Sepse me bukurinë, kthjelltësinë dhe pafundësinë e tij do t'i bënte t'u mbahej fryma dhe ëndrrat t'u treteshin në eter ende pa çelur mirë pasi qielli i pastër dhe i pamatë ishte për ta sa një ngacmim joshës dhe turbullues, aq edhe i paarritshëm dhe tallës në pafundësinë dhe kthjelltësinë e tij. Ai s'qe veçse një qiell ëndrratretës. Ose i tillë që aq shumë i gufmonte, sa i bënte të pëlcnisnin. Pa krisma, por me agoninë e heshtur të vdekjes. Të pashpresshmërisë, që është e njëjta gjë.

Në qoshen e njërës prej rruginave të ngushta ngrihej imponante shtëpia dykatëshe e Agronit, një vilë e bukur e rrethuar me avlli të larta, me verandë, ballkon në katin e dytë, pjergull të shendetshme e të lartë, me një kopsht që zgjerohej anash saj plot pemë nga shikonin dritaret e mëdha me grila të gjelbra. Në të vërtetë shtëpia nuk i përkiste familjes së Agronit, por një armiku të klasës të persekutuar, shpronësuar dhe futur në burg. Babai i Agronit ishte marrë gjithë jetën me punë partie e pushteti, ndaj dhe ia kishin dhënë atë vilë që stononte shumë me ato karakteristika që sikur strukeshin të turpëruara prej saj.

6

Portën ma hapi vetë Agroni, që me të më parë, më pyeti mos kisha marrë vesh ndonjë gjë të re lidhur me demonstratën. Asgjë, i thashë. Sytë i mbaja ngulur te një boçe trëndafili të kuq. Një mrekulli që shpejt do të vyshkej, do të merrte fund.

- Më duket se është e vërtetë.

- Kush të tha?

- Alekoja, po edhe Bledari. Bledari prapë kishte dëgjuar. Kanë ardhur të dy.

Hymë në dhomën e Agronit. Edhe ai, po si unë, mëson dhe fle në dhomë më vete. Është e mobiluar thjesht, pa luksin e dhomës sime, por që prapë ta ka ënda të rrish, pasi është plot hapësirë e dritë, nga dritarja e së cilës duket deti i pafund i pemëve dhe çatitë me qeramidhe të përhitura të çative të shtëpive përdhese.

Përsëhëndeta Alekon dhe Bledarin dhe zura vend në kolltukun pranë dritares. Alekoja rrinte në këmbë me fytyrë të tendosur, disi të hakërryer e të përndezur. Bledari, i ulur kolltuk, rrinte këmbë mbi këmbë, pranë qoshes tjetër. Sikur nuk i erdhi mirë nga vizita ime,

kurse Alekos i shkëlqyen sytë. Me siguri po të mos i kishte ndodhur ajo ngjarja me kryqin në shkollë, do të fillonte nga humori, siç bënte zakonisht.

- Ç'thanë në shtëpi? - e pyeta.

- Mamaja u tremb, filloi të qante. Ka frikë mos më përjashtojnë nga shkolla. Edhe babi u shqetësua, por nuk besonte se mund ta bëjnë. Nuk kanë të drejtë të shkelin kushtetutën, tha.

- Të përjashtojnë që ç'ke me të! - u hodh Bledari. Ndërkohë nxorri paketën të ndizte një cigare. Në klasën tonë ishte i vetmi që e pinte duhanin rregullisht. - Kushtetuta ta jep vërtet të drejtën e besimit, po jo të ekspozosh objekte fetare.

- Alekoja nuk e ekspozoi kryqin, - ia ktheva, - nuk e nxori në sy të ndokujt. E mbante thjesht për vete, për hir të besimit vetjak. Besimi vetjak s'është i ndaluar.

Bledari lëshoi një shtëllungë tymi.

- Kontakti me çfarëdolloj simboli fetar s'lejohet askund, mor i dashur, aq më tepër në shkollë, ku të mësojnë ateizmin dhe të përgatisin si luftëtar kundër fesë. Kurse ky vete e bën të kundërtën. Kush ta fal këtë?

- Po ato revistat e tua që sjell në shkollë, lejohen? - e pyeta jo pa qëllim. - Edhe ty të mësojnë të luftosh ideologjinë e huaj.

Më pa me një shkrepëtimë inati në sy.

- As ato nuk lejohen, kush tha?

- Atëhere pse i sjell?

- Për qejf. Revista pornografike nuk janë.

- A, dashke të jenë pornografike! - ia ktheva. - Që të të rrasin brenda! Le që dhe po të duash s'ke ku i gjen, se nuk guxon t'i fusë njeri.

- Po ja që ka dhe nga ata që guxojnë. Unë e ti jo, po diku lart, në majë të piramidës... Kush i ndalon ata?

- Ej, po i jep gojës si shumë! - e qortoi Agroni.

- Tërhiqem, nuk kam informacion të saktë se kush i sjell, vetëm kam dëgjuar. Po që nga ato revista hyjnë edhe tek ne, mund t'jua vërtetoj që tani. Urdhëroni.

Futi dorën në xhepin e brendshëm të xhaketës dhe nxori një faqe dyshe të një reviste të ilustruar, siç m'u duk nga vendi ku isha ulur.

- Eja, - më tha. - Ejani dhe ju, - u tha Agronit dhe Alekos.

Agroni i uli sytë mbi revistë dhe u bë dyllë në fytyrë.

- Bledar, ç'drejqin ngatërrohesh me këto?! - tha i alarmuar.

- Vëri çelësin derës dhe na lërë rehat!

Agroni rrotulloi çelësin në derë dhe u afrova ngadalë. Çehreja e fytyrës i ndërroi, i hipi një i kuq.

- Ec, pra, afrohu! - i tha Bledari me sytë të picërruar nga kënaqësia që me siguri i shkaktonte mendimi se do të na bënte të na sillej mendja vërdallë.

- Ta shikojnë ata njëherë, - tha Agroni duke parë i trembur dhe në mënyrë pyetëse herë nga unë e herë nga Alekoja. Mirëpo nuk e mbajti fjalën, se shpejt shkoi pranë tij.

Më vinte plasje që Bledari ma kishte shëmbur sigurinë aty për aty. Desha s'desha (në fakt qejfi ma kishte) i shkova pranë edhe unë për të parë fletën dyshe që sapo kishte nxjerrë nga xhepi. Me një farë shpërfilljeje hakërruese u afrova edhe Alekoja.

I ngula sytë faqes së parë, që në të vërtetë kishte numrin 17. Pra qe e shkëputur nga një revistë. Ishin tre foto ku i njëjti çift, një vajzë dhe një djalë, kryenin aktin seksual. Pozicione nga më të çuditshmet, që s't'i merrte mendja. Fotoja e tretë, sidomos, të çmendte: femra mbi mashkullin, e kërrusur, kurse ai, në orgazëm, e shtrëngonte në bel ndërkohë që turinjtë i kishte futur në gjinjtë e saj.

- Hë, ç'janë këto? - tha Bledari me ton sfidues.

Nuk fola. Më vinte plasje edhe me Bledarin, po edhe që s'gjeja forca për t'i hequr sytë nga revista.

- Prisni, se ka akoma, - vazhdoi duke hapur faqet e brendshme.

O zot, ç'të shihje! I njëjti mashkull duke bërë dashuri me dy femra njëherësh, në pozicione që etiketa normale nuk lejon t'i përshkruash. Gjëra që asnjë djalë apo vajzë të moshës sonë s'do të ishin në gjendje t'i përfytyronin. Të tre personazhet të kapërthyer e të bërë lëmsh me njëri tjetrin në ekstazë. Tmerr.

Në dy faqet e tjera pamjet ishin edhe më skandaloze. Çiftet genë të tjerë, por fantazia e pozicioneve gjithnjë e pashterur. Merre me mend si duhej të kishte genë e tërë revista.

- Ç'thua, - më pyeti Bledari duke fikur bishtin e cigares në tavëll, - nuk të bëjnë të masturbosh?

- Çfarë? - pyeti Agroni me naivitetet. Alekoja dhe Bledari qeshën.

Agroni u bë flakë.

- Disa gjëra janë të tepruara, bile të neveritshme. Një njeri normal...

- Gjithë puna është se çdo njeri normal ka qejf që për disa

minuta të bëhet anormal, këtu është gjithë lezeti.

- Hë pra, - m'u drejtua mua, - t'u mbush mendja që të tilla revista hyjnë dhe tek ne?

- Bledar, mos u ngatërro me këto gjëra! - tha Agroni.

- I do robi i zotit, Gono! Dëgjoni, keni parë ndonjëherë film pornografik?

- Ku t'i shohim?! - tha Alekoja. - Televizori im nxin nga zhurmuesi, të vjen ta thyesh! Për UHF nuk kam as kanoçe, as antenë.

- Mirë, se ti e paske të tredhur, po ti? - më pyeti mua.

- Jo, - i thashë, - nuk shikoj. UHF-në e kam të patredhur, - përdora figurën e tij - po s'kam antenë. - Kush t'i lë antenat?

- Po të duash edhe e mban, - tha Agroni. Kisha vënë re se shpesh ai përpigëj t'i paraqiste më të buta kufizimet që u imponoheshin njerëzve. - Ja, ne e kemi antenën, ka dhe të tjerë që i kanë. Po të shikosh kafshërira të tilla?!...

Foli me aq naivitet, sa unë e Bledari ia plasëm gazit, po edhe Alekoja qeshi. Agroni u nguros, nga që nuk po e kuptonte përse qeshnim.

- Boll, - deshi të na qetësonte Alekoja. - Agron, unë po iki.

- Ku? - e pyeta.

- Atje pra, në shesh...

- Vërtet?... - e pyeta prapë, me vrull, dhe zemra sepse m'u ndrydh.

- Unë ta thashë mendimin tim, - iu përgjigj Agroni. Me siguri, para se të shkoja unë, do të kishin biseduar për demonstratën. - Ti si të duash, veç ta dish që është me zarar. Unë për vete do mësoj.

- Agron, po si mund... - Desha të shtoja si mund "të mësoh në një ditë të tillë", por heshta.

- Tmerr, - tha Bledari duke palosur fletën e revistës dhe duke e futur përsëri në xhepin e brendshëm të xhaketës. - Të rrish mbi libra kur njerëzve ka filluar t'u ziejë koka për të tjera gjëra.

- Ç'thua Agron, - e pyeti Alekoja si me një farë ndjenje faji, - nuk të mbetet qejfi?

- Pse? - e pyeta unë.

- E kishim lënë për të mësuar, por ka mundësi që sot të bëhet ajo që është folur...

Ndofta për herë të parë në jetën e tij Alekoja ishte gati ta linte të mësuarit, apo të paktën ta shtynte për më vonë, për shkak të një ngacmimi të ri, me siguri të papërjetuar kurrë më parë.

- Shkojmë dhe ne, Agron? - i thashë. - Sa për të parë.

- Po ç'na du... Ç'të them... - iu muar goja Agronit.

- Eja, - i tha dhe Alekoja. - Rrimë mënjanë, vetëm shikojmë ç'do të bëhet.

- U zhvidhosët? - ia pat Bledari. - Po sikur të kërcasë pushka?

Heshtëm. Fjalët e tij na ushtuan vërtet si krismë pushke. Edhe pse kishte filluar të merrej me ato revistat e huaja dhe flokët kishte filluar t'i mbante disi më të gjatë se të tjerët - gjë për të cilën ishte qortuar disa herë - Bledari, kur vinte puna të tregonte ndopak guxim përballë ndonjë gjëje "me spec", e tregonte veten burracak. Vërtet nuk këlthiste si Ilir Karaj kur dikush kishte shkëlur ndonjë "normë" por ama, kur i kërkohet fjala, edhe ai me Ilirin bëhej. Sa për sy e faqe, se në fakt ishte liberal, dhe mënjanë tallej me parimet që sapo kishte mbrojtur. Me siguri tashti kundërshtoi jo se i dhimbseshim ne nga që mund "të kërciste pushka", por mbase i dukej se implikimi ynë mund të prekte dhe atë. Mbase e kisha gabim, po kështu m'u duk.

- Se mos do të marrim pjesë, - i thashë. - Ne do të rrimë sa më larg.

- Si të doni, - tha Bledari dhe u ngrit. - Alekos epo hajde, edhe mund t'i lejohet të fusë hundët në gjëra të tilla, po juve ç'ju duhet?

- Se mos unë do të marr pjesë, - tha Alekoja i zbehur, duke parë herë nga unë e herë nga Agroni. - Do të shkoj për të parë, asgjë më shumë.

- Bukuri, shkoni, - tha Bledari. - Unë do shkoj në shkollë të shikoj provat e teatrit.

Diç më pickoi në zemër kur dëgjova ato fjalë. Nuk shkonte për të parë provat, se aq i bënte për prova e për teatër, po për Elonën. Elona kishte një nga rolet kryesore në dramën që po vinte në skenë shkolla. Ai e priste sa mbaronte dhe e shoqëronte. Me siguri nuk ishte aq budalla sa ta çonte drejt e në shtëpi, pa bredhur një copë herë me të dhe pa i hedhur duart. Mbase edhe e puthte. Për punë femrash qe usta, s'ia haje dot hakun.

U ngritëm e dolëm të katër në heshtëje, si të shoqëronim një të vdekur. Agroni ca më keq, sikur po shkonte vetë drejt vdekjes, aq qe prishur në fytyrë. Qe vërtet për t'u habitur sesi i ishte mbushur mendja të vinte edhe ai në shesh. Po ja për disa gjëra njerëzit jo gjithmonë iu përmbahen recetave.

Kishte filluar të binte mbrëmja dhe koha po freskohej. Nga ana e Dajtit qielli vinte si i blertë, me ca re ngjyrë rozë me gajtanë të

artë. Kopshti gufmonte nga aromat e jeshillëkut dhe të luleve. Hijet po dendësoheshin; në murin e lartë, pranë portës, krahu i varur i një kumbulle të mbushur me lule të bardha krijonte imazhin e një rrënje katrore. M'u përqeth trupi nga ajo figurë, ku dukej sikur jeta i kërkonte ndihmë matematikës për t'i gjetur rrënjën katrore diçkaje që kishte filluar ta mundonte prej kohe. Kur ndodhem papritur përballë simbolesh të tilla, unë bëhem pikë e vrer. Dëshpërohem pa masë, e humbas fillin.

Deri në rrugën që të nxirrte te shkolla ecëm pa folur, si të qemë nisur për të kryer një aksion të rrezikshëm. Bledari u nda nga ne dhe ktheu për në shkollë, katin e katërt të së cilës e shikonim që aty. Ne vazhduam drejt deri te Rruga e Dibrës. Në rrugë kishte lëvizje, sidomos grupe të rinjsh, që edhe ata me siguri shkonin drejt sheshit.

Nga kreu i rrugës së Dibrës filluan të lëshoheshin me uturimë disa makina me drita të ndezura. Qenë mikrobusë të policisë që morën kthesën me tërsëllimë për në rrugën e Barrikadave. Padashur shtrëngova Alekon te bërryli. Sapo makinat u larguan kapërcyem me vrap rrugën e Barrikadave dhe vazhduam të ecnim drejt sheshit, në të djathtë të Pallatit të Kulturës. Por s'kishim bërë veçse disa hapa kur papritur se nga del një grup policësh duke u sulur me vrap në drejtimin tonë. Sa hap e mbyll sytë na vunë në mes, me shkopinjtë prej gome në duar. Njëri na pyeti me zë të hakërryer:

- Ku shkoni?

- Në shtëpi, - iu përgjigja unë. - Pse?

- Marsh, kthehuni pas! - sokëlliti një tjetër, me një pamje edhe më të egërsuar.

Të hutuar e të mpirë u kthyem pas duke marrë majtas, përgjatë rrugëzës që i bie diagonalisht lulishtes që ndodhet prapa Pallatit të Kulturës e që të nxjerr në rrugën e gjerë nga ana e Bibliotekës Kombëtare. Nuk kishim ecur shumë kur dëgjuam disa zëra të pazakontë e të frikshëm të përzier me klithma, ulërima e gërthima të çjerra si dhe përzier me to, zhurmë hapash që vraponin me shpejtësi. Ishin një grup djemsh të lëshuar në pikë të vrapit, sa dy a tre prej tyre për pak u përplasën me ne.

- Ikni! - na tha njëri. - Mbathjani! - Dhe u zhduk sa hap e mbyll sytë.

Ngrimë në vend pa ditur ç'të bënim e pa kuptuar ç'po ndodhte. E morëm veten dhe u tërhoqëm menjëherë në drejtimin nga kishim ardhur. Prej aty pamë se djemtë i ndiqnin tre a katër sambistë, me

uniforma të tjera nga ato të policëve të zakonshëm, me parzmore transparente plastike, me kokore po plastike dhe me shkopinjtë e gomës në ajër, gati për të qëlluar. Njëri kaloi si vetëtimë mu fare pranë nesh, gjithnjë në ndjekje të dikujt. Aty ndaloi, duket gjahu i kishte humbur nga sytë. Kur na pa ne u afrua duke folur gjithë egërsi:

- Ku shkoni?

E humbëm krejt, nuk nxorrëm fjalë nga goja.

- Zhdukuni, se ju vdiqa! - foli përsëri dhe ngriti lart shkopin e gomës. - Qërohuni!

Që të tre, si me sustë, ia dhamë vrapit njëri pas tjetrit kuturu, me sa na hanin këmbët. Pranë basenit bri rrugës së Barrikadave Alekoja u pengua dhe ra. U sula ta ndihmoja, e kapa nga dora dhe bëra ta tërhiqja, e pikërisht atë çast një dhimbje therëse, e hidhur dhe e nxehtë si zjarri, më goditi supin e majtë aq fort sa nuk u mbajta dot dhe klitha. Thashë se më kishte kapur ndonjë plumb, ndonëse asnjë krismë nuk u dëgjua. Ktheva kokën vetëtimthi; në ajër pashë të vërtitej një shkop të zi, pashë dhe fytyrën e sambistit, e cila të kallte datën, aq e egërsuar qe, me xhamin e kokores të ngritur lart, gjë që e bënte edhe më të frikshme, gati jashtëtokësore. Sytë i shkëndijonin si gaca kurse dhëmbët i skërmiteshin si të qenit që bëhet gati të të sulet për të dytën herë. Mblodha forcat dhe arrita t'i shmagesha goditjes së dytë. O zot, të më kishte kapur do të më kishte lënë në vend, pa le të më kishte goditur në kokë, me siguri do të ma kishte çarë më dysh.

- O Krisht, si ke shpëtuar! - briti Alekoja që më priste disa hapa larg, i strukur pranë një peme. Ai brofi në këmbë dhe vazhduam vrapin. E mbajtëm frymën pranë shatërvanit. Kishte filluar të binte errësira. Atë çast llamburitën dritat e rrugëve dhe të lulishtes. Pamë rrotull për Agronin, nuk dukej. Matanë rrugës bri Pallatit të Kulturës, buzë lulishtes së vogël që kufizohet me rrugën e Sahatit, po ndodhte një katrahurë e vërtetë: disa sambistë godisnin me egërsi një grup djemsh, dy nga të cilët u shëmbën për tokë me britma. Djemtë e tjerë që arritën të largoheshin shkulnin pllaka nga trotuari - shumica e pllakave ishin të thyera dhe hiqeshin kollaj - dhe ua vërvitnin sambistëve. Disa nga copat e pllakave qëllonin në shënjë, kërcitnin mbyturazi në mburoja, por nuk arrinin t'i thyenin.

Nga sheshi, gjithë britma e ulërime, po lëshoheshin turma të

tjera duke vrapuar me tempe të ndryshme, herë-herë edhe duke u ndalur paksa për të parë prapa. Ndonjëri shante policët, i kërcënonte, e po të gjente ndonjë gur, e hidhte drejt tyre.

- Do t'ju zhdukim, o egërsira! - thirri dikush.

- Ku do të futeni, o këlyshët e Ramiz Alisë? Ku da ta gjeni brimën e miut? - u dëgjua një tjetër.

- O qen të regjimit, o kriminelë, mu këtu do t'ju varim!

- Si Çaushesku, si Çaushesku! - u dëgjua një britmë tjetër diku larg, por mjaft e fortë dhe kumbuese.

- O Shqipëri, që do të bëhesh Rumani! - këngëzoi dikush mu fare pranë meje dhe Alekos, që vazhdonim të rrinim si të mpirë e të gozhduar në vend. Aq brengë e pikëllim pati në ato fjalë sa ato çaste e harrova dhimbjen therëse të supit.

- Ikim! - më tha Alekoja me të shpejtë.

Nuk lëviza menjëherë, se e mbaja vështrimin të mbërthyer tek ata dy djemtë që sambistët i kishin shtrirë për tokë. Atë çast mbërriti furgoni i policisë; sambistët i ngritën peshë dhe i flakën në të.

Një turmë tjetër të rinjsh po vinte me vrap nëpër rrugëzën që fillonte te pjesa e pasme e Teatrit të Operas duke e mbajtur frymën pranë shatërvanit. Një trup u lëshua përtokë, kurse dy a tre të tjerë u ulën mbi të duke i folur shoku shokut me pëshpërima të nxituara:

- Shpejt ta lagim me ujë!

Dikush u përkul mbi shatërvan, mbushi grushtet dhe ia hodhi atij që kishte rënë. U dëgjua një rënkim i mbytur, i dhimbshëm, i përzier me fjalë të shkëputura:

- Na vranë! Oh!

Djemtë e ngritën peshë dhe duke e mbajtur ca nga supet e ca me krahët rreth belit, nisën të ecnin bashkë me të duke u çapitur. Në pllakat e bardha të mermerit spikaste një vazhdë pikash të kuqe, vende-vende aq të dendura sa piknaja kijonte një rrëke të hollë. Ishte vazhda e gjakut të djaloshit, që kushedi në ç'pjesë të trupit qe plagosur; ajo fekste trishtueshëm në reflektimin e dritave të neonta.

7

Me Alekon morëm rrugën që të çonte te Pazari i Ri e prej aty vazhduam përgjatë rrugës Hoxha Tahsin, derisa u futëm rrugicave.

Kalimtarët e rrallë ecnin të qetë, në ndonjë grup qeshnin e bënin shaka, gjë që na u duk absurde. Po s'kishin faj, ku mund ta dinin ata ç'po ndodhte në rrugët rreth sheshit "Skënderbej", e mbase edhe në shesh?

- Mirton, më mirë ik, - më tha Alekoja. - U bë errësirë dhe shtëpinë e ke larg. Pres unë për Agronin.

- Jo, - i thashë, - do pres edhe unë, edhe sikur gjithë natën të rri.

- E tmerrshme, - pëshpëriti Alekoja duke fshirë syzat me shami.
- Si godisnin ashtu? E pe gjakun te shatërvani?

- E pashë. Ai të paktën shpëtoi, ata që futën brenda mund ta pësojnë edhe më keq. - Heshta një grimë, sa u mbusha me frymë, dhe vazhdova: - Aleko, e gjithë kjo përpjekje mua më duket e kotë. Po u tentua përsëri për ndonjë demonstratë, regjimi mund të tregohet edhe më i ashpër.

- Po, - tha Alekoja i menduar. - Mund të ketë edhe gjak. Mund edhe të bëhet si në Rumani, siç thoshin në rrugë. Vetëm se... me çfarë çmimi do të paguhet ai gjak? A do të arrijë të çahet betoni? Ja, këtu është puna.

Ndjeva një përqethje në trup nga ajo pyetje. Në vesh më jehuan përsëri ato vargjet e rimuara që shprehnin edhe kërcënim, edhe dhimbje. Pyetjet e Alekos ishin me vend, po ç'përgjigje t'u jepja? Çdo gjë mund të ndodhte. Krisja kishte filluar, po sa do të zgjerohej e çara, sa e thellë do të qe dhe sa viktima do të thithte në gjirin e saj të errët kush mund ta dinte?

- Si na kanë mashturar kështu, Toni - vazhdoi Alekoja me dhimbje. - Për dyzetë e ca vjetë me radhë. Poshtërsisht, qenërisht... Na kanë ngopur me fjalë. Ç'falsistet i pështirë! Dhe pse? Që ata lart, duke filluar që nga diktatori...

- Pusho! - i thashë me një frymë ndërsa trupi m'u mbush me mornica. - Do të na dëgjojnë!

Fjala "diktator" më tmerroi, me të vërtet e them. Mundet që edhe unë ta kisha thënë ndonjëherë me vete, por pavetëdijshtëm dhe jo me atë urrejtje siç e kishte shqiptuar Alekoja.

- Jo. Se nga ai ka filluar e keqja. Ai, bashkë me klanin e tij, ka rrojtur si në parajsë. Kurse ne na kanë marrë shpirtin, na kanë mbyllur gojën, na kanë kërcënuar e futur nëpër burgje edhe për një fjalë. Dhe jo një e dy vetë, po një popull të tërë.

Heshti një grimë e pastaj, duke më parë në sy e si duke u kujtuar për diçka, shtoi:

- Nëse nuk je dakord, më fal, nuk flas. Po kështu mendoj. Edhe pse mbaja atë kryq, e që prapë do ta mbaj, unë nuk besoj aq shumë tek ai sesa tek këto që po them. Nejse, nëse nuk je dakord... Se ti ke bërë tjetër jetë...

- Jo se s'jam dakord, - fola mbyturazi. - Puna është se... Ti e pe vetë sa janë egërsuar...

- Ke të drejtë, Toni, po nuk durohet më. Po qe se do të organizohet ndonjë demonstratë tjetër - e kam fjalën nëse do të arrijë të bëhet siç duhet, se kjo dështoi, unë do të jem në ballë.

- Ti nga e more vesh se do të bëhej?

- Nga babai. Ia kishin thënë disa shokë. Po edhe ai nuk ishte i sigurt nëse do të bëhej apo jo. Sepse data ishte ndryshuar disa herë. Ty nuk të thashë sepse më porositi ta mbaja të fshehtë. Kështu ishte vendosur: do të njoftoheshin vetëm ata që nuk do të na shisnin, që ishin absolutisht kundër, kupton? Për ty nuk mendoja kështu, për Agronin jo e jo.

- Ke të drejtë. Edhe vetë e ndiej që jam një farë lëmshi... Në shtëpi askush nuk flet kundër, as babai, as mamaja.

- Dhe kanë arsye, - qeshi hidhur. - Ju jetoni... në mos si në bllok, të paktën aty afër, apo jo?

Më përcëlluan faqet. Kishte të drejtë, veçse unë dhe im atë, apo ime më, nuk ishim aspak e njëjta gjë.

- Aleko, dhe kalë karroce nuk jam, - ia ktheva shkurt. M'u kujtuan palldëmet, për të cilat më kishte folur Ardit. Me po atë gjuhë më foli edhe Alekoja, si ta kishte dëgjuar.

- Kush tha? Nuk them se je ashtu. Po qe se të preka, më fal.

- Jo, ke të drejtë.

- Unë do të të vija faj nëse nuk do të doje të kuptoje se shumica jeton në mjerim, në errësirën më të madhe dhe e shkëputur nga bota. Pikërisht për shkak të asaj klikë të poshtër.

- Aleko, nuk është teprim të flasësh për mjerim, errësirë?...

- Aspak. Nuk di nëse e pe një emision te televizioni jugosllav përpara ca kohe, ku u intervistuan katër djem shkodranë të arratisur. Ato ditë zhurmuesi qe dobësuar, mbase vetëm në zonën tonë, nuk e di. E pe, apo jo?

I thashë se nuk e kisha parë, dhe i thashë të vërtetën. Zhurmuesi edhe tek ne e nxinte televizorin - pa le zhurma e neveritshme që bënte - po babai kishte gjetur një teknik, që seç i kishte bërë televizorit dhe zhurmuesi nuk ndihej shumë. Emisionin për të cilin më pyeste Alekoja nuk e kisha parë, nuk e dija që do

të jepej. Babai më ndalonte të shikoja qoftë jugosllavin e qoftë italianin (në verë, kur hynte) por unë nuk pyesja; kur ai s'ishte në shtëpi e çoja ku të ishte figura më e mirë, pa e çarë kokën. Antenë për UHF-në s'kishim, dhe më vinte plasje. Për vete babai e hapte te stacionet që mua m'i ndalonte, ndonëse rrallë shikonte televizor.

- E pra, ata djemtë e arratisur... Të arratisur... - qeshi hidhur ai. - Shiko ç'fjalë ka hyrë në fjalorin tonë! Një fjalë akuzuese që çudi si nuk është ndaluar nga regjimi për të mos u përdorur. Se njeriu mund të arratiset nga burgu, apo jo? Nejse, ato që thanë ata djemtë qenë të gjitha të vërteta. Edhe pse edhe unë i dija ato, jo vetëm ato, por edhe gjëra të tjera, u trondita kur i dëgjova. Nuk është për t'u habitur - të tronditesh për gjëra që i di?! Mirëpo kështu më ndodhi, mbase ngaqë për herë të parë i dëgjoja nga ekрани, edhe pse në një stacion të huaj. I përpjia fjalët e tyre, singerisht ta them. Një shprehje nuk e harroj kurrë: diktatura na e vuri litarin në fyt që në fillim, po shtrëngimin e bëri më pas, vit pas viti, pa mëshirë, me egërsinë më të madhe. Kur filluan ta ndienim, kur filluam të kuptojmë se po mbyteshim ishte vonë, nuk e hiqnim dot.

Për një copë herë heshti. Kohë më kohë hidhnim ndonjë hap përgjatë rrugicës së ngushtë, të errët e të pistë. Hapat na kumbonin trishtueshëm në errësirën e stërpikur aty këtu nga ndonjë pllange drite që vinte prej ndonjë poçi të rrallë. Ishte një mbrëmje prilli e qetë tiranase, si qindra mijëra të tjera, një mbrëmje që mund ta quaje krejt të zakonëshme me atë heshtje fëshfëritëse zërash e hapash të largët, me të lehurat e ndonjë qeni, me ndonjë fragment muzike të huaj që mezi dëgjohej (volumi duhej ulur në atë masë sa muzika të mos bëhej e rrezikshme) e me ndonjë britmë fëminore e megjithatë ajo mbrëmje prapë ishte krejt ndryshe nga ato qindra e mijëra të kaluara, pasi vetëm kjo kishte qenë e mbushur me shpërthime ëndrrash, me zëra që këlthisnin në kupë të qiellit, me rrugët të mbushura me djelmosha që urrejten e kishin shpërthyer nën goditjet e përgjakshme të shkopinjeve të sistemit, të atij sistemi vetëpërligjës e të vetëpropaganduar si më i përsosuri, më i përparuari dhe më i miri në të gjithë botën. Ishte e habitshme, thuajse e pabesueshme, që në atë mbrëmje aq të zakonshme tiranase të përjetoje një përmasë të re, të paimagjinuar më parë përveçse nëpër ëndrra, e jo në ëndrrat e kujtdo, në ato të tim eti, të atij të Agronit, në të mijat apo edhe në të Agronit, po

në ëndrrat e Alekos, të atyre djelmoshave nëpër rrugët rreth sheshit "Skënderbej" e të mijëra të tjerëve si ata, që atë mbrëmje nuk ishin ndodhur në shesh. Ishte diçka e papërfytyrueshme, diçka që, edhe pse qe bërë pjesë e një realiteti që e kishim parë me sy, përsëri thoshe me vete "Mos pamë ëndërr? Vallë a kishin qenë të vërteta ato të vërteta?"

- Aleko, - pyeta pasi kishim bërë një copë rrugë drejt shtëpisë së Agronit, - flasini hapur prindërit me ty?

- Babai po. Mamaja ka frikë. Frikë për mua, kupton?

- Çfarë akuze konkrete i ngritën babait tënd, Aleko? Mos ma merr për keq që po të pyes.

- Aspak. I thanë se bënte agjitacion e propagandë, po nuk ishte kështu. Ai kishte mendimet e tij, por nuk i shprehte në ato që shkruante, në drama, skeçe apo në ndonjë artikull. I shprehte vetëm me ndonjë shok. Mirëpo ra në erë, e spiunuan. Se policia vë edhe provokatorë. Babai u besonte njerëzve.

- Po tani ç'thotë, Aleko? I urren ata që e burgosën?

- Më shumë urren sistemin se njerëz konkretë. Është sistemi ai që i pjell këta njerëz, thotë, që i kthen edhe në përbindësia. Ai thotë se komunizmi fillimisht qe ëndërr, pastaj eksperiment dhe në fund mashtrim, një mashtrim i tmerrshëm. Ana më e përbindshme e tij, thotë ai, është se komunizmi e shikonte thumbin helmues që po i rritej dhe në vend që ta priste, krenohej me të.

- Mos e tepron me këtë përcaktim, Aleko?

- Jo. Të paktën tek ne atë fytyrë ka treguar. Nëse ti mendon ndryshe s'prish punë, veç të lutem...

Pak i fyer e kapa nga krahu dhe i thashë:

- Aleko, po ç'më pandeh mua?

Nuk foli. Tashmë i qemë afruar shtëpisë së Agronit. Errësira e rrugicës u përshkua nga zhurma e disa hapave dhe zërave. Qëndruam në heshtje, pa frymë, të trembur mos na kishin përgjuar. Ishim trembur kot, se qenë dy kalimtarë, një burrë me gruan e dy fëmijë.

Me hapa të qetë ia afruam portës së madhe e të rëndë të shtëpisë së Agronit. Qëndruam përpara saj pa ditur ç'të bënim.

- Thua të ketë ardhur? - pyeta unë.

Mblodhi supet, pastaj tha:

- Edhe të pyesim s'është mirë, se po s'pati ardhur do të fillojnë ata nga pyetjet: ju dolët bashkë, ç'ka ndodhur...

- Presim edhe pak. Po qe se prapë s'vjen, do të sajojmë ndonjë rrenë.

- Toni, - tha vrulltaz Alekoja, - po sikur t'i ketë ndodhur gjë? Sikur ta kenë arrestuar apo plagosur?

- Nuk e besoj. Ti e pe, policët ndiqnin ata që qenë në grupe. E di ç'bëjmë? Shkojmë te posta dhe marrim shtëpinë e tij në telefon. Ka një postë këtu afër.

Pranoi dhe u nisëm, po s'kishim ecur shumë kur Agroni erdhi. Gati iu hodhëm në qafë. Nuk ngopej me frymë nga nxitimi dhe tronditja. Megjithatë na bombardoi me pyetje:

- Ku u zhdukët? Nga shkuat? Si u ndatë?

- Ne thoshim ku u zhduke ti! - iu përgjigjëm.

- Shyqyr që s'paski pësuar gjë! - foli i lehtësuar. - Se ku nuk më shkonte mendja! Kur s'ju pashë askund, mora vrapin gjatë rrugës së Valutës, poshtë pallateve me kolona. Ndalova dhe zura një qoshe. Prit e s'ka, u ktheva prapë në Rrugën e Barrikadave. Rrëmuja vazhdonte.

- Aty ishim, - tha Alekoja.

- E ç'rëndësi ka? - ndërhyra unë. - Shyqyr që nuk hëngre ndonjë shkop. Se mua akoma më djeg supi!

- Të goditën?! - u habit Agroni.

- Dhe çfarë të godituri! Mirë që nuk më zuri në kokë. Me siguri nuk ka dashur vetë. Le që do të isha në birucë tani.

- Dihej ajo, kështu do të ndodhte, - tha Agroni. - Policët bënë keq që qëlluan, po dhe të bësh demonstratë...

- Po si thua ti, t'i pijmë dollinë gjithë jetën këtij pushteti? - iu drejtua Alekoja i nxehur.

- Ohu, Aleko! Po sikur të kishin qëlluar me armë? I mirë, i keq, pushteti të shtyp kokën, e di ti këtë?

- Dakord, po si thua ti se mund të ndryshojë? Ose më mirë: si mund të përmbysset?

- E pse duhet përmbysur?

- Ohu! - ia ktheu Alekoja me nervozizëm. - Se është kalbur, ka marrë fund. Le që i kalbur ka qenë!

- Rri, Aleko, se nuk flitet ashtu! Ajo që donin të bënë ata, - ai tregoi me dorë në drejtim të qendrës, - është kundërrevolucion, e ke të qartë?

- Mirë, Agron, mirë, - tha Alekoja i mërzhitur. - Ti ke mendimet e tua, unë të mijat. Tani i japim fund, se shkoi vonë.

- Fundja në qoftë se duhen bërë ndryshime, ka mënyra demokratike, paqësore... - foli me një farë toni të zbutur Agroni.

- Pse, demonstrata ç'është? Kishin gjë armë njerëzit?

- Dëgjo, jemi në rrugë... - Agroni dukej i trembur, i hutuar. - Jam dakord, e lëmë. Se mund të ketë ardhur babi, dhe... Do të më falni, ë? Nuk ju mbetet qejfi?

- Çne, o Agron! - i thashë unë. - Ne pritëm të dinim ç'të kishte ndodhur!

- Matematikën do ta mësosh dot vetëm? - pyeti Alekoja.

Agroni mbeti një hop pa folur.

- Janë ato drejt ushtrime me yll... Po deshe eja dy minuta. Do të vish dhe ti, Toni? Ama për ato që pamë...

- Jo, Goni, po iki, - i thashë. - Se u bëra vonë. Për këtë... asnjë fjalë askujt, dakord?

- As që diskutohet! - tha Agroni duke parë rrotull.

Iu urova natën e mirë dhe nisa të ecja me nxitim gjatë një rrugice që të nxirrte te stacioni i autobusit të Medresesë.

Rrija ngjitur pas xhamit, me dorën pranë fytyrës që të shikoja më mirë jashtë. Njerëzit bisedonin ultas, vesh më vesh. Thua e kishin marrë vesh ç'kishte ndodhur para pak kohësh në rrethinat e sheshit "Skënderbej"? Kisha shumë kureshtje, por nuk mund të pyesja njeri.

Kur autobusi nisi t'i afrohej Pallatit të Kulturës zemra zuri të më rrihte me forcë. Lulishtja prapa tij kishte rënë fashë. Sheshi ishte krejtësisht i zbrazur, aq sa të vinte tmerr tek e shikoje ashtu. "Ifat" e sambistëve nuk dukeshin kurrkund. Tej, pranë përmendores së Enverit, dukej vetëm një mikrobus policie. Turma policësh, me shkopinj të nëpër duar, silleshin andej këtej, më shumë anëve të sheshit.

Autobusi nuk ndaloi në stacion, po diku prapa Muzeut Historik. Ora po shkonte shtatë e gjysmë. Mora vesh se stacioni i Tiranës së Re për sonte kishte ndryshuar, urbani nuk nisej nga vendi i zakonshëm, por që aty. Në kohën që u bëra gati të vrapoja për ta kapur frenova në vend: puna që se vendosa të mos shkoja në shtëpi.

Do të shkoja, tek Tomi, kllouni i cirkut. Mbase e gjeja në prova. Po që se kishte shfaqje nuk do ta prisja. Vërtet që ca si vonë, po qëllonte që e gjeje në cirk edhe në atë orë.

Dezhurni më tha se ishte në prova, gati në të mbaruar. Pas pak Tomi doli me një grup shokësh. I thirra. Sa më pa u nda me ta, më erdhi pranë dhe më përfshiu me atë trupin e tij të gjerë.

- Ç'erë e mbarë? - më pyeti.

- Kot, - thashë. - Je i lirë?

- Po, sa i dhamë fund. Si është puna?

- Asgjë, erdha për një dorë muhabet, ashtu. - I afrova gojën te veshi dhe i thashë si me të pëshpëritur: Para ndonjë ore te sheshi pati grumbullime, trazira... E more vesh?

Pashë se u interesua menjëherë.

- Po, për ato po bisedonim, - më tha me zë të ulët. - Ti ç'di?

- Ca skena i pashë vetë. Isha me dy shokë prapa Pallatit të Kulturës.

- Ashtu?! Pati grumbullim të madh?

- Nuk e di, nuk arritëm deri sheshi. Po ato që pamë... Tmerr!

Atë çast diçka vuri re se më tha me të shpejtë:

- Shsh!

- Pse deri kaq vonë në prova? - e pyeta me zë të lartë për të krijuar përshtuypjen se biseda ishte normale.

- Së shpejti do të nisemi në një turne, - m'u përgjigj duke më hedhur dorën në qafë. Dëgjo, hedhim ndonjë gotë?

- Me kusht që të të qeras unë, mirë?

Qeshi.

- Kur të mbarosh shkollën. Ose më mirë kur të jesh bërë aktor. Shkojmë te "Bodrumi"?

Nuk ia prisha. Tomi ishte i martuar dhe bënte jetë të rregullt familjare. Pinte ndonjë gotë, po nuk e tepronte. Shpesh i linte në mes ziafetet me shokët dhe kthehej në shtëpi. Nxitonte edhe kur kishte ndonjë film serial, se edhe ai se ç'i kishte bërë televizorit dhe e kishte zbutur zhurmuesin.

"Bodrumi" qe një lokal i nëndheshëm afër cirkut. Zumë një tryezë dhe porositëm konjak. Në atë lokal im atë nuk hyn kurrë, as ndonjë nga mësuesit. Gjithsesi vendosa të mos e çaja kokën, le të më shikonte kush të donte. Pas atyre që kisha parë atë mbrëmje doja ta ktheja një gotë. Le që kisha afro dy muaj pa dalë nga shtëpia pasditeve për qejf, dilja vetëm për ndonjë konsultim në shkollë apo tek shtëpia e Alekos.

- Pa hë! - më tha Tomi me zë të ulët.

Ula zërin dhe fillova t'i tregoja. Kur mbarova Tomi nuk foli menjëherë. Kaloi gati gjysmë minute kur uli kokën dhe pëshpërtiti:

- Do të krisë dhe këtu, s'ka tjetër. Po më mirë e lëmë këtë bisedë, s'është vendi, kupton? Ç'thotë shkolla?

- Nuk i kam mirë punët, Tomi. Në fizikë kam rënë për drej, kam marrë dy katra.

Më dëgjo vetullngrysur.

- Po si kështu? Pse? Për ty shkolla është kryesorja. Pavarësisht

se ç'ndodh, dhe po ndodhi s'do të rrimë indiferentë, kryesore për ty është shkolla. "Atje" - këtë fjalë e theksoi disi ndryshe - mirë bërë që shkove, po tek unë ç'erdhe? Duhej të kishe shkuar drejt e në shtëpi.

- E di, Tomi, po nuk më bëhej.

- Edhe për dy muaj fillon provimet, apo jo?

- Do t'i rregulloj katrat. Hajde, gëzuar! - i thashë dhe e ktheva gotën me fund. - Do të marrim dhe nga një tjetër, nga unë. Të lutem mos ma prish. Me para s'jam keq.

- Jo.

Iu luta, i thashë se po të pranonte do t'i tregoja një barceletë të bukur. Qeshi dhe pranoi. Ishte i thekur pas barceletave, si dhe Xhezairi, regjisori. Shkova vetë te banaku dhe u ktheva me dy gota.

- Hajde, - më tha. - Barceletën.

- Më fal, Tomi, nuk jam në formë. Barcelatat duan një farë gjendjeje... - Kisha filluar të trullosesha.

- Ama paske vendosur vërtet të bëhesh aktor! Aktori kapërcen çdo gjendje...

- Si s'kam vendosur? - Salla më vinte rrotull dhe zërat e njerëzve më vinin në vesh si zukamë bletësh. - Do të bëhem që ç'ke me të. Nuk i ngjaj Alen Delonit? Në shkollë kështu më thonë.

Vuri buzën në gaz. Këtë ma kishte thënë vetëm Elona, kurse gjasme ma kishin thënë edhe të tjerë.

- I ngjan, - tha. Por nuk dukej në qejf. E pyeta se ç'kishte.

- Edhe ne pamë një tmerr sot. Dësh na u vra një vajzë, gati ra nga dhjetë metra lartësi.

E pashë pa folur. Përpiqesha të përfytyroja ç'lëvizje të gabuar kishte bërë ajo vajzë.

- Kur pjesët mësohen mirë, bëhen pa mjete sigurimi, - tha Tomi.

- Se thelbi i cirkut ai është. Mirëpo edhe një mijë herë ta kesh bërë një numër prapë s'ke siguri. Eja ndonjë ditë të shikosh akrobatët në prova që të kuptosh sa e mundimshme është të mësosh diçka të re. Në shfaqje është ndryshe, të duket sikur i dinë vetiu ato që bëjnë. Eja, se do të të bëjë mirë. Çohemi?

Nuk dëgjonte të më linte të paguaja. E kam tmerr të paguajë tjetri kur e kam thirrur vetë. Janë disa që bëjnë sikur kanë qejf të paguajnë, por me vete thonë ishalla e ha tjetri. Kurse unë e kam me gjithë mend. Kur kamerieri më mori paratë e ndjeva veten krenar, sikur kushedi ç'kisha bërë. Punë dreqi me mua, nganjëherë ma ledhatojnë sedrën edhe çikërrimat.

Në kohën që po bëheshim gati të dilnim hynë me një farë nguti katër djem të rinj, pak më të mëdhenj se unë, që u ulën nga fundi. Dukeshin si të trembur, dhe derisa u ulën disa herë kthyen kokat nga dera. Njëri kishte një njollë mavi nën syrin e majtë. Unë e Tomi vazhduam të ecnim drejt daljes kur atë kohë hynë katër policë, të shoqëruar nga një civil, që zunë të shikonin nëpër sallë plot vëmendje. Pastaj, papritur, u sulën gjithë zhurmë për andej nga fundi. Ktheva kokën të shikoja ç'e kishin gjithë atë turr. E mora vesh brenda pak sekondash, pasi ngjarja rrodhi si në një film me xhirim të shpejtuar: policët u sulën mbi djemtë dhe u hodhën prangat dyve prej tyre. Dy të tjerët nuk i pranguan, por edhe ata i morën. A ishin edhe këta të arrestuar apo jo, nuk merrej vesh.

Zukama që sundonte në sallë u ndërpre, dhe qetësia që ra befas qe aq e thellë se dëgjohej edhe frymëmarrja. Një qetësi që u prish nga hapat e policëve dhe zhurmat e karrigeve që tërhiqeshin pas kur kaloi grupi i tyre me të arrestuarit.

Më shkuan drithma në të gjithë trupin. Ndofta arrestimi i tyre kishte lidhje me ngjarjet që kisha parë në rrugët përreth sheshit "Skënderbej". Se djemtë nuk dukeshin aspak si kriminelë ordinerë apo hajdutë. Asnjërin prej të pranguarve s'e kisha parë kurrë - që të dy simpatikë, njëri brun e tjetri bjond - e megjithatë fytyrat e tyre m'u dukën të afërta, madje të dashura, me atë si farë buzëqeshjeje krenare anash buzëve e me sytë që u shprehnin edhe pikëllim, edhe sfidë ndaj diçkaje që e dinin vetëm ata.

- Mirë ua bëjnë qenve! - foli një burrë kokëmadh e tullac, duke rrotulluar kapelen republike në duar. - Oj duan të na përmbysin! Ku ju çon mushka, more!

Askush nuk iu përgjigj. Vetëm se fjalët e tij rindezën zhurmat dhe bisedat. Të gjithë flisnin për çka kishin parë, kush duke bërë komente si kokëmadhi e kush në të kundërtën. Një pjesë s'dinin ç'të thoshnin, ende qëndronin në mëdyshje.

- Ikim, - më tha Tomi duke më tërhequr nga krahu.

E pashë në sy - fytyra e tij sikur qe tkurrur e ndrydhur, kurse thellë bebëzave bluhej një mendim, një dhimbje e fshehtë, e trembur për të dalë në sipërfaqe, po tepër krenare për ta fshehur ekzistencën e saj.

- Ç'po vete... - tha Tomi ndërsa ngjitnim shkallët nëpër gjysmëerrësirë.

Kokën e kisha ende të trullosur, po ajri i freskët në rrugë më bëri mirë. Tomi, megjithatë, më mbante nga krahu. Nuk më hiqeshin

nga mendja fytyrat e djemve me pranga në duar. Nuk di pse më qe fiksuar edhe ajo e civilit, me siguri spiuni, me atë gatishmërinë prej servili për t'u shërbyer policëve. O zot na ruaj nga spiunët, thosha me vete. Kisha dëgjuar që gëlonin nga çdo anë, po me sy s'kisha parë ndonjë. Ja, erdhi rasti dhe e pashë.

- Tani do të tërbohen më keq, - tha Tomi ndërsa nxitonim drejt sheshit "Skënderbej", - prandaj duhen hapur sytë.

- Me siguri tërë natën kanë për të bërë arrestime, - thashë unë.

- Sht! Ç'ulërin?! - më tha dhe më shtrëngoi krahun. U çudita, as që e kisha kuptuar se kisha ulëritur.

- Tmerr, Tomi, ë? Të arrestosh tjetrin pse nuk është dakord me ty...

Përfytyrova veten në shtëpi dhe një tufë policësh duke hyrë si të ndërkyer për të më hedhur prangat. Babai e ndiqte skenën syshqyer kurse mamasë i binte të fikët. Për një çast përfytyrimi m'u duk aq real, sa vërtet u tremba. Po sikur të më arrestonin edhe mua?

Tomi sikur e ndieua ankthin tim, ndaj bëri një pyetje krejt jashtë teme:

- Po për çupat ç'mund të na thuash andej nga shkolla?

Si të më kishte shtypur një buton zura t'i flisja për Elonën. Thosha duke m'u marrë goja se ishte vajzë e hatashme, alamet seksi, që më turbullonte sa herë e shihja. Kur jam pak i pirë unë i jap gojës shumë për punë vajzash. E kuptoj që këpus budallallëqe e megjithatë nuk e frenoj dot veten. Mbase nga që për punë seksi mund të flasësh më pa frikë. Sikurse kisha dëgjuar një djalë në gjimnazin tjetër që thoshte se e vetmja gjë që të lejohet me zë të lartë për vendet kapitaliste është t'u mburrësh futbollin. Të thuash, për shembull, përpara policit: "A, s'ka si Gjermania Perëndimore!"

Te stacioni i autobusit, ku do hipte Tomi, ndaluam.

- Po me atë tjetrën shoqërohesh? - më pyeti. E kishte fjalën për Selma Berklin.

- Jo, - i thashë. - Larg syve, larg zemrës. Megjithëse për një vajzë si ajo kjo formulë nuk pi ujë. Nuk gjen vajzë si ajo.

Tomi më shikonte me buzën në gaz. Pikërisht atë çast më hipi në tru të shkoja të takoja Selmën, vetëm që Tomit nuk ia thashë. Me siguri do të më merrte për të çmendur, mund edhe të mos më ndahej derisa të më shoqëronte në shtëpi. Por mua më kishte hipur për të për të takuar Selmën. E kisha nga konjaku a nga ç'dreq tjetër nuk e

di, po kur më hipën në kokë diçka, më hipën dhe pikë.

Tomi më përqafoi duke më thënë "hap sytë". I tunda dorën dhe u nisa përpara se të nisej autobusi. Aty pranë ishte një kabinë telefonike, këmbët më çuan atje.

8

M'u desh një copë herë të më kujtohej numri i telefonit të Selmës. Të atin e kishte a teknik a inxhinier avionësh. Formova numrin dhe prita; ndërkohë i hodha një sy orës "Sejko" që ma kishte bërë dhuratë im atë për Vitin e Ri. Ishte rreth tetë e gjysmë. Në telefon u dëgjua zëri i ngrohtë i Selmës: "Po, kush është?"

Përfytyrova si u hapën buzët e saj - buzë më të bukura nuk sheh kurrë te ndonjë femër, singerisht jua them.

- Jam Toni, Selma. Mirtoni. Ç'bën?

- Toni! - u habit ajo dhe qeshi lehtë. - Shyqyr që të dëgjova zërin... Ç'kemi?

- Dëgjo, a del për pak minuta?

- Tani?! - Zëri i saj tingëlloi vërtet i habitur. - Përse?

- Në telefon s'mund të ta them. Të të pres?

- Po jo... Sonte jo. E lëmë për nesër?

- Të lutem! - fola gati përvajshëm. - Dua të të takoj sonte. Tani. Po të pres, Selma. Thuaj, do të dalësh?

Dëgjohej qartë frymëmarrja e saj pak e shpeshtuar.

- Mirë, - tha më në fund. - Më prit përpara shkallës.

- Po, po! - i thashë me nxitim, nga frika mos i kthehej mendja.

Mbylla telefonin dhe dola. Balli më ishte mbushur me djersë. Ajrin e ftohtë e ndjeva si brisk, gjë që më kthjelloi disi.

Ecja dhe mendoja për të. Nuk kishim ndënjur në një bankë, por kishim patur shoqëri. Ishte vajzë e zgjuar, me humor, me shije. Shijen ia pikasje në çdo gjë, në veshje, në të mbajtur të vetes, në shkrim, në rregullimin e stendave të murit e ku di unë. Qepte bukur, po mbi të gjitha dinte të krijonte modele. Vajzat gjithnjë i kërkonin mendim për ndonjë model fustani a bluze, po Selma rezervohej. Kishte frikë se i hapeshin telashe, jo po është i modës së huaj, i papërshtatshëm për estetikën tonë revolucionare e këso gjërash. Në vit të parë i kishin hequr vërejtje për një bluzë a fund, s'e mbaj mend, dhe ajo s'e kishte veshur më. Kishte dorë edhe për pikturë, qe krejt e veçantë në ngjyra e forma, po nuk kishte

ndërmend të merrej me pikturë, donte të vazhdonte për elektronikë. Mua ma kishte thënë përse, kishte frikë se një ditë apo tjetrën do të binte brenda me pikturat, do të dilte jashtë kornizave dhe do ta merrte lumi. Dhe kishte të drejtë, se një vajzë aq e ndjeshme dhe me atë sens të jashtëzakonshëm për format dhe ngjyrat doemos do të dilte jashtë kornizave.

Kisha shumë kujtime me Selmën. Sidomos nga viti i tretë, i fundit për mua në atë shkollë, kur dhe qemë afruar shumë me njëri tjetrin. Një herë, kur kishim shkuar në një aksion për të mbledhur misër, papritur na zuri shiu në mes të arës. Vraponim e vraponim të gjithë duke bërtitur e duke u pllaquritur nëpër pellgje. U dyndëm hyrrja-byrrja drejt disa kasolleve të vetmuara në mes të fushës. Unë e Selma u gjendëm të ulur pranë e pranë, të dy të bërë qull. Shpejt ndjeva trupin e saj të ngrohte timin. Po më e ngrohtë qe diçka tjetër, nuk e di çfarë po diçka vërtet e bukur, diçka si një rrjedhë e prajshme që buronte prej diku thellë brenda meje. Pikërisht pse pranë kisha Selmën, që fërgëllonte e shtrydhte flokët pa folur e pa m'i ndarë sytë, me buzët lehtë në gaz, përmes të cilave, në mugëtirën e kasolles, dhembët i ndrisnin si perla.

Një herë tjetër, por në vit të tretë, e gjej fill vetëm në klasë, të ulur në bankë e duke qarë. Sapo kishte dalë nga klasa mësuesi i fizkulturës, një djalë i hedhur. Nuk di ç'kishte ndodhur midis tyre pak çaste përpara se të hyja unë që ajo qante. Apo dhe ai e kishte gjetur duke qarë, kush e di. Iu afrova dhe e pyeta ç'kishte, nuk m'u përgjigj. Madje as që ngriti kokën. Nga jashtë vinin zërat e shokëve që thërrisnin njëri-tjetrin. Eja, i thashë, kemi fizkulturë. Prapë s'reagoi, vazhdonte të qante mbyturazi. Të mos shihje pikat e lotve mbi bankë do të kujtoje se qe duke u menduar mbi ndonjë problemë. Iu ula pranë, nuk lëvizti. Bëra t'ia drejtoja kokën nga ana ime, nuk më la. I preka pastaj një tufë nga fokët e dendur, një pyll i vërtetë flokësh ngjyrë gështenjë që gjithnjë kishin një aromë dehëse e që i lëshoheshin mbi bankë të harlisur, me misterin e dhimbjes së saj në mes. Prapë nuk lëvizti. Pastaj, as vetë nuk e di pse, i afrova fytyrën fare pranë, i zhytur në butësinë e flokëve të saj. As këtë herë nuk lëvizti. Nuk di sa kohë ndënjëm ashtu, pranë e pranë, me faqet të puqura, krejt pa folur. Kjo kishte qenë hera e dytë, pas asaj të aksionit, që qemë afruar më shumë me njëri tjetrin. Hiq atë rastin në plazh, që kishte qenë kulmi.

Eh, Selma. Në pushimet e vitit të tretë qëlluam në të njëjtën

periudhë në plazh, ajo në "Iliria", ne në "Hekurudha". Takoheshim shpesh paradite, po edhe pasdite. Ishte nga të paktat vajza që hidhej nga trampolina, dhe hidhej bukur. Me kokë, tamam si zhytëse. Para se të hidhej i jepte kokës paksa lart, si të fiksonte një pikë në qiell. Një natë shkuam në kinemanë verore që ndodhet në "Iliria". Pas filmit, si duke lozur, filluam të ndiqnim njëri tjetrin. Kur mbërritëm te rëra se nga m'u zhduk. U lodha duke e kërkuar dhe thirrur, nuk e gjeta. Thashë se do t'i kishte shkrepur të shkonte në kabinën e saj pa më përshëndetur, kur ajo më del befas përpara nga prapa trungut të një pishë, nga s'e prisja fare. Unë u tremba, kurse ajo u shkri në gaz. Për një çast mbeta i hutuar, pastaj, krejt papritur, i kapa të dyja duart dhe e ngjesha për trungut të pishës, pa ia ndarë sytë. Ishte aq qetësi sa dëgjohej vetëm oshëtima e detit dhe tingujt e një orkestre dikur larg. Rrinte pa lëvizur, pa m'i ndarë sytë. Shikoja si i hovte gjoksi përpjetë nga frymëmarrja e shpeshtuar. Ia vura duart mbi supe dhe ngadalë, fare ngadalë, afrova fytyrën tek fytyra e saj, me vështrimin të fiksuar në fillim tek sytë e pastaj tek buzët, që ngjanin vërtet, jo për krahasim, si dy gonxhe të hapura nga ato të trëndafilëve në ngjyrë të kuqe të errët. Në kohën që gati po e puthja ajo, me një zë të mekur, më tha: "Mos." U stepa. Më vonë më vinte plasje, mendoja se nuk do ta kishte patur me gjithë mend atë pjesëz urdhëruese "mos". Së cilës as vetë nuk e di pse i isha bindur. Dhe që kishte qenë vërtet gomarllëk. Ajo e kishte dashur atë të puthur, edhe pse kishte thënë "Mos." Kaq gjë duhej ta kisha kuptuar. Po ja që ne, djemtë, nuk i kuptojmë vajzat gjithmonë. Ose më mirë në disa momente.

Eh, vajzat. Një pjesë e qenies së tyre për ne, djemtë, gjithnjë do të mbetet enigmë. Sidomos kur fjala është për një vajzë si Selma, që ka një botë aq të komplikuar.

Vajzë e rrallë, për besë. E vetmja në klasë që pas shpjegimit ishte në gjendje ta thoshte mësimin pa asnjë gabim. Që nuk dije të thoshe se në cilën lëndë ishte më e mirë. Dhe që kishte atë buzëqeshje të rrallë e të bukur dhe atë ndriçim të fytyrës kur gëzohej si asnjë vajzë tjetër. Dhe që shpesh do ta shihje me ndonjë lule në dorë, dhe që nuk ta jepte kurrë po t'ia kërkoje. Kurse, kur nuk e kishte mendjen, ta linte në dorë dhe zhdukej.

Selma. Diskutonte më bukur nga të gjithë për librat e filmat. Edhe në mendime ishte e avancuar, shumë më e avancuar se unë. Vitin e kaluar, aty nga maji, kishim bërë një ekskursion në Durrës. Mu në

qendër të qytetit na tërhoqën vëmendjen disa karikatura dhe fotografi që u kishin vënë disa të rinjve për shkak të veshjes së tyre "sipas modës së huaj". Selmës i mbetën sytë te fotot e dy vajzave fare të reja që i tallnin se ishin veshur me minifund. "Çudi, - më tha mua mënjanë, - njeriu del në dritë nga pafundësia e errësirës për të jetuar vetëm një grimë në krahasim me pafundësinë e errësirës ku prapë do të futet, por edhe kaq sa jeton e detyrojnë të jetojë në errësirë..." Kaq kishte thënë dhe kishte heshtur. Vetëm më vonë e kisha kuptuar sesa shumë kishte thënë.

Selma. Kishte filluar të lexonte edhe anglisht, vetëm se për këtë nuk e hapte gojën kurrë. Se kishte frikë. Vetëm unë e dija që lexonte anglisht, dhe vetëm me mua diskutonte ndonjë gjë që i kishte bërë përshtypje në ato libra.

Ja, për këto po mendoja gjatë rrugës deri tek pallati i saj, madje edhe gjatë atyre pak minutave deri sa doli. Kishte veshur një fustan ngjyrë lejla dhe një xhilé deveje të gjatë që i shkonte shumë. Flokët i kishte lidhur pas me një kordele, jo siç i mbante kur vinte në shkollë, të gufmuar rreth qafës. Në çastin që e pashë pata një drej shkrepjeje për ta përçafuar, aq më kishte marrë malli. Dëshirë absurde, vërtet. Më parë kjo dëshirë nuk më lindte kurrë me ta parë, po vetëm kur afroheshin shumë. Por ndjenjat janë punë dreqi, s'i merr vesh. Vetëm atë çast kuptova sa shumë e kisha ndier mungesën e saj. Kur më erdhi pranë e më dha dorën m'u duk se, përveç kureshtjes për të ditur përse e kisha kërkuar me aq ngulm, edhe atë e kishte kaplluar një ndjesi malli. Mbase s'qe e vërtetë, po ashtu m'u duk. E vërteta është se në dritën e mugët që vinte nga hapësira e shkallëve të pallatit pashë se sytë e saj ndriçonin me një rrezatim të ngrohtë. Si gjithmonë kur takoheshim, ishte më gazmore se unë.

- Zogu i mërguar! - tha. - Ç'është kjo urgjencë? - Dhe qeshi.

Tek i shtrëngoja dorën, krejt papritur, pa kurrfarë shkak, m'u fanitën përpara syve ngjarjet e asaj mbrëmjeje, shkopinjtë e policëve, gjaku mbi mermerin e shatërvanit... As vetë nuk e di pse përfytyrova edhe Selmën atje, krahas meje. Nuk e di, do të kishte ardhur vallë? Krejt i përhumbar ia shkunda dorën disa herë të mira - gjë që e urrej - pa ia shqitur sytë fytyrës së saj.

- Toni, ç'është? - më pyeti me një farë shqetësimi. - Ç'ke?

- Dëgjo, - u shkunda unë, - bëjmë një shëtitje të vogël?

- Shëtitje?! O, jo! Akoma s'i kam mbaruar mësimet. Po ti?

As mësimet kisha bërë dhe as referatin që duhej t'ia çoja mësuese

Lumturisë të nesërmen.

- Jo, Selma, as që i kam filluar. Por do të rri deri vonë e do t'i bëj. Ecim pak?

- Po në shtëpi ç'do t'u them?

Befas u ftillova - a e dinte ajo ç'kishte ndodhur sonte rreth sheshit "Skënderbej"? Me siguri jo, ndryshe s'mund të ishte aq e qetë.

- Selma, po mbase sonte prindërit nuk duhet të të kërkojnë aq shumë llogari... - Ajo u bë gati të më pyeste me siguri "përse", por nuk e lashtë të fliste. - Nuk e di ç'ka ndodhur?

- Jo, - tha ajo duke ma ngulur thellë vështrimin e syve të saj tmerrësisht turbullues, tmerrësisht të bukur. - Çfarë?

- Dëgjo, kishe dëgjuar ti të flitej se do të bëhej një demonstratë kundër pushtetit?

- Jo, - tha ajo dhe ngriu, me bebëzat e syve të zmadhuara nga tmërri. - Kur është folur?

- Unë sot e dëgjova, në shkollë.

- Edhe? U bë?... - pyeti me vrull, duke e pritur përgjigjen me ankth.

- S'ka ardhur këtej lajmi ç'ndodhi sot pasdite rreth Pallatit të Kulturës?

- Jo pra, - tha ajo me një zë të mekur dhe diçka u drodh në vështrimin e saj, mbase në gjithë qenien e saj. - Çfarë?

Pa e zgjetur nisa t'i tregoja ç'kisha parë e përjetuar atë pasdite bashkë me dy shokët e mi. Si për inat fjalët nuk më rridhnin, ngatërroheshja, emocionoheshja, këputja fillin e mendimeve. Ajo më shikonte me një farë mosbesimi, madje dy tri herë më ndërpreu:

- Fantazira! S'ka mundësi!

Kur ma përsëriti edhe një herë u nxeha.

- Kujton se po trilloj? A mund të trillojë njeriu gjëra të tilla? Unë e pashë gjakun me këta sy, Selma, - vazhdova me vrull dhe vura dorën te sytë. - As një lunatik nuk do të mund t'i trillonte dot. As prindërit e tu nuk e dinë?

- Babi sa erdhi në shtëpi, nuk tha gjë... Në të vërtetë m'u duk më ndryshe nga herët e tjera, po thashë se do ta kishte nga lodhja. Mbase e ka marrë vesh. Kurse unë e mami nuk kemi dalë fare, dhe asnjë nga komshinjtë nuk na tha gjë. Ndofta edhe ata s'e kanë marrë vesh.

- Ose kanë frikë të flasin.

- Ta dijë babi që ti ke qenë atje dhe unë rri e flas me ty...
- E di. E ke të fortë babin ti, me parime! Si ai imi!
- Posi! Ta dish ti ç'këput... Po jashtë shtëpisë është krejt ndryshe.

- Si shumica e shqiptarëve, - qesha hidhur. - Një fytyrë për në shtëpi, një për jashtë saj. Fytyra që u ngjajnë maskave të teatrit të lashtë grek.

- Vërtet qëllonin me shkopinj, Toni?... - Ajo më kapi nga mënga dhe më tundi dorën fort. Kur ishte e paduruar për ndonjë gjë gjithnjë ashtu bënte, më shkundte nga mënga.

- Po, pra! Çudi si në shkollën tuaj nuk është folur fare për ç'mund të bëhej sot!

- Mund dhe të jetë folur, po mua askush nuk më tha. - Pashë që u duk disi e prekur. - Kujtojnë se meqë babai im punon në aviacion dhe është komunist, është një nga styllat e sistemit e po si ai jam edhe unë. Dëgjo, po parulla hidhnin?

Ajo sa vinte elektrizohej, donte të dinte me hollësinë më të madhe.

- Ç'parulla! Atje kërciste shkopi, arrestimet... Nëqoftëse e ke fjalën ç'bërtiste njëri këtu e tjetri atje është tjetër punë, thoshnin "Si Çausheku!" ose "Shqipëria si Rumania!

Për një copë herë qëndroi në heshtje, e menduar, me vështrimin diku poshtë. Pastaj, papritur, pyeti:

- Thua se do të tunden këta, Toni?

- E dëshiron ti një gjë të tillë?

- Ç'pyetje! Para disa ditësh lexova disa poezi greke. Nuk më hiqet nga mendja sidomos njëra, me titullin "Duke Pritur Barbarët". Është një mrekulli, Toni! O zot, mjafton të vijë dikush, të ndodhë diçka, të thyhet ajo monotoni e pafund. Është dhe një tjetër me titullin "Muret", një mrekulli edhe ajo. Dëgjoje, e kam mësuar përmendësh:

*Pa pikë kujdesi, pa mëshirë, pa turp
Rreth meje muret ngritën gjithë gur.*

*Dhe midis tyre i gjendur unë tani
S'mendoj gjë tjetër veçse këtë zi.*

*Kaq punë më presin jashtë muresh, atje.
Por kur i ngritën, qysh s'i vura re?*

*S'dëgjova as çekiç as zhurmë, asgjë.
Nga bota tinëzisht më ndanë përgjithnjë.*

Mbeta si i ngurosur. Poezia m'u duk vërtet një mrekulli, një ankim i dhimbshëm, pa zhurmë, i një zemre që ia kanë vjedhur lirinë pak e nga pak... Tamam si tek ne. O Zot, ç'përkim i jashtëzakonshëm! Si të qe lindur e rritur në mjedisin tonë ai poet... Ç'thosha dhe unë, diktatura kudo një fytyrë ka.

- Selma, bëjmë dy hapa, lëvizim pak.

- Do të vonohemi! Dëgjo, ke pirë ndonjë gotë? Se vjen era raki.

- Vetëm një. Rrallë mund të pi ndonjë gotë, Selma, por sonte...

Më pyeti ç'mendonin në shkollë për këto gjëra dhe i tregova gjithë ç'dija. I tregova edhe për peripecitë e Alekos me atë punën e kryqit. Pashë që u trishtua për Alekon, ndonëse s'e njihte. I tregova për Ilir Karajin, Bledarin, Agronin. Vetëm për Elonën nuk i fola. Jo për gjë, nuk kishte ndonjë gjë interesante për t'i treguar.

Dolëm në rrugën e gjerë ku kishte një farë gjallërie. Njerëz që ecnin të ngeshëm apo nxitonin trotuareve, në atë sfond të trishtuar, shtypës. Një gjallëri e vdekur, e mpitë, ku njollat e pakta të dritës ta shtonin dhimbjen, pasi e nxirrnin më në pah pushtetin e errësirës. Megjithatë me Selmën ishte bukur, me të përkrah mund të ecje deri në fund të botës. Mirëpo nuk duhej të rrija i heshtur, vajzave si Selma s'u pëlqen heshtja. Ato nuk kanë qejf të flasin, por të dëgjojnë. Dhe dëgjojnë me interesin më të madh. Nuk ka nevojë të jesh gojtar i zoti për t'i bërë vajzat si Selma të të dëgjojnë me kënaqësi. E rëndësishme është vetëm një gjë: kush je ti për to. Po qe se nuk u ngjall interes le të jesh gojtar i shkëlqyer sa të duash - ato, sa të hapësh gojën, kushedi ku e çojnë mendjen. Kurse, kur kanë simpati, për ty mund t'iu thuash edhe dokrra e prapë të dëgjojnë me qejf. S'ke ç'i bën, kështu është me këto tipe vajzash.

Arritëm pranë një bufeje që dikur e frekuentonim shpesh e që Selma ia kishte ngulur vështrimin pa e pasur mendjen. Të merrte të qarët kur e shikoje, sidomos në darkë, me atë varfëri raftesh, me muret e rrjepura dhe ato dy drita të dobëta e të verdha, si sytë e një të sëmuri nga verdhëza. I thashë se do ta qerasja me një pastë. Jo, më tha, nuk dua. Kam dëshirë, mos ma prish. Po nuk dua, pra! Selma, kjo bufe më kujton kohët e dikurshme. Ty, jo? Eh, Toni! Sa herë kemi ardhur këtu kur kishim orë pushimi? Po, Selma, kemi

ardhur kaq herë. Të them të drejtën kjo bufe gjithnjë më kujton ty. Edhe mua ty, Toni. Atëhere prit dy sekonda, dua të ta forcoj këtë kujtim... Po s'është nevoja, Toni, se edhe pa këtë... Më mirë ikim, se kush e di ç'do të mendojnë në shtëpi. Kaq shpejt? Sonte është një natë krejt e veçantë, Selma, nuk e ndien? Sikur duhet të festojmë diçka...

Ajo vuri buzën në gaz trishtueshëm. Hyra në bufe dhe kërkova ndonjë ëmbëlsirë, pastë, ç'të ishte. "Pastë?!" u habit bufetierja. "Në mëngjes dhe mezi gjen!" S'ishte për t'u habitur, dyqanet varfëroheshin çdo ditë e më shumë. U ktheva te Selma duarbosh.

- Nuk thua shpyqyr që të paktën kemi bukë, Toni?

E kapa nga krahu butë, nuk lëvizti. U ndjeva i turbulluar, dhe ajo ndjenja për ta përqaftuar më kaplloi përsëri. Aroma që buronte prej saj, po sidomos ajo si aureolë e padukshme që e rrethonte, gjithnjë më mrekullonte.

- Selma, e di? Me dikë dua të bisedoj pa pushim, aq më tepër me ty.

- Toni, po nuk është koha! Të lutem, kthehemi.

- Edhe dy minuta, mirë?

- Si po shkom me mësimet atje?

- Në matematikë e fizikë jo mirë.

- Prapë... Po babai prandaj ta ndërroi shkollën, që të dilje mirë edhe në to, apo jo?

- Se mos kishte faj shkolla. Nuk më bëhet t'i mësoj ato lëndë, kjo është e gjitha.

Tani po kalonim pranë kinemasë ku kisha parë disa filma me të. I hodha një sy afishes, "Vrasje në gjueti". Më kishte lënë mbresë ai film, bënte përpjekje për të thënë diçka larg shtampave.

- Toni, po deshe mësojmë bashkë. Si dikur...

I hodha një vështrim me bisht të syrit. Në shprehjen e fytyrës së saj pashë mallin për atë kohë të kaluar. Vërtet, kishte qenë një kohë kur mësonim bashkë në shtëpinë e saj. Sidomos vitin e tretë. Edhe atëhere ajo e kishte propozuar. Kur kisha rënë shumë në ato lëndë.

- Jo, nuk është nevoja. Do të shkundem dhe do ta marr veten. Ti si gjithnjë me dhjeta, apo jo?

Nuk foli. Po të më përgjigjej do të dukej sikur po mburrej.

- Toni, vazhdon ta kesh dëshirën për artin dramatik?

- Po. Më është ngjitur si sëmundje, dreqi. Veç që nuk do babai. Ma ka prerë shkurt, o të marr mjekësinë, o s'ka. Rrimë pak këtu?

U mbështeta pas një peme, përballë saj, dhe e kundroja në heshtje. Në fytyrë i binte një pllangerë nga drita e rrugës duke ia nxjerrë më në pah. Më erdhi ta tërhiqja pranë vetes dhe të rrinim ashtu derisa të harroheshim. Ishte një mendim i marrë, sigurisht. Ajo rrinte me mua për të mos ma prishur, se mendja i punonte te mësimet. Apo edhe te ngjarjet e asaj pasditeje, për të cilat i kisha folur. Mbase edhe për mua, por pa i pasur dëshirat e mija. Se unë, sa herë rri me të, ngacmohem për drejt. Freskia dhe ëmbëlsia që buron prej saj më trullos dhe duhet ta mbaj veten me zor për të mos bërë ndonjë marrëzi, si fjala vjen ta puth papritur. Në mos ta puth, t'i prek pakëz gjoksin e hedhur. O zot, ç'gjoks që ka! Të fryrë e aq të hijshëm sa të vjen të ngjeshësh buzët. Apo t'i prekja pakëz kofshët, përmbi gjunjët. Se edhe kofshët i ka të mrekullueshme. Ah, si ia përpija me sy kur dilte për fizkulturë apo kur ishim në plazh! Si të derdhura, për besë. Jo krejt të bardha, siç i kanë disa vajza, po me një ngjyrë e formë të hatashme, të lëmuara, me një si push të imtë që të vinte ta nuhatje. Shkurt, trup më seks se të saj nuk gjen.

Aq isha i përpirë në kundrimin e tërë qenies së saj sa pa e kuptuar as vetë sesi, i vura dorën tek supi duke e rrëshqitur pakëz poshtë. Gishti tregues preku paksa lëkurën e bardhë të një pjese të gjoksit. Në fillim ajo sikur ngriu, pastaj fërgëlloi e tha me zë të mekur:

- Mos...

Desha të pëshpëritja "Selma..." Nuk munda, nuk nxora fije zëri. Ajo vuri dorën tek dora ime, ma shtrëngoi për një çast, pastaj ma uli.

- Toni, jo kështu, - tha. - Nuk duhet...

- Selma... - i pëshpërita. Duket ishte vonë, çasti i duhur kishte ikur.

- Ikim Toni. Mirë?

- Si të duash. - Isha mërzitur si drejt ngaqë nuk u tregova më i shkathët. T'i kisha dhënë një të puthur dhe aq. Asgjë tjetër.

U nisëm rrugës së kthimit duke ecur më shpejt. Papritur më pyeti:

- Ke ndonjë shoqe atje?

Iu përgjigja aty për aty:

- Po.

- Është e bukur?

- Shumë. Po jo sa ti.

Kafshoi lehtë cepin e buzës. Pastaj, me një farë pulitjeje të syve, ma ktheu:

- Mbase, po mos është më tërheqëse?

- Se ti? Kurrë! - vazhdova me duf. - Po ty, Selma të është qepur ndonjë djalë?

Qeshi. Dhe më hodhi një vështrim aq përkëdhelës sa, ju betohem, m'u mbajt fryma. I rrëmbyer nga një dalldi e befasishme i kapa dorën. O zot, sikur prej saj nisi të shkarkohej një rrymë duke më kaluar drejt e në thellësi të zemrës. Nuk bëri asnjë përpjekje për ta shkëputur. Vazhduam të ecnim ashtu, të kapur për dore, deri pranë shtëpisë së saj. Pothuaj të gjithë rrugën e bëmë të mbështjellë nga heshtja. Nga një heshtje e bukur dhe e ngrohtë, që gjithsesi fliste. Lusja zotin të mos ma shkëpuste dorën, atë dorëz delikate me gishta të hollë.

Para se të ndaheshim i thashë:

- Do vij të të takoj prapë, mirë? Të shkojmë në kinema, teatër, ku të duash. Ë, Selma?

- Shohim e bëjmë, po më parë më merr në telefon. Veçse...- Rregulloi paksa bluzën, pastaj flokët, dhe vazhdoi: - ... duhet të bësh çmos të përmirësohesh në matematikë e fizikë. Më jep fjalën?

- Po. Patjetër. Megjithëse... - Në sytë e saj pashë një hije shqetësimi dhe m'u mor goja. - ... mësueset që kemi në ato lëndë... janë tepër të rrepta. Po kjo s'do të thotë që s'do të përmirësohem.

- Atëhere, natën e mirë.

- Rri dhe pak, Selma. Të lutem!

Pashë se iu drodh lehtë njëri çip i buzëve.

- Jo. Edhe kaq, e teprova.

Më zgjati dorën duke më parë drejt e në bebëzat e syrit. Ia shtrëngova dhe e tërhoqa me vrull pranë vetes. Ndjeva prekjen e butë të fytyrës dhe të flokëve të saj. Desha ta mbaja ashtu sa më gjatë, por ajo u tërhoq pas si e trembur.

- Ik, pra tani!

Më ktheu shpinën pa më lënë kohë t'i thosha ndonjë gjë. E shoqëroja me sy figurën e saj që dukej si siluetë në mugëtirën e shkallëve. Dhe jo pa një ndjenjë faji. Kur ndahesh me një vajzë si Selma të vjen plasje që s'ke bërë diçka më shumë se një kapje dore dhe një shtrëngim të thjeshtë pranë vetes. Kurse ke dashur me gjithë shpirt më shumë. Budalla, qortova veten në çast, mos edhe aq është pak? Nuk është dhe aq një mrekulli?

Në sheshpushimin e parë ajo qëndroi te parapeti dhe më tha të

ikja. I ngrita dorën pa lëvizur. Vizioni i siluetës së saj më mbeti gjatë në sy. Selma të bën përshtypje edhe si siluetë, me gjithë mend e them.

9

Ecja duke menduar vetëm për të. Ajo t'i bllokoi të gjitha mendimet e tjera. Ende më jehonte në vesh propozimi i saj për të mësuar bashkë. Isha i bindur që e kishte pasur me gjithë mend. Ka njerëz që bëjnë propozime vetëm për t'u dukur, kur e dinë që ose nuk do t'i mbajnë, ose janë të bindur se ti s'do t'i pranosh. Kurse Selma jo, nuk shtirej.

Yjet në qiell ishin të rrallë. Era më rrihte gjoksin duke më futur të ftohtit në gjithë trupin. Pas shiut që kishte rënë para ca ditësh moti po mbante, por netët ishin të ftohta. Megjithatë të ftohtit s'më bënte përshtypje, vazhdoja të mendoja për Selmën. Thosha me vete se duhej ta ruaja miqësinë me të derisa të fejohej. Pas fejesës, ta pret mendja, s'do të kishim më atë miqësi.

Ora kishte kaluar nga nënta. Lusi me siguri do të qe mërziur duke më pritur dhe do të kishte marrë në telefon mamanë qyshkur. Mamanë e kam farmacistë në një lagje. Këtë javë ishte turn i dytë, punën e linte në ora dhjetë. Pyetja e Lusit, po qe se do ta kishte marrë në telefon, do ta kishte shqetësuar. Rrezik të kishte ikur nga puna e të kishte shkuar drejt e në shtëpi apo, më keq akoma, t'i kishte telefonuar babait. Gjë e rrallë kjo ikja ime e sontme, dhe tronditëse, të thuash të drejtën.

Me të dalë te qoshja e rrugës, prej nga duket pallati ynë, pashë se drita e kuzhinës ishte e ndezur. Qëndrova gjatë përpara derës, kisha një si parandjenjë se në shtëpi do të ishte ndonjëri nga prindërit. Dhe vërtet, derën ma hapi mamaja. Zëri mezi i doli kur më pyeti nga kisha qenë. S'i dhashë përgjigje, vetëm tunda dorën. Nguli këmbë, nënat gjithnjë ngulin këmbë të dinë se ku kanë qenë fëmijët. I thashë shkurt se kisha qenë te një shok për të mësuar, po s'më besoi.

- Mos ke qenë në shesh? Se qe bërë hataja.

Më hetonte duke më parë nga koka te këmbët, si të donte të gjente në trupin tim, apo rreth meje, ndonjë provë që do t'i vërtetonte dyshimin. Mamanë e zë tmerri nga politika, nuk pranon as aluzionin më të vogël për ndonjë pakënaqësi lidhur me rendin.

- Unë në shesh! Çne, o ma! As që e dija ç'do të bëhej, po edhe ta dija, pse do shkoja?

- Mirë, po thuaja tët eti këto.

- Paska ardhur?!

Bëra për në kuzhinë pa ia ndarë sytë. Dukej e zbehtë dhe e lodhur. Zemra më rrihte fort. Lusin e kishte zënë gjumi në divan. Ulur në karrige, me bërrylat mbështetur mbi tryezë, rrinte dajë Sokoli, kurse babai që zhytur në kolltuk me një libër të hapur mbi gjunjë. Kur na u takuan vështrimet daja sepse më shkeli syrin në një mënyrë që gati më bëri të qeshja. E doja shumë dajën, e kisha si shok. Nuk ishte me shkollë të lartë, mekanik që, ama ishte i zgjuar. Përpara dy vjetësh ishte ndarë nga gruaja, e kishte zënë me një tjetër. Kishte një djalë me të, moshatar me Lusin.

Thashë një "mbrëma" si nëpër dhëmbë dhe u ula në cep të divanit. Babai mbylli librin, e përplasi mbi tryezë dhe me një zë të ulët, krejt ndryshe nga ç'kisha pritur, më tha:

- Hë, mor bandill, i dhe fund livadhisjes? Mos po na sjell ndonjë lajm nga fronti?

Këtë fjalë e shqiptoi me një mënyrë të veçantë. Ishte e qartë ku rrihte çekani. Nuk e dhashë veten; isha i bindur se në mes të asaj rrëmuje ku unë, Alekoja dhe Agroni ishim përfshirë pa dashur, asnjë i njohur nuk do të më kishte parë. Le që edhe të më kishte parë do ta mohoj.

- Çfarë fronti, babi? - ia ktheva me pyetje, krejt serbes. - E ke fjalën për ato që ndodhën në shesh?

- Pikërisht. Më thanë se kishin dalë disa trima si ata të Tien An Menit. Mos u përzjeve me ata huliganë... me ata llumra?

- Çne unë me ta? Shkova tek Alekoja, tek ai shoku që ju kam folur. Edhe kur shkova, edhe kur erdha, sheshi ishte krejt i qetë.

- Pse shkove tek ai? Ty sot të erdhi Sofokliu, apo jo?

- Po. Por atë kohë më dhimbte koka, nuk mësoja dot. Kur shkova tek Alekoja isha më mirë, mësuam.

Heshti. Dukej që s'besonte, po s'kishte si të vërtetonte të kundërtën. Dora që mbante cigaren i dridhej dhe tymin e thithte me aq afsh, si të kishte ditë pa pirë duhan.

- Jo! - tha krejt papritur duke ngjeshur cigaren në tavëll. - Duhej të kishe qëndruar në shtëpi, të kishe mësuar me profesorin. Sepse sot ke marrë katër! Unë nuk e paguaj që të vesh në shkollë e të marrësh katër!

Heshta për një grimë, pastaj fola:

- Babi, unë i arrij edhe vetë mësimet. Po të jetë se ju nuk do të ngulni këmbë që të marr mjekësinë, unë mësoj vetë dhe s'është nevoja fare të vijë profesori...

- Ç'lidhje ka këmbëngulja jonë me... me notat e dobëta që po merr?

Edhe pse në fjalët që kisha thënë mungonte vërtet lidhja logjike, isha i bindur se babai më kishte kuptuar. Megjithatë ai nguli këmbë të jepja shpjegime të mëtejshme.

- Më duket se... notat e mira në matematikë e fizikë do më prishin punë, ja kështu.

- Dhe notat e këqija do të të ndihmojnë në realizimin e dëshirës? Jo, mor djalë, jo. Më mirë thuaj që më ka marrë marrë koka erë! Përton të mësosh, bredh e na bën teorira... E shikon tët nip, Sokol? - iu drejtua dajës. - Vazhdon avazin e vjetshëm: do të bëhem aktor, s'ka ç'më duhen matematika, fizika... Ja nuk fitove për aktor, ç'do të bësh? - m'u drejtua prapë mua. - Me notat e mira të hapet rruga për çdo degë, ndaj të plasësh trutë mbi libra, merr vesh?

Heshta.

- Se ku e çon ky menefregizëm nuk e vret mendjen fare, - iu drejtua prapë dajës. - Aq më tepër tani, që ca liberalë të poshtër po kërkojnë t'i heqin për hunde moshatarët e tij. Ca llumra e ca e qafëleshë, që krijojnë shqetësime si ato sot. Dalin për të shprehur protesta, pakënaqësira! Harrojnë ç'detyra kanë nga vetja në radhë të parë. Harrojnë se para se të hapin gojën për kërkesa, duhet t'u shtrohen mësimet a punës, ku ka nevojë. Harrojnë ç'kanë hequr baballarët e tyre për të arritur këtë ditë. Si u shqelmoka kjo djersë e ky mund pa pikën e përgjegjësisë? Sokol, të lutem, të takon të thuash dy fjalë.

Daja e dëgjonte i përqendruar, por në mimikën e tij vura re diçka të veçantë, që s'ia kisha vënë re më parë, një farë hakërrimi që përpigjej ta përmbante.

- Për Mirtonin keni të drejtë, nuk ka pse të bjerë në mësimet. Edhe unë e kam qortuar, dhe për të mirën e tij. Edhe për ata qafëleshët që përmendët nuk kam simpati. Kurse për ata që i quajtët liberalë të poshtër... nuk pajtohem. Në qoftë se kërkojnë ndryshime nuk do të thotë se janë të poshtër.

Këto fjalë ranë si bombë jo vetëm për babanë dhe mamanë, por edhe për mua. Nuk ma kishte marrë mendja se daja mund të kishte bindje politike të avancuara.

- A, a?! - ia bëri babai. - Si, edhe ti qenke për ndryshime?

- Pse jo? Ç'ka të jashtëzakonshme?

- Sokol, je në vete?! - tha mamaja si duke iu mbajtur fryma.

- Rri, të lutem! - iu drejtua babai për të vazhduar me dajën. - E para, nuk e dija që qenke edhe ti pro atyre të sheshit... Ata, me ç'ma pret mua, nuk janë thjesht për ndryshime, po për përmbysje. Tek dhënia fund e këtij sistemi. Pajtohesh ti me ta?

- Astrit, nuk kam ndërmend të debatoj. E di që çdo fjalë imja mund të shkaktojë rrëke fjalësh nga ana juaj. - Daja gjithnjë i fliste me "ju" babait. - Mund të them vetëm kaq: koha po kërkon ndryshime, ndofta edhe përmbysje. Ç'ka për t'u habitur?

- Hajde, Sokol, hajde! - tha babai me një zë të zvargur, disi vajtimtar, dhe me duart që i dridheshin ndezi një cigare tjetër. - Po e di që për këto mendime ha nja tetë apo nëntë vjet burg?

Daja nxorri paketën "Partizani" dhe e ndezi. Më erdhi keq që babai nuk ia zgjati paketën e vet "DS".

- E di. Si s'e di?

- Prandaj të këshilloj që t'i heqësh një minutë e më parë nga koka, në radhë të parë për të mirën tënde. Së dyti, ky këtu, yt nip, ç'do të mendojë? Ç'do të mendojë ky që të ka kujtuar të... të pjekur, të brumosur si duhet?

- Edhe edukata, edhe brumosja, janë nocione relative. Devotshmërinë dikur e respektoja, tani jo. Ta them troç, jam zhgënjyer. Nuk besoj as tek devotshmëria juaj. Ju keni parë botë me sy, vende që unë s'i kam parë dhe mbase s'do t'i shoh kurrë. Më thoni: a ke parë ndonjë vend më të prapambetur se yni? A ka ndonjë vend ku njeriu burgoset apo ekzekutohet për një fjalë goje? A ke parë në ndonjë vend një diktaturë më të egër nga kjo? Apo me që e quajnë e proletariatit i lejohet të bëjë çdo gjë?

- Mjaft, Sokol! - bërtiti mamaja. - Paske rrjedhur fare! Të gjithë kështu mendojnë në uzinë?

- Nuk e di, secili sipas kokës. Iku koha kur na detyronin të mendonim me dhunë, si i pëlqente njerit. Tani s'ka më. Tani po vjen koha, në mos ka ardhur, që secili të mendojë me kokën e tij po që se nuk do që të bëhet qesharak.

- Pra ne s'mendokemi me kokën tonë? - tha babai pa e fshehur zëmërimin. - Mirë që qenke kundra, dhe ne s'e paskemi ditur, po të paktën pse na fyen?

- Pse po ju fyej? Pse ju thashë një të vërtetë, se nuk mendoni me kokën tuaj? Ju përmendët liberalët dhe qafëleshët. Kjo kategori

njerëzish nuk mund përkufizohet kaq thjesht, nëse do që të jesh realist. Me etiketa si dikur nuk ecet më. Kush dëshiron t'i bëjë qoftë dhe një analizë të përciptë kohës së sotme duhet të heqi dorë nga shabllonet, përndryshe nuk arrin në asnjë përfundim të saktë.

- Me sa duket zotrote e paske arritur atë përfundim! - vazhdoi babai me ton ironik.

- Kam mundur të kuptoj sa mundem, jo më tepër. Dikush mund të shkojë më thellë, por pa objektivitet dhe realizëm as ai nuk do të nxirrte gjë. Nejse, ndofta e zgjata ca. Po për të fyer nuk kam pasur qëllim t'ju fyej. Sidoqoftë këtë bisedë mund ta lëmë, flasim për problemet që keni me djalin tuaj dhe nipin tim, jam dakord.

- Që t'i fusim në kokë pikëpamjet e tua?

- Nëse një njeri e ka në dorë t'i fusë mendimet e tij një tjetri pse s'i fusni në kokë tuajat?

- Pse, ç'i kemi futur?! - briti babai. - Ato të qafëleshëve?! Jemi përpjekur t'i futim ato që duhet të kenë të rinjtë. Kemi bërë gabim?

- Jeni të sigurt? A e dini ju se të rinjtë kanë nevojë për mendime të ndryshme nga tuajat?

- Posi, kanë nevojë të dalin nga brazda! Të bëhen si hipitë e viteve shtatëdhjetë! Nuk të duket se kanë më shumë nevojë për t'ua shtrënguar edhe ca frerinin?

- Jo, - vazhdoi daja i qetë dhe nxorri prapë paketën "Partizani", ku pashë ca cigare të shkundura për ibret. - Kanë nevojë për më shumë liri dhe vetëveprim.

Vetëm me fijen e tretë të shkrepes mundi ta ndezë cigaren, aq shumë i dridheshin duart. Kurse në fytyrë dukej i qetë, jo si babai, që lëvizte si i ndërkrayer, dhe as si mamaja, që dyllë e verdhë kafshonte thonjtë.

- Mirë, Sokol, mirë, mbaji ato mendime, - foli babai pas një pauze. - Vetëm ta dish se nuk kanë për të të çuar në rrugë të mirë.

- Iku koha kur njerëzit qortoheshin, madje dënoheshin, për pikëpamjet e tyre. Doni apo s'doni ju, tani po vijmë kohë të tjera.

- Avash! - ndërhyri mamaja. - Mbetën t'i sjellësh ti! Mblidhe, ore vëlla, mendjen!

Babai tundi kokën pa thënë asnjë fjalë. Doja ta shikoja dajën në sy por ai sikur s'më vinte re, sikur nuk ndodhesha aty.

- Ne të thirrëm për të na ndihmuar, - vazhdoi mamaja, kurse ti... Sikur yt nip të kish qenë në shesh dhe ta kishin arrestuar, si do të të vinte?

- Së pari do të doja ta dija pse kishte shkuar, - u përgjigj daja. - Për të parë ç'do të bëhet, apo për hir të një qëllimi?

- Ç'qëllim, more! - turfulloi babai. - Kush ju lejon juve, more, të realizoni qëllimet tuaja? Ore je në binarë? Mblidhe, ore mendjen, se nuk je axhami! Mor po nuk rrezikon vetëm veten, e kupton?

- Këtu ke të drejtë, - tha daja i qetë. - Një nga paradokset tona është që njeriu bëhet viktimë e mendimeve të tij. Po më i përbindshëm është një tjetër: që për to bëhen viktimë familja, farefisi, miqtë e viktimës. Ky është paradoksi më i madh që ka njohur historia. Të paktën e shoqja e Xhordano Brunos, apo miqtë e tij, nuk u dogjën në turrën e druve...

- Mjaft! - briti sërish babai. - Nuk pranoj të dëgjoj më asgjë tjetër! Asgjë!

- Koli, e teprove! - pasoi mamaja. - Po qe se vazhdon kështu...

- Po, do t'i jap fund. Veç jo pa thënë edhe diçka: nuk ka vend të botës ku njeriu mund ta tmerrojë më shumë e vërteta sa tek ne. Tani mund të rrini të qetë, nuk do të flas më.

- Mor vëlla, po që kur kështu? Kush t'i ka futur në kokë këto... - ankoj mamaja dhe iu mbushën sytë. - Do të na marrësh më qafë, Sokol! Ne qanim hallin e këtij - tregoi me dorë nga unë - kurse paske fluturuar ti!

Nga shprehja e fytyrës dukej që i kishte hyrë tmerri. Nganjëherë sepse më bëhej sikur daja tallej me ta, sikur asgjë nuk kishte seriozisht, vetëm donte t'i alarmonte dhe aq. Sepse jo më ata, po as unë s'e kisha dëgjuar të fliste ashtu, shraftra-kallamastraftra, siç thotë Kadareja në romanin e tij, dy fjalë që nuk më hiqen nga koka. Vërejtja e mamasë e nervozoi dajën.

- S'mund të ketë njeriu mendime nga koka e vet? - vazhdoi daja, për herë të parë me një farë rrëmbimi. - Si të mos kem këto mendime kur punoj si qen dhe paguhem si qen?! Ti ke të drejtë, motër, të mendosh ndryshe, se kuletën dhe dollapin i ke plot! - Daja sa vinte e rrëmbehej, gjë e rrallë kjo për të. - Se helbete, me rroga të mira, me ryshvete, me vajtje jashtë shtetit...

Pashë babanë në fytyrë. Qe bërë dyllë, vetëm sytë i shkrepëtinin. Po ashtu edhe mamaja, që u përpoq ta ndërpriste dajën, po që nuk mundi, sepse ai vazhdoi:

- Prit, prit! Po juve aq ju bën si janë të tjerët përçark, mjafton që vetë të jeni mirë...

- Qenkemi dhe egoistë! - ia ktheu mamaja. - Pse s'thua edhe

kriminelë?...

- Jo, jeni viktima. Ju e shihni krimin, shihni edhe rrënjët e tij, por nuk e denonconi, nuk keni guxim.

- Kujt i flet me këtë gjuhë?! - bërtiti babai me sa kishte në kokë. - Kush je ti që vjen e na bën gjyq? Që na akuzon e na bën përcaktime? Të tilla biseda bëji ku të duash, po në shtëpinë time jo! Aq më tepër në sy të një axhamiu! Po ta them prerë: nuk dua ta vazhdojmë më këtë bisedë. Qartë?

Daja qeshi lehtë, hidhur, dhe nuk foli.

- Ne do të bëjmë sikur s'kemi dëgjuar gjë, mor vëlla, - tha mamaja. - Nëse do që të marrësh veten më qafë, mbaji këto mendime.

- Kurse me ty, - m'u drejtua babai me ashpërsi, duke ma shkarkuar mua një pjesë të mllëfit, - nuk kam mbaruar. Por sonte shkoi vonë dhe nuk kam fuqi. Se kam operuar tërë ditën!

Mori Lusin në krah, e pa thënë "natën e mirë", doli nga kuzhina. Ndjeva një farë lehtësimi. Mirë që ishte kapur me dajën, se nuk do ta kisha patur të lehtë. E dija që rrebeshet e tij, derisa të merrte udhë puna e vendosjes për degën që do të ndiqja, do t'i kisha gjithnjë çekan mbi kokë. Sa për sonte ato kishin mbaruar.

10

Edhe mamaja sikur u ndje më e çliruar pas ikjes së babait. Teksa merrej me pjatat dhe lugët duke bërë ecejake nga aneksi në kuzhinë nuk vështronte asnjërin nga ne. Nuk më tha asnjëherë ta ndihmoja, siç bënte zakonisht kur shtronte për të ngrënë. Dukej shumë e pikëlluar. Për mua po se po, por edhe për dajën. Me siguri nga dyshimi se ai mund t'i shprehte ato mendime edhe me të tjerë dhe pa një pa dy do ta pësonte. Për këtë kishte të drejtë.

- Nuk dua darkë, - tha daja kur mamaja i vuri për të ngrënë. - Më sill vetëm një gotë raki.

E heshtur ajo i mbushi një gjysmë gote uji me raki, siç bënte gjithmonë. Vëlla vetëm atë kishte - kurse motra një lukuni, të shpërndara në shumë qytete - dhe e dija se e donte sa mua e Lusin. Me moshë daja vinte pas saj, dhe ishte fëmija i fundit.

- Gëzuar! - tha ai duke ngritur gotën ndërsa mua më shkeli syrin. - Për të ardhmen!

- Gëzuar, - ia ktheu mamaja. - Kole, t'u bëftë motra, të paktën mbaji përbrenda ato mendime. Mirë për ne, po për mamin nuk mendon?

Duron dot ajo të të ndodhë gjë?

- E kemi trime plakën, po hajt! - tha daja gazmor. - S'ke ç'i bën, Flora, këto mendime të gjithë i kanë. Gjithnjë i kanë patur, të jesh e sigurt.

- Kole, e lëmë këtë bisedë, se u çmenda! Nuk duroj më. Kur më thanë ç'kishte ndodhur në shesh u tmerrova. Vinin njerëzit e na thoshin dhe e mbyllëm farmacinë dy orë përpara, që po të merret vesh na pushojnë nga puna. U bëra akull, më shkante mendja tek ky, - tha për mua. - Ta dija se ç'mendime bluake ti, do të kisha vdekur fare. Më parë s'e ke hapur kurrë gojën për të tilla gjëra. - Tani m'u poq kungulli! - tha daja gazmor dhe ktheu një gllënjë. - Pastaj sonte erdhi rasti. Mos do të vija t'ju bëja leksione? Ju, si intelektualë, duhet t'i kuptoni vetë këto gjëra, ose të paktën një pjesë. Sado të kundërshtosh, Flora, jam i bindur që ti më shumë je dakord me mua, se me tët shoq.

- Koli, po boll më, të shkretën! Do ta gdhijmë me këto? Sokol, këto janë shumë të dëmshme për Tonin. Nuk mendon për të?

- Flora, nuk e dua unë Tonin?

- Kur e do pse nuk bisedon për hallin që na ka zënë me të, po vete e acarohesh me Astritin për politikë? Do t'i ndryshosh mendimet ti atij? Ta zëmë se edhe ai mendon si ti, kujton se do të të hapet?

- Po ty?

Mamaja pa nga unë.

- Koli, po iki. Nuk vazhdoj më.

- Rri, se nuk do të bisedoj më për politikë. Dakord, bisedojmë për Tonin. Ç'thua, Toni? - më pyeti.

- Patjetër. Sikur ma zuri veshi se të kanë thirrur për të më bërë moral, kështuqë...

Daja u bë serioz.

- Buçko, kur e do puna edhe do të të bëjmë! Politika dhe mund të ndryshojë, po disa vlera themelore, kurrë! Kur bisedojmë për politikë jo se e kemi qëllim, po si ta bëjmë atë që të na hyjë në punë. Në qoftë se ti e kupton ndryshe, s'ke kuptuar asgjë.

- Po, - e pasoi mamaja. - Se është aq i cekët në disa gjëra sa të habit.

E ndjeva veten të prekur.

- Pse, cektësi është të kesh pasion për t'u bërë aktor?

- Cektësi, për të mos thënë idiotizëm. Kur i ke të gjitha mundësitë për të marrë një profesion të vërtetë, si të mos e quaj

ashtu?

- Flora, nuk ke të drejtë, - ndërhyri daja. - Sa herë vij këtu, ky avaz vazhdon. Lëreni, moj, të bëhet aktor! Ç'të keqe ka? Të kishte zë për të kënduar, do ta pengonit të bëhej këngëtar?

- Jo, artist nuk e duam. Do të humbasë kot, as rrogë do të ketë e as personalitet. Të kishte ndonjë talent edhe hajde...

- Nga e di që s'ka?

- Rri, o Koli! Ç'ia hap syrin! Në vend që të gjykosh me pjekuri, bie në nivelin e tij!

- Po nuk shoh asgjë të keqe. Ç'thua ti, më mirë të bëhet një aktor i mirë, apo një mjek i keq?

- Pse i keq? Nuk mund të bëhet i mirë? Bëhet po të dojë. Bota luten, paguajnë, për të siguruar mjekësinë. Më vonë mund të bëhet me konkurs, mund të ndryshojnë gjërat, po tani që kërkohet vetëm nota mesatare është gjynah mos ta marrë. Fundja le të marrë ndonjë inxhinieri, po jo budallallëqe, estradë e teatër! Shoqet e mija hapin sytë kur u them që nuk do.

- Ç'punë ke që bisedon me to? - ndërhyra me inat. - Të duhet gjë ty se ç'degë duan fëmijët e tyre?

- Mirë, o djalë, mirë, - tha mamaja e lodhur. - Koli, po shkoj të shtrihem. Pak se më iku gjaku nga ato që dëgjua, na u deshën dhe broçkullat e këtij! - Daja diç desh të thoshte, po ajo ndërhyri me të shpejtë. - Të lutem, mos më thuaj asgjë, nuk duroj dot më. Ika, natën e mirë.

Sapo iku mamaja daja, si ta kishte kuptuar dëshirën time, më mbushi një gotë e ma zgjati.

- Hajde, gëzuar! - më tha. - Më thuaj të drejtën, ishe në shesh?

- Po. Po ti?

- Jo. Na mbajtën në uzinë edhe pasdite, qëllimisht a jo, nuk e di. Disa u treguan më të shkathët, kishin ikur që më përpara.

- Epo të kanë mjeshtër! Ikja jote do të binte në sy.

Nuk ia thashë plotësisht me shaka, se ishte vërtet mjeshtër. Le që për ç'punë nuk ishte i zoti! Kisha dëgjuar se hahej edhe me inxhinierët, ndonëse kishte mbaruar vetëm Politeknikumin.

- E kujt i ka hyrë në punë mjeshtëria ime? Edhe unë, edhe populli, fukara se fukara mbetëm. Sa ka më të talentuar se unë mor Toni, që humbasin kot! Asnjë nuk ka shkuar jashtë shtetit për të parë ku është bota, ç'bën bota... Ka frikë paria jonë se borgjezohemi! Idiotizma. Ata nuk borgjezohen që bredhin botën? Nejse, më trego ç'u bë.

- Ishim tre shokë, deri prapa Pallatit mundëm të shkonim. Po dhe që atje pamë... Ç'të them, që diçka e egër, e rëndë, që të shtypte. Krejt jashtë çdo përfytyrimi. E prapë diçka e bukur. S'është e çuditshme?

- Aspak. - Hodhi pak raki në gotën e vet dhe vazhdoi: - Tmerri qëndron te brutaliteti dhe gjaku, bukuria te shpresa e lirisë. Janë dy profile të së njëjtës fytyrë. Të them të drejtën, unë ende nuk arrij ta rrok plotësisht që u bë një orvatje e tillë, aq e pabesueshme më duket. Gati ëndërr. Po kur e vërteta ta çan trurin si pykë, e pabesueshmja bëhet hi e megjithatë, dreqi, prapë lëvrin si bishti i gjarprit të këputur nga trupi. Merre me mend, dyzet vjetë propagandë, britma, fishekzjarre, pompime idesh se jemi vendi më i lulëzuar në botë e plot këso budallallëqesh. Kurse në të vërtetë jemi një nga vendet më të prapambetura, me diktaturën më të egër dhe më bizantine që mund të ketë njohur historia, viktimë e pagabueshmërisë së partisë dhe e shefit të saj të çmendur...

- Për... për ish-udhëheqësin e ke fjalën?

- Pikërisht. Për njërin nga diktatorët më të egër që ka parë bota. Për atë maniak fliten aq shumë gjëra, sa të dridhen qimet e kokës...

- Çfarë, për shembull? - pyeta i brejtur nga kureshtja.

- Për ç'nuk flasin! Për vjedhje milionash, për vrasje tinëzare të shokëve të vet që në kohë të Luftës, për vese seksuale...

E shikoja si i mpirë, me siguri me sy të zgurdulluar.

- Ja, të iku fytyra. Po e lëmë atë kalë të ngordhur se kemi tjetrin gjallë, dishepull-qosen, që mbajti gjithë atë kongres për "vazhdimësinë" dhe që nxori gjithë atë libër për atë qelbësirë, që është kurvëruar gjithë jetën me të dhe tani na del si shpëtimtar i dytë i kombit duke përrallisur se ne nuk jemi as Lindje dhe as Perëndim, me një fjalë jemi hemafrodit, siç është edhe vetë. Grin sallatë ky maniak Nr. 2 se pluralizmi e rrezikon vendin, rrezikon pushtetin e popullit dhe sjell në fuqi bejlerët dhe çifligarët. Po ç'është një vend pa pluralizëm? Një diktaturë e egër! Dëgjo ç'thotë Barbysi, një shkrimtar që flet kundër diktaturës dhe luftës: Veprimi më fisnik i mençurisë njerëzore është që të fshijë nga faqja e dheut çdo nocion të imponuar...

- Ti mendon se pluralizmi është i nevojshëm?

- Si jo? Është alfa e demokracisë. Pa të nuk ka as liri fjale e mendimi e as mbrojtje të të drejtave të njeriut.

Horizonti i tij po më habiste, ndaj e pyeta me çiltërsi:

- Nga i di ti gjithë këto?

Nuk m'u përgjigj menjëherë. Vetëm pasi u mendua pak e si thithi cigaren, foli:

- Gjithkujt i zien koka nga mendimet. Njeriut i lindin dyshime se diçka nuk shkon dhe kërkon fakte ose për t'i vërtetuar dyshimet e tij, ose për t'i hedhur poshtë. Janë ca gjëra që s'ka nevojë të t'i thotë kush, të vijnë vetë në kokë. Mjafton të kesh sy, veshë dhe mend. Njeriu krahason, peshon, analizon. Njeriu ditë pas dite regjistron dhe hedh poshtë fakte, gjithnjë duke u konfrontuar me realitetin. Dhe kur vjen një ditë dhe bën bilançin, shikon me llahtari se në ç'distancë të largët qëndrojnë bindjet e tij vetjake ndaj propagandës. Dhe ç'mund t'i ngjallet tjetër veç urrejtjes, fyerjes që e kanë gënjyer si fëmijë, dëshirës për ta thyer atë makinë të poshtër që është rropatur me dekada të tëra ta shformojë dhe ta kthejë në automat?

Ai heshti, as unë nuk fola. Pastaj nisi të fliste sërish, duke vështruar në një pikë të zbrazët, por tepër i përqendruar diku brenda vetes:

- Janë dhe bisedat me shokët që të mësojnë. Janë dhe radiot dhe televizioni i huaj që i hapim fshehurazi, është "Zëri i Amerikës" që të krijon një sistem solid, janë edhe ato qindra barceleta që qarkullojnë vesh më vesh dhe që unë do t'i quaja letërsia disidente numër një.

- Nuk keni frikë që bisedoni shok me shok?

- Sigurisht, pa rrezik s'është. Ka spiunë, ka edhe provokatorë, që paguhen për të të rrasur brenda. E megjithatë flasim, po jo në punë. Vetëm kur i shkojmë njëri tjetrit në shtëpi. Flasim, se ndryshe do të çmendeshim. Ju nuk bisedoni me njëri tjetrin për shqetësimin kryesor: se cili është vendi i njeriut tek ne? I hapeni ju njëri tjetrit?

- Edhe aq jo. Përpiqemi të jemi sa më brenda.

- E qartë. E thënë ndryshe është: të jemi sa më shumë hipokritë, me dy maska. E di si e quan një inxhinieri ynë këtë? Dualizim i personalitetit.

- Megjithatë ka ndonjë që flet fare hapur, për shembull një shoku im, Aleko e quajnë. Po shumica kanë frikë.

- Po, - tha mendueshëm. - Me shokët më të afërt mos u hiq hipokrit, në klasë është ndryshe. Është e vërtetë se ka filluar të fryjë një erë që të nxit të flasësh, e megjithatë rreziku i dënimit për një fjalë goje prapë është i madh.

Duket mbaroi së foluri, se largoi gotën bosh që kishte përpara dhe u ngrit.

- Sidoqoftë për ty kryesore është shkolla. Me shqetësimin e prindërve pajtohem, është tjetër gjë të mos e duash mjekësinë e tjetër të mos mësosh. Do t'u shtrohesh mësimeve?

- Po.

- Ndryshe u prishëm bashkë, - tha si me të qeshur ndërsa vishte xhaketën. Dhe nuk m'i ndante ata sytë e mëdhenj si të kaut, si të priste një përgjigje edhe më siguroese nga unë.

E shoqërova deri jashtë, te shkallët.

- Kthehu, - më tha dhe më përqafoi.

U ktheva në kuzhinë dhe pushë orën, po shkonte dymbëdhjetë.

Gjithë pasditen s'kisha prekur mësim me dorë. Tani s'i bëja dot, po referatin duhej ta bëja pa tjetër. Tema ishte për ndershmërinë dhe singeritetin. Mësuesja na kishte porositur mos ta shkruanim me fjalë të përgjithshme, po me fakte e ndodhi reale.

U ula të shkruaja, por me të hedhur rreshtat e parë dora më ngeci. Përpara syve më dolën pamjet që kisha parë atë buzëmbremje prapa Pallatit të Kulturës. U përpoqa t'i largoja por qe e pamundur; ato, me një kokëfortësi të çuditshme, më sulmonin pareshtur. Si të donin të shkruaja për to!

Ah, jo! Për diçka tjetër duhet të shkruaja, për jetën e zakonshme pa përlëshje e gjak. Për dy vlera morale, që përbënin bazën e saj. Dhe për mungesën e tyre, që përbënin shkatërrimin.

Tek shkruaja më bëhej sikur dëgjoja një zë që më pëshpëriste se ato dy vlera i kisha parë në vrullin e atyre djelmohave që, për herë të parë në historinë e këtij sistemi, kishin sfidur rendin. Me një spontaneitet të jashtëzakonshëm shpërthimi të çiltërsisë së tyre. Më vinte të shkruaja për ta, më zjente shpirti, po kuptohet që nuk mund ta bëja. Se duhej të shkruaja për një ndershmëri dhe singeritet standard, të pjella nga sistemi dhe të mëkuara prej tij. Ku spiunllëku, mbyllja e gojës së tjetrit, rrahja e gjoksit në emër të mbrojtjes së parimeve, pajtimi dhe mbajtja iso ndaj çdo akti që ishte në pajtim me normat, sado gënjeshtër dhe falsitet të kishte në to, përbënin vlera morale. Si fjala vjen kur je aq i "ndershëm" sa të këshillosh shokun "singerisht" të mos bjerë në gabimin e mbajtjes së një kryqi në qafë, kur pohon me "ndershmëri" se ke dëgjuar një shogën tënde të thotë "Nuk ka më i mirë se socializmi, paçka që në shtëpi vuajmë nga uria dhe të ftohtit dhe kemi vite që veshim të njëjta rroba", kur je aq i ndershëm sa nuk të lejohet të

dysshosh kurrë se rreth teje ka aq shumë pandershmëri, si fjala vjen të mos dysshosh aspak se në klasën tënde shoku hiqet se djersitet e mëson shumë, kurse në të vërtetë notën e mirë e merr me mik, apo të tregohesh "i ndershëm" dhe "i singertë" duke shkuar te sekretari i Partisë për t'i thënë se dikush dëgjon këngë të huaja dhe atë e përjashtojnë nga shkolla. Ja, në vija të përgjithshme ky qëndrim kishte përbërë singëritetin dhe ndershmërinë tek ne. Gjeje aq shumë raste të pandershmërisë të veshura me petkun e ndershmërisë sa mund të mbushje faqe të tëra.

Unë, megjithatë, shkruajta siç kërkohet. Që të flisja për pandershmërinë përpara klasës isha i detyruar të isha i ndershëm brenda pandershmërisë sime. Midis rasteve të tjera kritikoja edhe Bledarin - pa emër, natyrisht - i cili i ishte shmangur ndershmërisë në punë. Semestrin e kaluar kishim shkuar në një uzinë mekanike për të bërë dy javë punë prodhuese. Bledari se ku kishte gjetur mentesha të gatshme duke i paraqitur se i kishte bërë vetë. Po ç'ishte kjo pandershmëri e Bledarit në një uzinë ku çdo gjë ishte e rreme dhe e pandershme? Se ç'material nuk vidhej atje, ç'punë private nuk bëhej, ç'qyli nuk i binin drejtuesit duke marrë dyfishin e rrogave të punëtorëve (hiq privilegjet e tjera) kurse punëtorët robëtoheshin dhe fytyrat u nxiheshin e u zverdheshin nga që s'nxirrnin dot pesëmbëdhjetëditëshin?

Megjithatë duhej edhe të kritikoja, edhe të sillja shembuj kur këto vlera morale i kisha parë si kurorë të ndritshme në ballin e njerëzve të "tipit" të ri, ashtu siç i edukonte Partia.

Mbylla fletoren dhe pashë orën, kishte kaluar nga dy.

Mëngjesi ishte gjithë lagështi, me një qiell të vrenjtur nga ana e Dajtit, ku nxinin retë. Në ajër pluskonin pikla të imta vese të përziera me një mjegull të hollë si vello e çjerrë vende- vende, në ngjyrë gri të kaltëremë, gjithë freski dhe joshje për t'u mbështjellë me të. Gjatë natës do të kishte rënë shi i rrëmbyeshëm pasi nëpër rrugë qenë formuar pellgaçe përmes të cilave kaloja pa kujdes dhe duke u pllaquritur. Më kishte shkrepur të lozja me ata sy të vëngërt ku njëri pasqyronte një copër qiell të pastër e tjetri lëmshin e bardhë të një reje.

Me të hyrë në oborrin e shkollës pashë Alekon duke ecur drejt hyrjes me të ëmën. Për punën e kryqit, m'u kujtua. E ëma do të takohej me Arshiun dhe drejtoreshën.

S'kisha bërë veç disa hapa nëpër oborr kur përballë më doli Elona. Dukej e freskët si një lule e porsoçelur dhe kundërmonte erë

e mirë, që të kujtonte një lloj bari. Si për asociacion përpara syve të mendjes të shfaqej një fushë e blertë, e përgjumur, kur sapo ka dalë dielli. Dukej paska e trembur, se dihaste.

- E more vesh? - më pyeti.

- Për ngjarjen e mbrëmshme?

- Po. Ç'ndodhi, Toni? Ç'ke dëgjuar?

M'u afrua fare pranë duke zier nga kureshtja. Sa hapa gojën t'i thosha diçka pranë nesh erdhën Ilir Karaj, Bledari dhe Gentiana Harizi. Gentiana ishte vajza më e bukur e klasës, madje e shkollës, dhe me shaka shpesh i thosha "Miss Bota". Ca të tjerë ishin për Elonën, sidomos Bledari. Ç'është e vërteta që të dyja ishin alamet femrash, njëra më e bukur se tjetra. Vetëm Selma ua merrte, vetëm se vinte më e imët.

Fytyra gjithë puçrra e Ilir Karajt nuk m'u duk fshehtësisht e ngazëllyer nga diçka, me sytë të picërruar nga një flakëz që i dridhej brenda bebëzave. Sa për Bledarin isha i bindur se dinte shumë më tepër se të tjerët. Ai që i jashtëzakonshëm për të marrë vesh edhe lajmet më të veçanta, aq sa mund ta quaje pa frikë një lloj byroje informacioni - vetëm se tani nuk do ta hapte gojën. Kur ndodhej në grup zakonisht e qepte. Gentiana dukej e trembur, aq sa të krijohej përshtypja se ishte gati të merrte arratinë. Pamë njëri tjetrin në sy, po askush nuk po e thyente akullin. Për çudi që Bledari ai që e theu:

- Besoj e morët vesh se mbrëmë disa bandilla bënë përpjekje për të dalë në sheshin "Skënderbej"... Apo jo, Mirton? - m'u drejtua mua, gjë që më befasoi. Sytë e të gjithëve u drejtuan nga unë.

- Edhe mundet, po aprovimin tim përse e kërkon? - ia preva me inat. Ai tip të befasonte në çdo çast, kishte kënaqësi ta turbullonte tjetrin. - Mos kam qenë roje tek sheshi mbrëmë?

- S'është e domosdoshme të kesh qenë roje, - ma ktheu duke qeshur lehtë. Ia ngula sytë gjithë habi. Duhej të ishte budalla të mos kuptoje ku synonte - të ngjallte kureshtjen dhe dyshimin tek të tjerët se një nga ata "bandillë" kisha qenë edhe unë.

- Atëhere nga mund ta di? - thashë duke u bërë gjithnjë e më nervoz. Pashë se Ilir Karaj i përpinte me etje replikat tona, po edhe të tjerët nuk na i ndanin sytë. Më erdhi ta kapja për fyti Bledarin. Më mirë t'i binte drejt e të thoshte të vërtetën, sesa ashtu, rrotull e rrotull. Skuthi, kishte zgjedhur një mënyrë që edhe të nervozonte, edhe ta bënte të vështirë mbrojtjen.

- Sa u nxehe, Mirton! Mbase kushedi, je ndodhur rastësisht, ka

gjë të keqe? - vazhdoi pa e hequr nga fytyra atë buzëqeshje të shtirë, që të acaronte më shumë se fjalët.

- Këtë edhe unë mund të them për ty, apo jo?

- Për mua s'mund ta thuash, se kam prova që vërtetojnë se ku kam qenë.

- Pra dyshon se kam qenë në shesh? Këtë do të thuash? - Sytë më flakëritën dhe u mata vërtet ta kapja për fyti.

- Mos u zini, - ndërhyri Elona, e zbehur. - Bledar, nga i paske marrë këto të dhëna? - e pyeti ajo serbes.

- Ç'të dhëna?! - foli ai me një ton krejt tjetër, miqësor e pajtues. - Desha të bëja shaka, po s'më eci!

- Dakord, po ndonjëri aq do, e merr për të vërtetë shakanë, e kupton këtë? - ia ktheva unë.

- Toni, nuk është asgjë, - ndërhyri Gentiana dhe më kapi nga bërryli. - E kuptuam që bëri shaka.

- Që ta dish mirë, Bledar, unë s'kam asnjë arsye për të qenë nga ata bandillët, - fola dhe gati kafshova buzën, aq hipokrizi kishte në ato fjalë. Po ç'të bëja, ta lija veten të futesha në bllokun e Ilir Karajit?

- Vetëm armiqtë dhe alabakët mund të guxojnë për gjëra të tilla, - konkludoi Elona duke i dhënë shkas një diskutimi të përgjithshëm: dihet kush janë ata që ëndërrojnë për këtë ditë, që kanë marrë guxim nga ngjarjet në Poloni, Çekosllovakia, Gjermani Lindore dhe Rumani, se prapa tyre është dora e Amerikës, e xhandarit ndëkombëtar, që i nxit të ëndërrojnë të marrin pushtetin e plot dokrra të tilla. Po ç'të bënim? Në praninë e Ilir Karajit s'mund të flisje ndryshe.

Inatin që më kishin shkaktuar fjalët e Bledarit e harrova shpejt se diçka tjetër zuri të më bënte përshtypje me atë njeri - mënyra si ia ngulte sytë Elonës. Edhe ajo sesi e shikonte, në një mënyrë të përhumur a enigmatike, s'e përcaktoja dot. Në një çast shikimet tona u kryqëzuan. Më buzëqeshi dhe sepse e ndjeva veten fajtor.

11

Ra zilja dhe si përherë u nisëm drejt vendit ku rreshtoheshim. Rreshtimin e kisha tmerr, po ishte rregull i shkollës. Nxënësit e klasave rrotull nesh bisedonin për ngjarjet e mbrëmshme. Thuajse në të gjitha fytyrat vije re ndjenjat më të kundërta, ankth, hutim,

frikë, gëzim, revoltë dhe shpresë por që të gjitha, pa përjashtim, mbanin vulën e një habie të pazakontë, e ngjashme me tmerrin, a thua se mbrëmë, sipas dëshmive të shumë njerëzve, ishte shfaqur vetë Djalli apo Krishti, në varësi nga si gjykonte secili.

Tek kalonim përgjatë korridorit u këmbuem me Alekon dhe të ëmën. Edhe pse drita që e pakët munda të vija re sa të tronditur ishin, sidomos e ëma. Dukej e shpërfytyruar, si të ishte kthyer në një maskë vdekjeje.

Orën e parë kishim letërsi. U ula në bankë. Për çudi pashë që në vendin e Alekos, pranë meje, u ul Elona. Kishte kohë që nuk rrinte në një bankë me mua, por me Bledarin.

- Pse ky ndryshim? - e pyeta.

- Dua të më tregosh për mbrëmë, e di që ke ç'të më tregosh.

- Nga e di?

- Bledari kot nuk tha...

Ndjeva një pickim pranë zemrës. Kishte të drejtë, ai ia kishte arritur asaj që kishte synuar.

- Thuaj të drejtën, ishe apo jo? Të betohem, Toni, nuk i them askujt. Apo s'ke besim?

Lutesha që mësuesi të hynte një minutë e më parë që t'u shpëtoja pyetjeve të saj, të paktën hë për hë. E pashë në fytyrë - gojën e mbante paksa të hapur, drithëronjëse. Edhe ato dy gropëzat e vogla në të dyja faqet, që aty dukeshin e zhdukeshin, sikur i plotësonin të folurit e buzëve. Më hetonte pa m'i ndarë sytë, si të që në kërkim edhe të detajit më të vogël që do të konfirmonte apo do të zhdukte shpresën që i kishin ngjallur fjalët e Bledarit. Ishte e tëra në ankthin e kureshtjes ku përziheshin edhe admirimi, edhe frika. Doja ta gënjeja, t'i thosha se dija po aq sa ajo, por e ndjeva se nuk mundja. I thashë se kisha qenë, po thjesht për të parë.

Iu ndez kureshtja si dreqi, dhe në kohën që bëra të vazhdoja hyri mësuesi i letërsisë, Arqile Daullja, i pasuar nga Arshi Krodhja dhe drejtoresha. Arqileja dukej i qetë, kurse fytyrat e Arshiut dhe të drejtoreshës ishin solemne, si të qenë duke sjellë ndonjë mesazh presidencial. Kuptohej se ardhja e tyre kumtonte për diçka të rëndësishme. Doli vërtet ashtu, se Arshiu, pa e përfilluar mësues Arqilenë, nisi të flite me një zë të zvargur, thua se po tregonte për ndonjë katastrofë të përmasave apokaliptike.

- Jam i autorizuar t'ju vë në dijeni se dje pasdite rreth orës gjashtë në rrethinat e sheshit "Skënderbej" ndodhën disa incidente

të papëlqyera me karakter politik, të inskenuara nga armiqtë e Partisë e të popullit që kohët e fundit, të nxitur nga trazirat në vendet revizioniste, kanë filluar të rigjallërohen. Grupe të pakta prej llumit të shoqërisë, njerëz të degjeneruar, nga familje të deklasuara dhe armike të socializmit, të Partisë dhe popullit tonë, bënë përpjekje të organizonin një demonstratë antiparti, antikushtetuese, antiligjore, antisocialiste, me qëllim që të nxitnin masat për t'u bashkuar me ta në platformën e tyre djallëzore...

O zot, thashë me vete, qenka kurdisur keq. Kushedi kur do të mbarojë.

- Mbrëmë Partia ka qenë e shqetësuar, - vazhdoi Arshiu me ton dramatik. - Na kanë marrë nga shtëpitë në mes të natës dhe kemi bërë mbledhje. - Papritur këtu ngriti zërin dhe vazhdoi me ton kërcënues: - Partia, të dashur nxënës, porosit të mos bini pre e këtyre kurtheve të armiqve. Ajo ju bën thirrje të jeni vigjilentë dhe, ç'është më kryesorja, të denonconi cilindo element turbullues...

Heshti për nja dy sekonda, sa u mbush me frymë, dhe vazhdoi:

- Kushdo që nxit apo merr pjesë në të tilla veprimtari thellësisht armiqësore do të marrë ndëshkim të rëndë. Në qoftë se është nxënës jo vetëm që do të përjashtohet nga shkolla, por do të ndiqet edhe penalisht. Për tradhtarët ligjet janë të pamëshirshme. - Fjalën e fundit e shqiptoi me një shtrëngim të dhëmbëve dhe të dyja "sh"-të e saj më tingëlluan në vesh si fishkëllima e një gjarpri. - Mendoni pastaj ç'pasoja do të ketë në jetë ky njeri dhe familja e tij, e cila do të internohet. Sidoqoftë unë nuk besoj që ndonjë nga ju të jetë bashkuar me ato fundërrina... Po nëse është ndodhur në shesh rastësisht, të ngrihet e të thotë. Ndryshe, po qe se merret vesh nga rrugë të tjera...

Të gjithë qëndronim të heshtur, si gur varri. Pas pak filluam të lëviznim dhe klasa u mbush me pëshpërima.

- Flisni, kush nga ju ka qenë mbrëmë në shesh?

Përsëri ra një heshtje e akullt.

- Flisni, pra, - ndërhyri drejtoresha për herë të parë. Ndërhyrja e saj m'u duk e pavend, le që e kishim harruar fare praninë e saj.

- Heshtja tregon se asnjë s'ka qenë, - guxoi e foli Gentiana Harizi, e skuqur në fytyrë. - Po qe se dini ndonjë, e thoni.

Ato çaste nuk admirova bukurinë e Gentianës, por guximin e saj.

- Të dinim, gocë e mbarë, do të kishim folur ndryshe! - tha Arshiu. - Deri tani nuk kemi ndonjë të dhënë. Me këtë punë po merret policia, por zbulimi i tradhtarëve nuk është vetëm detyrë e saj. Mos harroni se grupet më të rrezikshme armiqësore i ka zbuluar Partia dhe jo Sigurimi apo policia. Pra e kemi për detyrë edhe ne, si Parti, të gjejmë fajtorët. Kurse ju të na ndihmoni, qartë?

U dëgjuan mbyturazi disa zëra aprovues dhe përsëri ra heshtja.

- Që t'i japim fund po ju them vetëm kaq: kushdo që do të guxojë të ngrejë sikur vetëm gishtin kundër Partisë do të thyejë kokën. Shqipëria nuk do ta ndërrojë kurrë ngjyrën e saj të kuqe dhe do të dërrmojë çdo armik!

Na ishte bërë refleks që pas fjalësh të tilla pompoze të duartrokisnim, mirëpo askush nuk lëvizti. Heshtja që pasoi qe edhe edhe më shtypëse. Arshiu, papritur, u kthye nga Arqileja.

- Edhe ju, shoku mësues, - i tha - duhet të punoni më shumë për edukimin revolucionar të brezit të ri...

- Pa dyshim, shoku Arshi! - u gëlltit Arqileja i zënë gafil. Vuri syzat me nxitim dhe vazhdoi: - Sigurisht, atë e kemi objektiv kryesor... dhe për fat të mirë asnjë...

Arshiu nuk ia zgjati, u kthye nga drejtoresha dhe vazhdoi me të:

- Edhe ju, shoqja drejtoreshë, duhet ta kontrolloni më mirë përgatitjen ideoprofesionale të mësuesve...

Drejtoresha i hodhi një vështrim të habitur dhe ia ktheu me një farë indiference:

- Nuk besoj të kem lënë shkas për një vërejtje të tillë. Edhe ju, si sekretar i partisë, nuk dilni jashtë përgjegjësisë, apo jo?

Vërejtja e drejtoreshës, e shqiptuar me qetësinë më të madhe, sikur e çarmatosi Arshiun.

- Nuk e mohoj që edhe unë duhet ta rris rolin tim në edukimin revolucionar të nxënësve, - bëri me kokë nga ne, - por një i vetëm është e pamundur t'ia arrijë. Përgjegjësinë përpara Partisë e kemi së toku.

Heshti një grimë, u kthye nga ne dhe vazhdoi:

- Përveç problemit që sapo trajtuam dua t'ju komunikoj se shokut tuaj, i cili manifestoi mbeturina fetare, i dhamë vërejtje me paralajmërim për përjashtim nga shkolla. Edhe ju, si organizatë rinie, do të mbani qëndrimin tuaj. Qartë, shoqja Miranda?

Miranda Kolluri, sekretarja e rinisë, brofi në këmbë:

- Si urdhëron, shoku Arshi! Do të diksutojmë edhe rreth ngjarjeve të djeshme.

Arshiut i ndriti fytyra.

- Shumë mirë. - Heshti një grimë e shtoi: - Kaq kishim. - Dhe duke u kthyer nga Arqileja i tha: - Mund të vazhdoni.

Kur ai me drejtoreshën dolën, të gjithë morëm frymë të lehtësuar.

Mësues Arqileja ende vazhdonte të qëndronte si i ngrirë. Rrinte si i përhumur, me shikimin nga dritarja. Në klasë filluan zhurmat e pas pak të folurat me zë të lartë.

Ktheva kokën nga Alekoja. Rrinte me fytyrën të mbështetur mbi pëllëmbë, i menduar, vështrimhumbur.

- E hodhe, - i pëshpërita.

- Na traumatizoi... - mezi foli duke iu dredhur buzët. - Unë s'e çava dhe aq kokën, po mamasë gati i ra të fikët. Ç'bëra unë, thoshte kur dolëm nga dhoma e Partisë, që të lashë ta mbaje kryqin.

Arqileja nuk shpjegoi, na dha të përgatisnim për seminarin romanin "Koncert në Fund të Dimrit" dhe u ul në tryezë ku seç nisi të shkruante. Mbase ndonjë dramë, se vdiste për të shkruar drama.

Orën tjetër kishim fizkulturë, gjë që përgjithësisht qe një variacion i mirë në mes të streseve të lëndëve të tjera, mirëpo unë isha i dënuar të mos ia shijoja kënaqësinë sepse nuk më hiqej nga mendja ajo këmbëngulja e Arshiut për të treguar nëse ndonjëri kishte qenë në shesh.

Tek po vishesha më erdhi pranë Agroni, që dhe atë po ky shqetësim e mundonte.

- Si dreqin do të vejë kjo punë? - më pyeti. - Thua të na kenë parë? Mos na kanë çuar emrat në polici?

Ishte aq i turbulluar dhe i lodhur, sa mezi e gjeti këmbëzën e duhur të pantallonave.

- Ç'ia këput! - ia ktheva. - Kush e kishte mendjen tek ne? Askush nuk na ka njohur, mos u bëj me fiksime.

- Nuk më zinte gjumi mbrëmë, e beson?

Drejt nesh po vinte Bledari e pas tij Alekoja, kokulur e fytyrëvrrarë. I skuqur nga stërmundimi i ushtrimeve të fizkulturës - me atë trup të vogël Alekoja bënte çmos të mos mbetej prapa të tjerëve - i veshur me një triko të vjetër, të ngrënë te bërrylet e me një palë pantallona të gjera, me sa duket të përshtatura nga të të atit e me një palë këpucë po të vjetra, me dy a tri mballoma, të pikonte në shpirt kur e shikoje. Na u afrua në një kohë me Bledarin, të cilit i ndriste fytyra dhe faqet sa s'i pëlçisnin nga shëndeti, i veshur me një xhakovento blu, me xhinse e këpucë atlete

të bukura. Xhinset tani sikur kishin filluar të lejoheshin, se më parë të përjashtonin nga shkolla po të vije për herë të dytë i veshur me to.

Orën tjetër kishin filozofi. Filozofi i thënçin, se vëllimin kryesor e zinte filozofia marksiste, kurse rrymat dhe shkollat e tjera vetëm sa përmendeshin, më shumë për t'i dërrmuar. Gjë absurde, të thuash të drejtën, pasi mendimit më të lartë njerëzor, të selitur në shekuj, u vihej vizë me një të rënë të lapsit nga filozofët e proletariatit, të cilët ideologjia jonë i kishte kurorëzuar si më të mëdhenjtë e të gjitha kohërave. Në shpjegimin e ligjeve të natyrës teoria e tyre, me sa kuptoja unë, mbase kishte soliditet dhe racionalizëm, kurse në materializmin historik, në shpjegimin e ligjeve që rregullonin shoqërinë njerëzore, teoritë vërtet tingëllonin logjike e shkencore, e mbi të gjitha fisnike dhe humane, por, duke i përqsasur me realitetin e vendit tonë apo edhe në Lindje s'ishte e vështirë të kuptoje se ishin dogma apo utopizma që u kishte kaluar koha qyshkur.

Një natë më parë Alekoja më kishte folur për pikëpamjet e të atit, sipas të cilit komunizmi qe një eksperiment i dështuar. Pra mos kishte ardhur koha që kjo filozofi të degdisej në ndonjë muze si flamur i rreckosur, edhe pse lulkat vende-vende i feksnin të bukura?

Ç'është e vërteta edhe unë, edhe të tjerë në klasën tonë, kishim qejf t'i kapërcenim kallëpet e kësaj filozofie. Jo se kishim lexuar filozofë të tjerë, po thjesht nga dëshira intuitive se çdo nocion në filozofi mund ta shikosh në mënyra të ndryshme. Gjë që nuk lejohej, madje qe e dënueshme. Asnjë nocion nuk mund ta përkufizosh ndryshe nga ç'e kanë përcaktuar klasikët e marksizëm-leninizmit.

Të flasësh për ndonjë forcë apo ekzistencë që i kundërvihet materies apo të konsiderosh se jashtë saj, apo pavarësisht nga ajo, ekzistojnë edhe forca të tjera, quhet herezi, dhe për mendime të tilla fikesh. Një herë pashë fshehurazi në televizionin italian një emision ku bëhej fjalë për një portret në barelief të Shën Mërisë në Sirakuzë, portret që qante (e pashë vetë si buronin lot nga sytë e asaj ikone, një dukuri kjo që kishte turbulluar fetarë e shkencëtarë, të cilët i kishin analizuar në laborator dhe kishin rezultuar lot njeriu!) po vallë a mund ta shtroje për diskutim këtë fenomen në orën e filozofisë? Do të të merrnin për të marrë dhe do të të përjashtonin nga shkolla. Unë as sot e kësaj dite nuk e di si

është puna me atë portret të Shën Mërisë (nëse nuk ka ndonjë falsifikim, pa dyshim kemi të bëjmë me një dukuri sot për sot të pashpjegueshme nga shkenca), po jam i sigurt që po ta bisedoja edhe privatisht këtë çështje më mësuese Lumturinë, ajo menjëherë do të kujdesej që mua të më vizitonte ndonjë psikiatër.

Po hiq gjëra të tilla ekstremisht heretike, për të cilat ajo nuk guxon - ose e quan të kotë - të diskutosh, përgjithësisht ajo pranon të diskutosh me të rreth ndonjë çështjeje pa ta ulur notën, po ka mësues të tjerë me të cilët fikesh po guxove të bësh prova të tilla. Një herë kjo mësuese mungonte dhe e zëvendësoi një e dispozicionit. Ç'më gjeti belaja me të! Në klasë nisi diskutimi për problemin themelor të filozofisë, se cila është primare materia apo ndërgjegjja. Kjo çështje diskutohej shpesh në klasë, meqë përbën çështjen kardinale të filozofisë. Të gjithë përmendën aksiomën e njohur se materia është primare dhe ndërgjegjja sekondare, një aksiomë me bisht, ku bishti është shtojca se ndërgjegjja është veti e materies.

As vetë s'e di si më hipi në kokë ta kundërshtoj këtë teori. Ngrihem e them se ky argument filozofik çalon nga pikëpamja logjike pasi, arsyetova, në pohimin "ndërgjegjja është sekondare" nuk hyn vetëm nocioni i rëndësisë, apo radhës - pasi sekondare do të thotë diçka dytësore për nga rendi dhe rëndësia - por edhe nocioni i pavarësisë, i ekzistenëcs së saj si diçka më vete. Në këtë pohim materia dhe ndërgjegjja dalin si dy nocione, apo kategori, të pavarura nga njëra tjetra dhe me një raport të caktuar ndërmjet tyre, kështuqë ndërgjegjja nuk mund të jetë veti e materies, por diçka e pavarur prej saj, ose diçka e ndryshme. Mund të tingëllonte më logjike të quhej formë e saj, siç është energjia, por ta quash veti nuk qëndron, nuk të lejon aksioma.

Ç'm'u përvesh ajo mësuesja e dispozicionit! Më tha se kisha rënë në pozita idealiste dhe habitej si kisha guximin të vija në dyshim të vërtetat e padiskutueshme të teorisë materialiste marksiste-leniniste, të mësimeve të Partisë... Pas kësaj ngjarjeje mësuese Lumturia, kur u kthye, u muar gjatë me "edukimin" tim, më thirrën edhe në organizatën e Partisë ku më bënë presion të hiqja dorë nga teoria ime, ndryshe do të merrnin masë të rëndë. Sa për sy e faqe deklarova se hoqa dorë, por në të vërtetë po atë mendim kam edhe sot.

Ndërsa mësuesja bënte apelin, nisa t'i hidhja një sy referatit që kisha shkruar mbrëmë vonë. Vende-vende as vetë nuk lexoja dot ç'kisha shkruar, aq i lodhur dhe i përgjumur kisha qenë. Por mësuesja, për çudi, na njoftoi se do ta ndryshonte programin: nuk do të lexonim referatet, por do të zhvillonim një bisedë të lirë.

- Për çfarë? - e pyetëm njëzëri.

- Për interesat tuaja në përgjithësi, - u përgjigj. Ajo sepse dukej e hutuar. - Më vonë mund të plotësoni një anketë...

Ky ndryshim programi na u duk disi i çuditshëm. Biseda të lira kishim bërë edhe më parë, por ato kishin qenë spontane, jo të paracaktuara. Kurse tani me urdhër. Përse vallë?

- Mund të fillojmë - tha mësuesja duke e bredhur shikimin nëpër klasë. - Doja t'ju bëja këtë pyetje: ç'interesa keni ju veç mësimit? Si do të donit ta kaloni kohën e lirë?

- Të bëjmë më shumë mbrëmje vallzimi, - tha dikush.

- Edhe alpinizëm! - u hodh Aladin Dulja, duke u ngritur me atë trupin e tij të madh sa të një katallani.

- Edhe turizëm! - pasoi Bledari dhe në klasë shpërthyen të qeshura.

- Ju lutem, me radhë - mezi u dëgjua zëri i mësueses. - Dhe të mos e kthejmë bisedën në shaka. Hë, Miranda?

Miranda Kolluri kishte ngritur dorën.

- Sigurisht rinia, sidomos rinia shkollore, do më shumë argëtim, - ia nisi ajo si në mbledhje dhe me një ton që të neveriste, tamam si nëpër fjalime. - Po jo se argëtimi na ka munguar, pasi Partia na i ka siguruar të gjitha kushtet. Askush nuk e vë në dyshim se rini më të lumtur se rinia jonë nuk gjen në gjithë botën...

- E paska bredhur botën kjo... - pëshpëriti Alekoja, po që për dreq e dëgjuan të gjithë, se përkoi me një çast qetësie.

U dëgjuan të qeshura dhe zhurma të mbytura. Miranda e humbi, u skuq, dhe duke iu marrë goja tha gjithë inat:

- Çfarë, s'jeni dakord?

- Vazhdo, - i tha mësuesja.

- Rinia jonë, - vazhdoi Miranda, - e brumosur me mësime të Partisë, është e ndërjegjshme që ne jetojmë si në rrethim...

- Përqendrohuni në temë, - ndërhyri mësuesja. - Jeni apo nuk jeni që rinia të ketë më tepër liri për argëtime?

- Jo, - u përgjigj Miranda. - Argëtimet e tepërta do të na

çorientonin, do të na çedukonin...

- Po riedukohu, moj shpirte! - ia priti Aladin Dulja dhe në klasë plasi gazi. Ai shpesh këpuste budallallëqe, por thoshte dhe ndonjë batutë që i kishte lezet.

- Miranda le t'i mbajë për vete ato mendime, - u ngrit e foli Gentiana Harizi. - Vërtetë jetojmë si në rrethim, po edhe manastir nuk jemi. Sipas Mirandës duhet kthehemi dy mijë vjet pas, në Spartën e Lashtë! Marrim dhe krevatet nga shtëpia dhe flemë në shkollë, hapim dhe një mensë...

- Hajde ç'kamp! - bërtiti Bledari.

Përsëri u dëgjuan të qeshura dhe Gentiana u skuq. Zhurmat vazhduan dhe mësuesja mezi arriti të vendoste qetësinë.

- Gentiana, - e pyeti ajo - ç'argëtime do të doje ti të zhvillonit në shkollë ose jashtë saj?

- Të hapim një diskotekë... - pëshpëriti Bledari, po askush nuk e dëgjoi veç meje, Alekos dhe Elonës.

- E pse jo? - u kthye me vrull Gentiana nga ai. - Thuaje me zë të lartë!

- Luajta mendsh? - iu hakërrye Bledari si me të qeshur. - Apo të më fluturojnë nga shkolla!

- Ato që duan të gjithë, - vazhdoi Gentiana, tani duke iu përgjigjur pyetjes së mësueses, - të kemi një kohë të lirë më aktive, më të gjallë, jo kështu, të mbyllur...

- Mos do dhe një veturë? - e ironizoi Miranda.

- Atë ta kam lënë ty, bashkë me vilën, kur të hysh në punë si sekretare e ndonjë të madhi! - ia priti Gentiana dhe në çast të gjithë ia dhamë gazit me të madhe. E bërë spec në fytyrë Miranda u përpoq të thoshte diçka po ca nga zhurmat e ca nga zëri i fortë i mësueses, që përpigjej të vendoste qetësinë, nuk u mor vesh ç'tha.

- Thamë të bëjmë bisedë të lirë, Miranda, jo të grindemi, - arriti më në fund të dëgjohej mësuesja.

- Ama jo të na tallin! - briti Miranda.

- Kush u tall? - foli Aladin Dulja. - Ti që tani je me pozitë, pale më vonë!

Përsëri qeshëm. Çdo fjalë na shkaktonte të qeshura, kot më kot.

- Sidomos ne vajzat, - vazhdoi Gentiana, - bëjmë një jetë shumë të mbyllur: shkollë-shtëpi, shtëpi-shkollë, asgjë tjetër. Jeta kolektive duhet të jetë më e larmishme. Edhe kur vjen vera zor se e gjejmë një fletë kabine për në plazh...

- Bëj vajtje ditore me tren, - u hodh dikush.

- Po, të shtypesh si sardele, - vazhdoi Gentiana e nxehur. - Apo kemi para të vemi çdo ditë...

Me t'u përmendur paratë ra heshtja. Kisha vënë re se sa herë që në biseda kolektive përmendeshin paratë, secili shikonte si me frikë nga tjetri. Gjithandej - edhe në shtëpinë time që jetonim mirë - njerëzit vesh më vesh qaheshin se s'u dilnin paratë, ama me zë të lartë askush s'guxonte të fliste se merrej si protestë ndaj regjimit i cili, sipas propagandës, kishte sjellë bollëkun më të madh.

- Ju lutem, të mos dalim nga tema, - tha me nxitim e me një farë hutimi mësuesja. - Nuk do të diskutojmë për gjëra që s'na takojnë.

- Derisa kjo bisedë u hap, le ta diskutojmë! - tha me forcë Ilir Karaj dhe pa marrë leje u ngrit. - Mos do të thuash ti, shoqja Gentiana, se jetojmë në varfëri? Mos ke ndonjë pakënaqësi?

- Ç'flet, ore! - reagoi ashpër Gentiana.

- Jo po sikur dëgjova se s'të dalkan paratë! Çdo të thuash me këtë? Nga veshja, njëherë, s'duket se je kaq e varfër...

Gentiana u bë lulkuq. Në të vërtetë ajo vishej bukur e me shije, po jo se kishte kushedi çfarë të ardhurash. Babanë e kishte veteriner kurse nënën rrobaqepëse, pra me rroga të zakonshme, ndonëse e ëma (me ç'kisha dëgjuar) bënte ndonjë qepje fshehurazi. Për mendimin tim mirë bënte, se me djersë i nxirrte paratë, duke u qorruar deri pas mesnate, po ec t'i mbushje mendjen shtetit, policisë, që punën private e quante krim dhe të dënonte po qe se e ushtroje.

- Jo vetëm Miranda, po askush nuk ka të drejtë të qahet... - vazhdoi me pathos Ilir Karaj. - Niveli ynë ekonomik ka njohur ritme që s'i ka njohur bota...

- Ju lutem, nuk do të diskutojmë për këtë, - tha mësuesja.

- Ne nuk jetojmë në luks, - vazhdoi në të vetën Ilir Karaj - por kemi arritur nivele që s'i ka arritur bota dhe ç'është më kryesorja nuk kemi pabarazi. Ju e dini që përpjestimet e të ardhurave tek ne...

- Ju lutem, ta lëmë këtë diskutim! - e humbi durimin mësuesja duke e lënë të habitur Ilir Karajin. - Do të diskutojmë vetëm për problemin e argëtimit tuaj!

- Po ai lidhet edhe me anën materiale, - u hodh Bledari.

- Ju thashë: do të diskutojmë për ato probleme që nuk kanë të bëjnë me të. Kush do të flasë?

- Në rregull, - tha Ilir Karaj, - për ato le të diskutojmë. Unë

them se rinia jonë, e cila ka një përgatitje të shkëlqyer morale dhe politike dhe është e brumosur me ideologjinë më të shkëlqyer që ka njohur bota, sigurisht ka nevojë për argëtim, po kjo s'do të thotë se duhet t'u hapim rrugë dëshirave për ekstravagancë. E kam fjalën se argëtimi shpesh ngatërrohet me shfaqjet e huaja.

- Vazhdo, - tha mësuesja. - Kush dhe si e bën këtë ngatërrim? A keni në klasën tuaj shfaqje të huaja?

- Tendenca për shfaqje të huaja mund të shihet në shumë drejtime...

U krijua një moment pauze.

- O zysh, - bubulliu zëri i Aladin Dules, - pse nuk e thoni copë që e keni hallin te kryqi i Alekos?

Mësuese Lumturia u skuq lehtë.

- Jo, - tha. - Jua thashë që në fillim, do të bisedojmë për interesat dhe argëtimin tuaj. Iliri preku një temë që edhe atë mund ta diskutojmë. Pra, Ilir, si mendon ti, ka shfaqje të huaja tek ju?

- Në klasën tonë... - ia nisi ai si i dha një herë kokës përpjetë, - ato shprehen më shumë në formën e koncepteve, sesa në anën e jashtme.

- Për shembull?

- Po ja, - vazhdoi ai dhe nxorri nga xhepi i brendshëm i xhaketës bllokun e tij të famshëm, të cilin zuri ta shfletonte. - Do të përmend vetëm pak raste. Në datën 23 dhjetor, dy ditë përpara Krishtlindjeve, Aleko Boçka ka thënë pse të mos festohen edhe tek ne Krishtlindjet. Kurse tri ditë më vonë, më datën 27, ka thënë se pse nuk jemi edhe ne të lirë të udhëtojmë nëpër vendet e tjera, të kemi pasaporta për jashtë shtetit.

- S'është e vërtetë! - u hodh Alekoja.

- Ashtu thua ti, po unë e kam këtu! - tundi bllokun Iliri. - Në datën 29 dhjetor Bledar Guxholli ka thënë pse të mos bëhet edhe tek ne konkursi i bukurisë së vajzave, që mund të quhet Miss Albania...

E gjitha klasa i ktheu sytë nga Bledari, fytyra e të cilit, brenda një çasti të vetëm, u bë flakë, kurse sytë iu errësuan.

- Ç'janë këto shpifje?! - bërtiti. - Nuk e kam shprehur atë mendim!

- Edhe Aladin Dulja, - vazhdoi Iliri pa e prishur terezinë - më 28 janar të këtij viti është shprehur që edhe tek ne të lejohet boksi dhe një sport tjetër borgjez që quhet kar... kar... - Nuk po e lexonte dot fjalën dhe e afroi bllokun te sytë, - po, karaté.

Të gjithë ia dhamë gazit.

- Ore ti! - bubulliu zëri i egërsuar i Aladinit, duke ngritur lart edhe grushtin që e kishte sa një dorezë boksi, - nga i nxjerr këto?

- S'keni ç'bëni, se kam edhe dëshmitarë, - foli Ilir Karaj i krekosur dhe i sigurt në vetvete.

- Nxirri dëshmitarët, ku i ke? - e pyeti me hakërrim Bledari.

- Kur të vijë puna, - ia ktheu Iliri. - S'më detyroni ju se kur i nxjerr. Po ashtu edhe Elona Bitri ka shprehur një koncept të huaj, e cila më 22 shkurt të këtij viti, kur na mbajtën një leksion për SIDË-n, ka thënë se nuk është e vërtetë që tek ne nuk ka shfaqje të kësaj sëmundjeje borgjeze.

- Ua, ç'thotë ky!? - u alarmua Elona, e bërë dyllë në fytyrë. - Ku kam thënë ashtu?

- Edhe Mirton Lumani, - vazhdoi ai duke shfletuar bllokun - më 27 mars të këtij viti ka thënë se aktor komik të rangut botëror ne gjoja paskemi vetëm një: Tano Banushin, kur dihet mirë se kemi edhe të tjerë.

- Mirë, boll me këta shembuj! - ndërhyri me të shpejtë e me një farë nervozizmi mësuesja. - Vazhdo më konkretisht...

- Jo, se lidhur me Mirtonin kam edhe diçka: në 29 mars ai ka ka kënduar me fishkëllimë melodinë e këngës The Wind of Change të Skorpionsave, një këngë me një simbol që...

- Ju lutem, Karaj, - vazhdoi mësuesja po me atë ton, - kam mendimin që të flisni për gjëra më konkrete, për koncepte që janë vërtet shprehje të ideologjisë dhe moralit të huaj.

- Pse, këto nuk qenkan shprehje e moralit të huaj?! - ia ktheu Iliri me një farë hakërrimi. - Të këndosh me fishkëllimë një këngë të huaj çfarë shfaqje është?

- Kam për të ta rregulluar qejfin, spiun! - bërtiti Aladin Dulja.

- Po më kërcënon? - u skërmit Iliri duke e parë me sfidë. - Guxo e më prek dhe e shikon po s'përfundove në burg...

Aladini tundi atë kokën të madhe sa të ariut, turfulloi si kalë dhe nuk foli.

- Ilir, - vazhdoi mësuesja, - ke ndonjë gjë më konkrete lidhur me shfaqjet e huaja në klasën tuaj?

- Po, - vazhdoi ai gjithë inat. - Edhe në klasën tonë ndonjë djalë ka tendencë të mbajë xhinse, rrip të gjerë e medalion...

Disa kthyen kokën nga Bledari, i cili u bë flakë.

- Po më shumë këto tendenca i gjen te disa djem të klasave të

tjera, të cilët mbajnë xhakovento të zeza apo me ngjyra, flokët më të gjata nga ç'lejohet, kurse vajzat minifunde, maksifunde ose veshje të tjera me forma të papërshtatshme. Veç kësaj, edhe në klasën tonë, disa kanë dëshirë për të dëgjuar muzikë të huaj, për të lexuar letërsi të ndaluar ose ndonjë ëndërron të ketë veturë ose vilë e kështu me radhë, - i dha fund Iliri dhe u ul.

Pllakosi një heshtje e rëndë.

- Kush do të diskutojë për këto që tha Karaj? - pyeti mësuesja.

U ngrit Alekoja.

- Le të na thotë Iliri si të vishemi, - tha ai. - Mos mendon të vishemi të gjithë kuq e zi, siç shkruante një idiot para ca kohësh në një gazetë?

- Pse, s'të pëlqen ty veshja sipas tabanit kombëtar? - iu kthye Ilir Karaj. - Të pëlqejnë mballomat e botës perëndimore, pantallonat e kaubojsave dhe getet e vajzave?

- Kush po vishet ashtu? - tha Arlinda Gjoni, një vajzë flokëkuqe me preka.

- Ka dhe që vishen ashtu - ndërhyri mësuesja. - Këtu Iliri ka të drejtë.

- Pse duhet të ketë kufizime për veshjen? - tha Gentiana. - Pse të mos vishet secili si t'i pëlqejë?

- Ah, ç'mendim i shkëlqyer! - u hodh Miranda Kolluri. - Të pëlqeka ty të dalësh me minifund? Apo si në plazh?

- Mbjaj vendin aty dhe mos na u hidh si kacagjel! - i foli me inat Gentiana. - Mos do të vishem si të pëlqen ty? Ke shije të hollë ti, posi!

- Të paktën shije të degjeneruar nuk kam!

- Ju lutem, qetësi! - ndërhyri mësuesja. - Mos e teproni! Flisni pa e fyer njëri tjetrin.

- Unë kam mendimin se për veshjen tepronet me etiketimin "shfaqje të huaja", - tha Bledari. - Pak të vishesh më ndryshe se të tjerët ta ngjiten nofkën, mbushin dhe muret me karikatura.

- Për librat dhe muzikën e huaj ç'mendim keni? - pyeti mësuesja.

- A ka botime që bien ndesh me ideologjinë dhe moralin tonë?

- Po, - tha Miranda. - Në librat e përkthyer lihen fragmente që duhej të ishin hequr, edhe nëpër filma. Për shëmbull lihet ndonjë skenë ku tregohen të rinj që kërcejnë nëpër diskoteka, që bredhin me vetura e të tjera si këto, kur nuk duhen lejuar se janë gënjeshtër. Të rinjtë nuk gjejnë punë andej, si i kanë mundësitë për këto? Në ndonjë libër lexon se punëtorët e kanë rrogën gjasme

një mijë dollarë në muaj, që është krejt e pabesueshme. Ne e dimë si shfrytëzohet në perëndim klasa punëtore, e cila rron me thërrimet që i jep borgjezia.

- E dika shumë mirë kjo! - foli Alekoja me të përshpëritur dhe duke shtrënguar dhëmbët. Bledari e pa me bisht të syrit, po nuk foli.

- Në filmat e huaj ka edhe skena erotike, që nuk janë të denja për moralin tonë të pastër, - tha Elkana Verdha, një vajzë trashaluge me sytë të fryrë, që gjithnjë e ngrinte fustanin përmbi gjunjë kur ulej në bankë.

- Kush flet! - foli Bledari me zë të ulët. - Pres kokën në qoftë se ajo nuk vdes për t'i parë!

Unë e Agroni u shkrimë së qeshuri. Fytyra e bardhë e Elonës, paksa e skuqur, shprehte habi, por edhe keqardhje, që Bledari kishte folur ashtu, kishte rrezik ta dëgjonin dhe mund të futej në telashe. Bledari s'e çau kokën, u ngrit e tha:

- Sa për muzikën e huaj nuk mund të thuhet se është e gjitha e papranueshme.

- Në masën më të madhe është, - u hodh Adriana Todi, një vajzë imcake, me një palë sy e flokë të bardhë si negativ filmi. - Muzika "rok", muzika e diskotekave... Diskotekat në perëndim përhapin një degjenerim të madh.

- E drejtë, - foli mësuesja. - Pra jeni të mendimit se rinia jonë nuk ka pse të huazojë asgjë nga rinia e vendeve borgjeze-revizioniste, apo jo?

U dëgjuan zëra që i miratuan fjalët e saj, por edhe ndonjë pëshpëritje apo e qeshur.

- Tani më thoni, e ndieni të nevojshme të keni një liri më të madhe për ta marrë vetë në dorë dëfrimin tuaj jashtëskollor, brenda normave tona? A ka... a ekzistojnë koncepte që ju bëjnë të ndieni një farë mungese lirie në këtë drejtim? - pyeti mësuesja.

Pasoi një heshtje e gjatë, e pasuar nga pëshpërimat. Papritur ngrihet Alekoja që me fytyrën të skuqur e me zërin e hollë, që i dridhej nga emocioni, foli:

- Po, ndiejmë mungesa lirie.

Menjëherë u bë qetësi dhe fytyrat e të gjithëve u drejtuan nga ai.

- Këtu u fol për rininë tonë, që ka virtutet më të larta morale, që është më e lumtura e botës etj., u fol edhe për rininë në vendet e tjera. Pa dyshim rinia në ato vende ka hallet dhe problemet e

veta, ka drogën dhe papunësinë, po edhe rinia jonë ka hallet dhe problemet e veta, të cilat ne i ndiejmë dhe i dimë, se jemi vetë të rinj, por që për to nuk guxojmë të flasim apo flasim vetëm me shokun më të ngushtë, dhe me atë me gjysmë zëri. Në mbledhje apo në rreth të gjerë nuk diskutojmë kurrë për to.

- Për çfarë problemesh nuk guxokemi të flasim?! - u hodh Miranda Kolluri.

- Po përmend vetëm njërin: që duhet të kemi më shumë liri. E ke ngritur ndonjëherë ti këtë, shoqja Miranda?

- Liri për çfarë? - ia ktheu me vrull ajo.

- Së pari për një të drejtë, për të cilën ka filluar të flitet kohët e fundit, për pluralizmin e mendimeve. Po nuk e kam fjalën vetëm për këtë të drejtë, e kam te liria në një kuptim më të gjerë. Pse nuk e njohim ne Deklaratën e Përgjithshme të OKB-së mbi të Drejtat e Njeriut, ia kemi bërë vetes ndonjëherë këtë pyetje?

Të gjithë pamë njëri tjetrin në sy - as që e dinim se ekzistonte një deklaratë e tillë.

- Ç'flet ky? - ia bëri Miranda si të ishte duke dëgjuar marrëzinë më të madhe.

- Boçka, ne kemi sistemin tonë të së drejtës dhe nuk kemi pse të huazojmë nga të tjerët, - ndërhyri me të shpejtë mësuese Lumturia, mjaft e turbulluar.

- A jam i lirë të flas? - pyeti Alekoja me nervozizëm.

- Mund të flisni, por...

- Shoqja mësuese, pikërisht me atë "por" ju më hiqni lirinë e fjalës. Kjo Deklaratë është shpallur që më 1948 por ne, pas më shumë se 40 vjet, ende nuk e njohim. - Alekoja fliste gjithnjë e më shpejt. - Nenet e asaj Deklarate u garantojnë njerëzve liritë më themelore, ndalojnë grabitjen arbitrarisht të pasurisë, theksojnë të drejtën për mbrojtje ligjore, lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të besimit, të shpërndarjes të informacionit pa kufizime e të tjera. Pse mos ta njohim edhe ne?

Mësuesja vuri buzën në gaz në mënyrë patronizuese.

- Sepse legjislacioni ynë i mbron fare mirë të drejtat e njeriut. Kush do të flasë tjetër?

- Nuk kam mbaruar, - tha Alekoja. - Mirë, nuk do flas për të, po për diçka tjetër, që lidhet me zgjerimin e lirive tona, të të rinjve. Ja, tani vjen vera. Nuk do të ishte më mirë që gjatë asaj kohe ne të hyjmë në punë që të marrim ndonjë lek për t'u veshur, sesa të shkojmë nëpër aksione?

Përnjëherë klasa u mbush me gumëzhima e zhurma, përmes të cilave u ndje edhe ndonjë klithmë habie.

- Pse, nuk qenke dakord që rinia të shkojë në aksione? - e pyeti mësuesja, edhe ajo pa e fshehur habinë që i kishin shkaktuar ato fjalë.

- Të paktën të na paguajnë, - foli prerë Alekoja.

- Në një farë mënyre paguheni, se edhe ju përfitoni nga veprat që ndërtoni, nga hekurudhat, rrugët, tokat e reja...

- Përfitojmë sa gjithë të tjerët, kurse ne kemi nevoja të ngutshme.

- Kjo është kulmi! - tha Ilir Karaj. - Kjo është shprehje e individualizmit mikroborgjez, krejt e huaj për moralin tonë!

- Po, - e pasoi mësuesja. - Alekoja gjykon gabim, pasi shoqëria jonë e ka në konceptin e saj punën vullnetare në të mirë të të gjithë shoqërisë, e cila nuk duhet parë në një prizëm të ngushtë. - Ndërkohë pa orën e dorës dhe shtoi: - Ndonjë gjë tjetër?

- Me leje, presore? - u dëgjua përsëri zëri i Ilir Karajt. - Dua të diskutoj për ato që tha parafolësi.

- Vetëm shkurt, - i tha mësuesja duke parë orën përsëri.

- Mendimet e Alekos të revoltojnë! - ia nisi ai me vrull. - Të jesh kundër aksioneve të rinisë që kanë zbukuruar atdheun tonë, që... janë krenaria e kësaj rinie... Kur hekurudhat, tarracat, elektrifikimin e të gjithë vendit na i ka zili e gjithë bota... Kjo është kulmi! - vazhdoi ai duke iu marrë goja. - Nuk... As që e quaj të denjë që... Edhe atë kryqin ai nuk e ka vënë sepse beson, po për të ringjallur besimin fetar tek të tjerët, i nxitur ndofta nga dikush që e ka halë në sy sistemin tonë. Sepse po të shikojmë edhe biografinë e tij familjare...

- Me familjen time nuk ke punë, - ia ktheu Alekoja i bërë dyllë në fytyrë. - Sqepi yt prej papagalli është shumë i vogël për të më çukitur në atë mënyrë.

U bë zhurmë, gumëzhimë zërash, u dëgjua dhe ndonjë e qeshur.

- Me qetësi, ju lutem! - tha mësuesja. - Mos e teproni!

- Dashka liri zoti Aleko! - vazhdoi Ilir Karaj. - Posi, do t'i themi: urdhëro një pasaportë për jashtu shtetit! Ku dëshironi të shkoni?

- T'i hapim edhe diskotekë... - tha Arlinda Gjoni.

- Edhe plazh nudistësh! - tha dikush dhe në çast shpërthyen të qeshura.

- T'i sjellim edhe disa revista të huaja! - ironizoi edhe Elkana

Verdha duke lëvizur duart nën bankë, me siguri për ta ngritur fustanin edhe më lart. Në klasë vazhduan të qeshurat.

- Harruam se duhet t'i hapim edhe një kishë ku të falet! - foli prapë Iliri. Zhurmat dhe të qeshurat vazhduan dhe mësuesja mezi e vendosi qetësinë.

- Ç'të hipi? - i fola Alekos me inat. - Kërkon të të fusin në kallëpe të tjera?

- A nuk na u tha të flasim lirisht?

Për habinë time, por edhe të të tjerëve mësuesja, si ta kishte dëgjuar, përforcoi pikërisht fjalët e Alekos:

- Alekoja foli hapur dhe lirshëm, - tha ajo, - gjë që unë e quaj pozitive. Përgjithësisht mendimet e tij nuk i gjej të drejta, vetëm me ndonjë mund të pajtohem. Fjala vjen shqetësimi i tij dhe i ndonjë tjetri për disa kufizime lidhur me veshjen është i drejtë. Edhe muzika, filmat dhe letërsia huaj nuk mund të merren të gjitha si të papranueshme. Mendimet e tjera, sikurse edhe ju, nuk i aprovoj.

Ra zilja dhe klasa u mbush me zhurma e lëvizje, por mësuesja na u lut të dëgjonin edhe dy fjalë të fundit:

- Gjithsesi, - tha ajo, - mendimi im për këtë bisedë është se ju treguat një nivel të lartë pjekurie ideologjike dhe revolucionare.

E kënaqur, me një vështrim të qeshur, mori regjistrin dhe doli.

13

Derisa mbaroi ora e gjashtë isha si nëpër mjegull, pa e patur mendjen në mësim. Jo vetëm unë, se tek të gjithë binte në sy një farë hutimi e shpërqendrimi. Po krahas kësaj gjendjeje, paradoksalisht, në momente të veçanta bënte krye edhe një lloj humori e gjallërie që mbante vetëm pak kohë. Të bëhej sikur ndjesitë, që njeriu i përjeton vetëm individualisht, ishin shkëputur prej secilit dhe duke u formësuar si shpirtra të hapësirës, kishin filluar pluskonin në ajri; ndjesi nga më të ndryshmet - gjallëri, humor, gëzim, trishtim, shpresë, e mbi të gjitha, sensi i një të panjohure të pritshme, e ngjashme me ankthin, një ankth që doje të merrte fund sa më parë për të shkuar përtej së panjohurës abstrakte në mënyrë që të dilje në një breg real e të bukur, por të tillë që edhe të ngjallte frikë pikërisht për shkak të bukurisë së re dhe të panjohur. Të dukej se ngado

ndeshje në pështjellimin e këtyre ndjesive pluskonjëse, të cilat vinin duke u polarizuar derisa ndaheshin përfundimisht në dy grupime - në njërin hynin ndjesitë pesimiste, se diçka e tmerrshme përgatitej të ndodhte, kurse në tjetrin ato optimiste, se çfarëdo që të ndodhte do të ndodhte për mirë, për t'i hapur rrugën diçkaje të re.

Mbledhja e organizatës së rinisë, që u bë pas orës së gjashtë, që më e çuditshmja jo vetëm për mua, por edhe për gjithë të tjerët. Erdhën edhe Arshiu me drejtoreshën si dhe mësuese Lumturia, të cilën e kishim mësuese kujdestare. Mbledhjen e hapi Miranda, serioze dhe pompoze. Na tha se ajo mbledhje e jashtëzakonëshme organizohej si për shkak të gjallërimit të disa mbeturinave fetare - kjo për organizatën tonë - ashtu edhe për shkak të shfaqjeve e qëndrimeve armiqësore të disa elementëve - kjo jo për organizatën tonë, por që ne duhej të diskutonim edhe për to, pasi ishim të rinj që jetonim intensivisht me situatat.

I pari, si gjithmonë, foli Ilir Karaj, i cili pasi diskutoi për ndonjë gjysmë ore përfundoi se "si masë për Alekon mendonte përjashtimin që sot nga organizata e rinisë". Pas tij, për çudi, askush nuk u ngrit. Ra një heshtje e thellë dhe e zyrtë, kaluan rreth dhjetë minuta kur Arshiu, i bërë tym, u çua vrik e ia plasi:

- Ç'është kjo heshtje?! Mos do të thotë se solidarizoheni me veprimin e shokut tuaj?!

Heshtja prapë vazhdoi. Dreq o punë, të vinte edhe si frikë, edhe si gëzim, nuk e di pse. Mendoja se në mesjetë, kur Inkuizicioni shpallte heretik ndonjë kundërshtar, turmat me siguri një heshtje e tillë i mbulonte. Vetëm kur Arshiu, në kulmin e zëmërimit, i tha Mirandës që ta mbyllte mbledhjen, klasa u shkund dhe u ngrit Bledari, pas tij disa tjerë, Agroni e më në fund edhe unë, e që të gjithë një vrime i ramë, jo morali revolucionar, jo edukimi materialist, po kur vinte puna për të dhënë gjykimin për masën - shumica ishin për vërejtje me "shkrim". Mirëpo ç'u nxeh Arshiu! Ia nisi një ligjërate të mërzitshme: jo qëndrim konformist, jo pajtim me konceptet fetare e plot këso gjërash. Në fund mezi u arrit shumica minimale e votave për "paralajmërim për përjashtim". Më erdhi keq që edhe Agroni votoi për këtë masë. Me kaq mbledhja u mbyll.

Ecnim të katër, Agroni, Alekoja, Bledari dhe unë. Pak përpara nesh ecte Ilir Karaj me hapa të nxituara, gati duke vrapuar. Dy tri herë ktheu kokën nga ne, gjë që na bëri përshtypje.

- Papagalli! - shau Alekoja.

- T'ia shtypësh turinjtë! - pasoi Bledari.

Atë kohë na afrohet si furtunë Aladin Dulja. U habitëm, pasi ai shkonte në tjetër rrugë për në shtëpi.

- Ku u zhduk, qeni? - na pyeti duke zgjatur qafën. E kuptuam që e kishte fjalën për Ilir Karajin. - Ah, ja ku qenka! - tha dhe si na tundi dorën t'i shkonim pas, ia dha vrapit.

Pamë në largësi se edhe Ilir Karaj ia kishte mbathur vrapit. Aladini, me trupin si të ariut, dukej krejt kaba në të vrapuar, veçse e ndihmonin shalët e gjata. E arriti Ilirin në një vend ku rruga zgjerohet sa gati kthehet në një shesh. Ne ishim ende larg po skenën e pamë - Aladini e mbërtheu Ilirin nga xhakoventoja, e ngriti peshë dhe si e përplasi për tokë u përkul mbi të duke i futur dorën nën xhaketë. Me siguri kërkonte bllokun, dhe ja ku e nxori. Pastaj, duke e hequr Ilirin hosh iu afrua një pusete në anë të rrugës ku në një nga të çarat e zgarës lëshoi bllokun. Atë kohë ne u ndodhëm pranë tyre.

- Ç'ia bëre mirë! - i tha Alekoja. - Aty e kishte vendin!

- Lëshomë! - bërtiste Iliri.

- Të hapim pusetën që ta futësh edhe atë brenda? - tha Bledari me shaka, por që e morëm për të vërtetë sepse e pamë me qortim.

- Për nder ashtu e do! - bubulliti Aladini dhe si i dha një të shtyrë të fundit, e hodhi tej.

- Do të ma paguash! - bërtiste Iliri duke fshirë hundët e gjakosura. - Në burg ke për të përfunduar!

- Çuna, ju s'patë gjë, ë? - tha Aladini.

- Je në vete, o Dine? - i thamë. - Këtë e ka pasur hak prej kohe!

Ndërkohë hodhëm sytë rrotull. Veç disa kalamanjve e nja dy të rriturve, që qëlluan aty pranë, nuk pamë asnjë nga klasa apo shkolla që mund të dëshmonte kundër Aladinit. Një i moshuar tha: "Pse ziheni, o djema, apo doni t'i bëni qejfin armikut?" po nuk ia varëm. Aladini u nda nga ne dhe mori rrugën e shtëpisë. Ilir Karaj, pak më tej, po shkundte rrobat. Kujtova se po qante, po jo, vetëm shtrëngonte buzët duke sharë nëpër dhëmbë.

Po atë ngjarje e harruam shpejt dhe u kthyem te biseda rreth mbledhjes. Agroni tha se ishte i kënaqur me masën që iu dha Alekos, kishte pasur frikë mos Arshiu i bënte presion organizatës për ta përjashtuar prej saj.

- Punë e madhe! - tha Alekoja.

E pamë me habi.

- Si punë e madhe? - i thashë. - Ashtu nuk do të shkoje kurrë në universitet!

Alekoja e kishte ëndërr të vazhdonte për informatikë, kishte gjetur libra kompjuterash dhe i studionte.

- Se mos pa u përjashtuar do të shkoj, - tha me hidhërim. - Kush i jep të drejtë studimi djalit të një ish të burgosuri politik?

- Mos u mërzit, - i tha Bledari. - Gjërat do të ndryshojnë, mund të shkosh në universitet edhe pas një viti, pas dy...

Alekoja nuk reagoi, kurse unë dhe Agroni u pamë sy më sy. Fjalë të tilla nuk i prisnim nga ai. Mendonte megjithë mend ashtu apo na provokonte? Ai gjithnjë më ishte dukur fjalaman, i dhënë më shumë pas bisedash për femrat sesa për gjëra serioze. Edhe pse prindërit i kishte intelektualë - të atin profesor psikologjie kurse të ëmën mësuese rusionteje - asnjëherë s'e kisha dëgjuar të shprehte ndonjë konstatim të mprehtë për realitetin, siç bënte fjala vjen, Alekoja. Nuk dija nëse me fjalët që sapo tha kishte shprehur një besim të vetin, apo kishte patur qëllim të na tatonte pulsën?

- Bledar, ku e ke fjalën kur thua se gjërat do të ndryshojnë? - e pyeti Agroni.

- Pse, kaq e vështirë është për t'u kuptuar? - u përgjigj Bledari. - Siç po duken punët, nga ky sistem do t'i lajmë duart shpejt. Derisa filloi në Lindje...

Që të tre e pamë drejt e në sy. Nuk m'u duk se shtirej. Agroni u turbullua, ose më mirë e pushtoi frika. Gjithnjë ishte ndruajtur të shprehej siç mendonte, por e dija se në thellësi të vetes kishte edhe bindje objektive. Më shumë kishte frikë të binte në sy se kishte mendime "liberale", gjë që shpesh e bënte të dukej dogmatik.

- Edhe ti e paske këtë mendim? - e pyeti Agroni me habi Bledarin. - Dashke të lajmë duart nga ky sistem?!

- Po ti vërtet vazhdon të besosh se është i përjetshëm? - iu kthye Alekoja në vend të Bledarit duke qeshur me një ironi të dukshme. - Nga nisesh ti për të gjykuar se është i pavdekshëm, nga duartrokitjet e turmave nëpër metingje e festa, nga brohoritjet hysterike për udhëheqësit apo nga jeta reale, që është turpi i botës? Nuk arrin të kuptosh se ato duartrokitje janë puthje të një dore që s'e kafshon dot, një masë mbrojtëse për të mos u zhytur në një mjerim më të madh, për të mos u damkosur si kundërshtar ndaj sistemit? Nuk arrin të kuptosh se po të mos duartrokasësh, njerëz të vënë apostafat të shënojnë nëpër blloqe si ai i Ilir Karajit?

Agroni u nguros. Me Bledarin mund të përdorte edhe slogane, po me Alekon s'e kishte të lehtë. Edhe unë u shtanga nga fjalët e Alekos: si masë mbrojtëse për të mos u zhytur edhe më thellë në mjerim, populli detyrohet të zgjedhë brohoritjet për shkaktarët e mjerimit. Përfytyrova një të plagosur duke puthur dorën që i ka ngulur thikën për të mos ngrënë një goditje tjetër.

Më shkundën fjalët e Alekos, që vazhdoi:

- Tani nuk është më sekret për asnjëri që komunizmi këtë vend e shkatërroi më shumë nga ç'e kishte shkatërruar Turqia për 500 vjet. Dhe shkatërrimet, të paktën këtu tek ne, i filloi sapo lindi, sepse tek ne ai lindi një foshnjë e përbindshme...

- Aleko!... - Agroni nuk mundi të thoshte më shumë, vetëm rrotulloi sytë duke na parë me radhë. - Ç'do të thuash me këtë?

- Atë që flitet: se që në fillim prijësi e mori pushtetin me intriga dhe kurthe, madje duke spiunuar e zhdukur edhe shokët e vet...

- Toni, ti ç'thua? - më pyeti Agroni, zverdhur në fytyrë.

- Edhe mundet, - i thashë. - Kush mund t'i dijë të vërtetat e asaj kohe? Dëshmitarët ose kanë vdekur, ose janë ende nëpër burgje.

- Është e pamundur! - tha ai me revoltë. - Aleko, këto janë trillime dhe nuk bën aspak mirë që i përhap. Janë me shumë zarar dhe...

Alekoja e pa në mënyrë sfiduese.

- Po nëse këto krime dalin të vërteta ç'do të bëhet me ata që i mbrojnë?

Aleko u kapërdi, pa mundur të fliste një fjalë.

- Nuk ka asgjë të habitshme, - tha Bledari. - Nga një i etur për pushtet çdo gjë mund të pritët. Këto mund të jenë vetëm maja e ajsbergut, më vonë kushedi sa gjëra të tjera mund të dalin në dritë.

- Ky qe fillimi, - vazhdoi Alekoja i nxehur. - E di ti që më pas, kur e mori mirë fuqinë, e grabiti këtë popull në mënyrën më mizore? I beson ti dokrrat se ka mbajtur çorape të arnuara? E di ti se vetëm me paratë që princesha harxhon për kozmetikën mund të jetojnë qindra familje? Se po aq harxon edhe e ëma, se helbete, edhe plakushja do të duket e bukur tani në pleqëri?

- Je në vete?! - u habit Agroni.

S'kishte faj, me siguri s'kishte dëgjuar asgjë. As unë s'kisha dëgjuar, vetëm mbrëmë daja më kishte folur diçka. Ngaqë Agroni gjithnjë e kishte patur të atin me pozitë - jo në majë fare, ku do

të dinte shumë më tepër se të tjerët, dhe as poshtë fare, ku prapë do të merrte vesh shumë gjëra që fliteshin lart e poshtë, - askush nuk guxonte t'i shprehte gjëra të tilla.

Kishim arritur te kryqëzimi ku rrugët tona ndaheshin.

- Prisni, - tha Bledari, - t'ju tregoj një barceletë, nga ato që kanë filluar të qarkullojnë...

- Jo, unë ika, - tha Agroni. Me siguri i dridheshin gjunjët, aq të shokuar e ndjente veten.

- Prit, pra! Mos ma prish...

E mbajti me zor dhe Agroni qëndroi. Sa për mua jua kam thënë që isha i thekur për barceletë, sidomos për punë femrash, po edhe për ato "me spec".

- Një emigrant i ikur pas çlirimit në Amerikë, duke i besuar propagandës sonë se vendi ynë ishte bërë më i lulëzuar në botë, vendos të kthehet për të kaluar pleqërinë. Para se të nisej disa shokë i thonë: "Po qe vërtet mirë, na dërgo një fotografi ku të kesh dalë në këmbë, po qe keq, na e dërgo ku të kesh dalë ulur." Bukur, vjen emigranti këtu dhe pas ca kohe ua dërgon fotografinë, po si kishte dalë, thoni ju? I shtrirë barkas!

Qeshëm. Qeshi dhe Agroni, po si me frikë. Ai me Bledarin u ndanë me ne dhe ikën.

Unë e Alekoja vazhduam bashkë. I thashë të më përcillte deri te stacioni, meqë isha më larg. Rruga ishte plot lëvizje, njerëzit ktheheshin nga puna. Fytyra të lodhura, të vrara. Grupe djemsh e vajzash që ecnin shpenguar, duke qeshur e britur me njëri tjetrin. Rruga e pistë, e mbushur me plehra e me copëra gazetash të shqyera, si ëndrrat e njerëzve. Dyqane të rrallë, gati inekzistentë, të varfër, të zbratur. Një vajzë e vogël na kaloi pranë duke shtrënguar fort një shishe me qumësht. Në atë orë nuk gjeje kurrë qumësht se shitej që pa u gdhirë dhe mbarohej brenda një ore; ishte i lumtur ai që arrinte të merrte. Në shtëpinë tonë nuk shkonte njeri për qumësht, se mamaja e kishte zgjidhur ndryshe: na e sillte në shtëpi një plakë e varfër për 50 qindarka më shumë për shishe.

Në të djathtë tonën, në trotuarin përtej, u duk një grup policësh me shkopinjtë e gomës në duar. U drodha - në çast m'u përhijuan ngjarjet e një nate më parë. Edhe fytyra e Alekos u murrëtye.

- Aleko - e pyeta me t'u gjendur larg policëve - ç'thua ti: vërtet ka marrë fund ky sistem? Është sistemi i dështuar apo janë bërë gabime në kurriz të tij?

- S'është puna vetëm te gabimet, - tha ai. - Në të vërtetë ato janë të pafundme, disa të qëllimta e disa jo. - Puna është te thelbi, dështimi qëndron pikërisht atje. Lëre anën e jashtme të lustruar, jo barazi e drejtësi për të gjithë e ku di unë. Në teorinë e komunizmit shkencor, siç quhet, dy janë pikat më të dobëta: e para, ai zhduk e pronën private, gjënë më të shtrenjtë të njeriut, djersën e tij dhe të brezave, duke e kthyer në pronë të askujt dhe e dyta, zhduk individin, zërin e tij vetjak, sepse i humbet identitetin. E para e shkatërron një vend ekonomikisht, pasi mungon nxitja për prodhim, s'ka interes për punë dhe krijim, e dyta shkatërron njeriun, shpirtin e tij, pasi njeriut i janë hequr të gjitha të drejtat njerëzore: e drejta për të qenë i lirë, për të folur e shprehur ato që ndien, për shkuar ku të dojë, për të banuar ku të dojë e kështu me radhë. Propaganda jonë thotë se vetëm në socializëm njerëzit janë të lirë. Në të vërtetë është e kundërta. Ndofta vetëm në skllavopronari njerëzit mund të kenë qenë më të skllavëruar se në socializëm. Nuk kanë fund kufizimet që socializmi, të paktën ky i llojit tonë, i bën njeriut. E kthen në automat, i than energjinë krijuese, kultivon tek ai jo krijuesin, por shkatërruesin. Është komunizmi ai, dhe jo imperializmi, siç thoshte Marksi, që herët a vonë krijon varrmihësit e tij. Sepse vjen një kohë që shkatërrimi ekonomik, plus ai shpirtëror dhe moral, arrin pikën më të lartë, në krizë, dhe njerëzit, duke i rrokur gjërat në thellësinë e tyre, nuk mund të pajtohen më me atë gjendje dhe ngrihen për ta përmbysur. Pra kryejnë një revolucion social, jo socialist, shkatërrimtar. Një revolucion që nuk është në kah të kundërt me natyrën njerëzore, por në përputhje me të. Ky është revolucion demokratik, dhe ishalla tek ne zhvillohet pa gjak... Të paktën pa aq shumë gjak sa ç'kanë shkaktuar revolucionet komuniste, ose më mirë antirevolucionet.

- Edhe daja im po këto mendime ka. Kur ju dëgjoj juve bindem, po kur jam vetëm dhe iu rikthehem bisedave me mend më duket se kaloni në ekstrem.

- Mirton, edhe mbrëmë, kur u kthyem nga sheshi të thashë: nëse nuk je dakord me mua s'prish punë, mund t'i lëmë këto biseda. Veçse ti vetë më pyete...

- Ke të drejtë, - pohova si me turp. - Edhe një shok tjetër si ty mendon, - i thashë për Arditin. - Vetëm që nuk ka përgatitjen tënde.

Kishim arritur fare pranë stacionit por nuk më bëhej të ndahesha

me të. Çudi, sa vinte e më shumë më tërhiqte ai njeri.

- Dëgjo, - më tha pas një heshtjeje, - po të të jap diçka për të lexuar nuk i thua njeriu?

- Ndonjë gjë që e ke shkruar vetë?

- Jo. Janë disa poezi të një poeti të ri, të pushkuar në burg.

U drodha kur dëgjova ato fjalë, për nder që u drodha. Edhe në fytyrë do të qeshë zverdhur, se Alekoja më pa me habi, madje me shqetësim. Dora që kishte futur në çantë i mbeti krejt e palëvizur.

- Ç'ke? - më pyeti. - Nuk do?...

- Si jo? Po se si më erdhi... Do t'i lexoj edhe sikur...

- Sikur çfarë?

- Hiç, hiç. M'i jep!

Më hipi një dalldi e papritur, një si inat me veten që për një çast isha treguar i dobët. Alekoja nuk vazhdoi më me pyetje por nxorri nga çanta një tufë letrash të daktilografuara dhe m'i dha. I mora dhe i futa me të shpejtë në çantë, duke hedhur një vështrim të mirë rreth e rrotull.

- E quajnë Trifon Xhagjika, - më tha pas pak. - E ke dëgjuar?

- Jo. Ti... nga e ke dëgjuar? Kush t'i dha poezitë e tij?

- Babai. Së pari ai më ka folur për të. Ky poet kishte vdekur shumë vjet përpara se të burgosej babai, po në burg kishte ende të burgosur që e kishin njohur dhe i kishin folur për të. I kishin dhënë edhe poezitë. Veçse të lutem, Toni, nuk do t'ia tregosh kurrkujt, ë? Të lutem.

- Mos ki merak, - i thashë. - Janë të bukura?

- Kur t'i lexosh, gjykoi vetë. Ndonjë dhe mund ta kopjosh, vetëm do ta ruash në fshehtësinë më të madhe, më premtan?

- Mos ki merak, pra! Ja, të jap fjalën e burrit, - i thashë dhe i zgjata dorën. Edhe ai më zgjati atë dorën e tij të vogël e të ligur, ku përmes lëkurës së hollë mund t'ia numëroje të gjitha kockat.

Ai iku. Mbeta vetëm, në afërsi të stacionit të autobusit ku do të hipja. Isha tepër kureshtar për t'i lexuar ato vjersha. Le që dihet, çdokush është kureshtar për të lexuar gjëra të ndaluara.

Autobusi po vinte, nxitova dhe hipa. Të gjithë autobusët urbanë rrangallë ishin, po ky që erdhi tani, një "fizarmonikë", ishte

tmerr, i ndryshkur i tëri nga jashtë, me xhamat të thyera, me sediljet ca të shkulura e ca të sakatuara sa të vinte për të vjellë. Duke u shtyrë mes njerëzve mendoja: vallë vërtet kishim nisur të jetonim në kohëra analoge me ato kur revolucionarët, komunistët - të gjithë ata që në ndërgjegjen time ende vazhdonin të ishin mishërimi i idealit më të pastër, për hir të të cilit ia vllente të sakrifikoje gjithçka, madje edhe jetën - këmbenin me njëri-tjetrin literaturë të ndaluar? Nëse dikur ata kishin qenë luftëtarë në emër të idealit më të lartë por që tani, fatkeqësisht, ishin kthyer në të kundërtën e tyre, ne të tjerët kush ishim?

Ishim revolucionarë demokratë apo viktimë e një keqkuptimi të llahtarshëm? Ishte vallë aq e lehtë të besoje se ata që kishin vendosur një demokraci proletare, socialiste, të ishin kthyer në antidemokratë? Mos disa gabime - dhe ato dukeshin sheshit - po i visheshin së tërës duke e quajtur totalisht të gabuar? Ishte e pamundur t'u jepje përgjigje të gjitha këtyre pyetjeve. Për më tepër brenda një kohe të shkurtër, siç po precipitonin ngjarjet. Jo, mbase do të duhej më shumë kohë dhe më shumë gjakftohtësi për të menduar për to. Edhe më shumë qetësi.

Nga stacioni i autobusit unë i bie për në shtëpi përmes disa pallateve. Aty rrotull e ka shtëpinë edhe Arditi. Kur kthehem nga shkolla ndodh të takohemi shpesh - a rastësisht, a më ruan dhe më del përpara - nuk e di. Po ashtu edhe sot, më doli përpara. U habita kur e pashë aq shumë të ndryshuar. Njërin sy e kishte të nxirë kurse anash mjekrës kishte vënë një manikoto lejkoplasti. Vura re se edhe dorën e djathtë, mbi kyç, e kishte të fashuar.

Me të më parë më thirri t'i shkoja pranë, pa luajtur vendit.

- Ç'je bërë kështu? - e pyeta. - Ç'të ka ndodhur?

- Ndeshe me demat... - tha duke vënë buzën lehtë në gaz. Nuk e mora vesh mirë - e kishte fjalën se mbrëmë kishte qenë në shesh? - E tregova veten toreador, jo mi të ngordhur, - vazhdoi. - Ti ç'bëje mbrëmë, rrije pas fustanit të mamasë?

- Pa mos më çaj kokën! - ia ktheva me inat. - Çun mamake nuk jam, po nuk jam as aq i fortë sa ndeshem me demat.

- Ka kush ndeshet me ta. Ky qe vetëm fillimi, bebush. As fillimi, bile, vetëm fishkëllima e arbitrit. Prit, prit, pa ke për të parë si do të vringëllijnë hanxharët! - vazhdoi ai duke përdredhur buzët dhe duke i dhënë përt! një të pështyre me cepin e tyre. Kur ishte i inatosur gjithnjë kështu pështynte. Nisa ta hetoja në fytyrë nëse fliste me gjithë mend apo frynte me mua.

Pamjen e kishte të qetë, po prapa asaj qetësie, ose më mirë prapa përpjekjes për t'u paraqitur disi hokatar apo shpotitës, fshihej një tension i brendshëm.

- Ajo mbrëmë qe si punë nxemjeje, kupton? - vazhdoi. - Si ajo përpjekja në Shkodër për të hedhur poshtë Mustaqen. Po do të ketë ndeshje të tjera, të egra. Mos u dridh nga këto fjalë, ë? Ne jemi proletarë. E ç'do të humbasim, veç zinxhirëve? Kush e ka thënë këtë, Marksi? Hë pra, thuaj që nuk qenë burrë i zgjuar, babai i fukarenjve... Vetëm se ai Engelsi, që i hiqej si shok, i lëvronte të shoqen, apo jo? Nejse, punë e tyre, po dëgjo, do të vish sonte në shtëpinë time? Do të shtroj një suarë për nder të një beteje që kam pikturuar në mendje. Ti mbase s'e kupton se ç'do të thotë kjo, po s'ka rëndësi. Ç'thua, do të vish?

- Kush do të jetë tjetër?

- Do ta marrësh vesh. Ke për t'u kënaqur, e them me gjithë mend.
- Papritur ai u bë i përzëmërt e i afruar, si dikur; sytë e zinj m'i kishte ngulur gjithë dashamirësi.

- Po të shtëpisë aty do të jenë?

- Jo, kanë shkuar te disa njerëz në Fier. Dëgjo, nga ora tetë, mirë?

- Të shoh, - i thashë. - Ti e di si i kam punët në shtëpi, m'i kronometrojnë hyrjet e daljet si në kazermë. Dëgjo, mbrëmë je bërë ashtu?

- Spiun s'ke qenë kurrë, po mos je bërë kohët e fundit? - më tha me shaka, mirëpo u preka, dhe u preka shumë.

- Ej, Ardit, kë fyen ti, mua?

- Më fal! - tha me sinqeritet dhe më shkoi dorën në faqe. - Bëra shaka, për kokë të mamasë. Po, mbrëmë. U bë katrahurë, veç të kishe qenë... As vetë nuk e di si kam shpëtuar. E di që ti ndryshe i shikon këto gjëra, po kjo s'më prish punë fare, për mua do të jesh ai që ke qenë. Harroj unë sa herë ke ndarë bukën me mua? Sa herë më ke qerasur? - Tek fliste kështu iu drodhën buzët dhe sytë iu veshën nga një cipë e hollë, e lagësht. - Po atë vit kur më dhe pulovrën prej leshi dhe në shtëpi u the se të kishte humbur? Dhe që të dy e shkëmbyem me pulovrën e një djali të vitit të katërt për të humbur gjurmët? Mirton, nëse nuk vdiqa atë vit nga të ftohtit nga pulovra jote shpëtova...

- Lëri këto, - i thashë. - Ç'i kujton?

- Ta dish që unë s'harroj kurrë. Punë e madhe se politikisht i shikon ndryshe gjërat, armiku im s'do të jesh kurrë. Se ti mund të

thuash rroftë e goftë ky sistem, po unë... - Tundi kokën si për ta vazhduar mendimin dhe për t'i vënë pikë fjalisë. - Për atë që të tregova, që isha mbrëmë atje, mos nxirr asnjë llaf, ë? Se më fik, Toni, më kupton?

- Ç'është ajo fjalë, Ardit! Si mund të flas? Pastaj... edhe mua mos më kujto kalë karroce, ta dish!... - Desha t'i thosha se edhe unë kisha qenë në shesh, po s'e bëra. Do të dukej sikur doja të barazohesha me të. Le që mos kisha meritë! Arditi kishte shkuar për t'u bashkuar me demonstruesit, po të vinte puna edhe për t'u përleshur, kurse unë thjesht nga kureshtja. A ishin njësoj këto?

- Ika, - i thashë dhe i zgjata dorën.

- Po të pres, - më tha. - S'ke për t'u mërzitur, ta dish!

Bëra një lëvizje të papërcaktuar me dorë dhe ika, gjithnjë duke menduar për të. Banonte me të ëmën dhe të motrën; i ati i kishte braktisur dhe bashkëjetonte me një tjetër. Dikur shkoja shpesh te shtëpia e tij, një si barakë prej një dhome e një palo kuzhine, që të dyja si kuvli, me mobilimin më të varfër që kisha parë ndonjëherë - varfëri absolute. I ati, një burrë i pashëm, mustaqelli, që punonte sa robtohej në hekurudhë, nuk arrinte kurrë t'i ngopte me bukë. Nja dy herë kishte qëlluar ta shikoja të dehur tapë dhe duke qarë, kurse e shoqja e qortonte duke i mbajtur lotët me zor. Megjithatë Arditi s'më kishte thënë kurrë një fjalë të keqe për të atin.

Shkova në shtëpi, hapa televizorin dhe u ula të haja. Italiani hynte mirë. Kur s'është babai në shtëpi mund të rri me orë të tëra përpara ekranit, sidomos kur ka filma. Filmat që më pëlqejnë më shumë janë ata që rrjedhin natyrshëm e ku nuk gjej kurrfarë sforçimi as në lojën e aktorëve e as në mjeshtërinë e regjisorit. Unë vdes edhe për filma humoristikë, për filmat e Çaplinit dhe për ata me Olion dhe Stelion. Për këta filma çmendem, për nder. Po u bëra ndonjë ditë aktor, do të luaj vetëm filma humoristikë. Po në filma me sforçime dhe artificia pa pikë fantazie, si ç'janë disa nga filmat tanë, s'do të luaj kurrë. Janë një mijë herë më të bukura skeçet e estradës me Tano Banushin e Shkodrës apo me Arqile Lipen e Fierit. Unë çmendem për këta aktorë, mund t'i shikoj ditë e net pa u mërzitur.

Në kohën që isha duke mbaruar së ngrëni filloi një film i Felinit, "Rruga". Ajo pjesa ku Xampanója fillon të mësojë Xhelsominën sesi t'i tërheqë vëmendjen publikut më bëri aq shumë për të qeshur sa më ngeci buka në fyt dhe nxorra një shkullm

thërrimesh nga hundët. Një film aq tronditës dhe prekës sa, për nder, të gozhdon. Më erdhi keq kur pashë orën dhe u kujtova se duhej të shkoja në Institutin e Arteve për mësimin e mjeshtërisë së aktorit me Xhezair Kazazin.

Xhezairin e gjeta në po atë sallë të madhe të mbushur plot me dekore e makete, që mua më pëlqente aq shumë. Mirëpo sot ajo sallë kishte një dekoracion krejt të veçantë: në mes qe ngritur një kasolle me kashtë, pa mure, por vetëm me disa hunj të vend të tyre, që mbanin çatinë, nga strehët e së cilës vareshin një sërë objektesh, disa fort të çuditshme: midis fenerëve kishte statueta, piktura, një pushkë, një litar me lakun ku futet koka e të dënuarit me varje, maketi i një djepi fëmije... Në njërin nga hunjtë, brenda hapësirës së kasolles, ishte mbërtheyr një portret tmerrësisht i frikshëm, një si kafkë me brirë, me dhëmbë të mëdhenj dhe me sytë të çakërryer. Rreth e përçark kasolles ishin vendosur stola dhe karrige. Nëpër hunj, po nga pjesa e brendshme, qenë varur qirinj.

Ai dekor më bëri një përshtypje të jashtëzakonshme. Mendova se Xhezairi do të ishte duke përgatitur ndonjë shfaqje me studentët, po vallë ç'pjesë do qe ajo që kërkonte atë lloj dekori dhe rekuizite? Mos do të qe ndonjë dramë e teatrit absurd? Në asnjë mënyrë, thashë me vete, jo më të përgatisje e të shfaqje, por edhe ta mendoje mundësinë e një gjëje të tillë të priste dënimi më i ashpër. I dhashë karar me vete të pyesja Xhezairin sapo të gjeja rastin.

Xhezairi rrinte në këmbë dhe shikonte me vëmendje dekorin që kishte përpara. Në duar mbante një fletore. Më pa, po nuk më foli menjëherë. As unë nuk fola, vetëm zura të shikoja përçark. Xhezairi ishte një djalë bojalli, i thatë, me fytyrë tërheqëse, me flokët të zez e të gjatë tej kufirit të "sigurisë". Si e lejonte dekani t'i mbante ata flokë nuk e merrja vesh. Nuk di në ju kam thënë që ishte shok me dajën, dhe pikërisht daja i ishte lutur të më jepte mësim privatisht, me para, (që do t'ia jepte ai) por që Xhezairi me para nuk kishte pranuar.

- I përsërite etydet? - më pyeti pa më parë, por gjithnjë i përqendruar sa te shënimet që kishte në fletore, e sa te dekori. Nuk kishte qetësinë e zakonshme, se ndërsa fliste te diçka tjetër i punonte mendja, madje te diçka që për të përbënte një preokupim të veçantë.

- Po, - i thashë.

- Mirton, të vjen keq ta lëmë mësimin për sot?

- Aspak. Me sa shikoj po përgatisni ndonjë shfaqje, apo jo?

- Shfaqje?! - Ai qeshi lehtë dhe rregulloi pozicionin e një pikturë që varej në strehën e kasolles. Piktura u kthye e tëra nga unë dhe munda ta shikoj mirë, që diçka që nuk arrita ta kuptoja, figura të ngatërruara, me një kompozim të çuditshëm ngjyrash e formash. Por duke qenë se e mbajta vështrimin gjatë munda të kapja diçka nga figuracioni: një valle makabre skeletësh të rrethuar vetëm nga trupa skeletikë, me helmeta në kafka, kurse në krahët kockorë shtrëngonin pushkët me bajonetat të drejtuara.

- Po, edhe shfaqje mund ta quajmë, vazhdoi. - Në të vërtetë është diçka më shumë. Në këtë mjedis do të bëhet një lloj aktiviteti i veçantë, prandaj dhe jam shumë i zënë.

- Nuk mund të ma thoni se ç'është?

- Është diçka që... - Ai hezitoi të ma tregonte dhe unë e ndjeva veten ngusht. - Për ty nuk besoj të paraqesë ndonjë interes. Kështu, do ta lëmë mësimin për një herë tjetër, mirë?

- Posi jo! - i thashë me një farë gjallërie të shtirë, pasi më erdhi keq që nuk munda të merrja vesh se ç'do të bëhej në atë dekor atë mbrëmje. Për më tepër që kur do të zbulosh diçka dhe mundësia për këtë të ikën nga dora një herë e mirë, kureshtja të shtohet edhe më shumë.

E përshëndeta dhe dola. Mirëpo nuk kisha bërë veçse disa hapa nëpër korridorin e gjatë kur Xhezairi doli te dera e sallës dhe më thirri. I shkova pranë gati me vrap. Ai më futi brenda e më tha:

- Po që se ke qejf... Qëparë u nxitova kur thashë se për ty nuk do të paraqiste interes. Jo, mund të të duket interesant.

- Ç'aktivitet është?

- Nuk do të ta them, por në qoftë se do të rrish për ta parë, do të më japësh fjalën se nuk do t'i tregosh askujt, dakord?

- Po, - i premtova dhe zemra më gufmoi. Jo vetëm u gëzova se do të merrja pjesë në një aktivitet që me siguri duhej të që diçka jashtë rutinës, por edhe për faktin që Xhezairi pati besim tek unë.

- Do të jetë edhe Sokoli, - më tha.

- Daja?! - u habita unë. Xhezairi qeshi dhe u kthye në punën e rregullimit të mjedisit duke më ftuar ta ndihmoja.

mbetur kushedi çfarë pune për të bërë, vetëm ndonjë rregullim i vogël aty-këtu. Për më tepër që pas pak erdhi edhe një person tjetër, një burrë rreth të dyzetave, të cilin Xhezairi ma prezantoi si dramaturg dhe poet. Më bëri përshtypje fytyra e atij njeriu - një fytyrë gjatoshë, thatime, me dy sy të thellë e si të mbushur me një dhimbje të pashuar. E quanin Lazër Nikolla, një emër që si turbull më dukej se e kisha ndeshur diku.

- Në ç'orë do të fillojmë? - pyeti Lazri.

- Në shtatë, - iu përgjigj Xhezairi duke u marrë me një kuti ku ishin vendosur nja dy dyzina qirinjsh.

Koha kaloi shpejt dhe ja ku filluan të vinin mysafirët e parë: një grua e bëshme rreth të pesëdhjetave, të cilën e njoha menjëherë - aktore e Teatrit Popullor, jashtëzakonisht e talentuar - me një vajzë të re, si ndonja tetëmbëdhjetë vjeçe, me një trup të gjatë dhe me një fytyrë të bukur e të ëmbël me syza, të cilat i jepnin një hijeshi të veçantë. Vazhduan të vinin trumba-trumba edhe të tjerët, burra, gra, vajza e djem të rinj e më në fund edhe daja, i cili më përqafoi, më puthi e më pëshpëriti: "Ah sa mirë që të paska mbajtur Xhezairi!" Kur erdhën të gjithë, rreth tridhjetë vetë - e me ç'dukej nuk pritej të vinte tjetër njeri - Xhezairi e mbylli derën me çelës dhe u kthye pranë kasolles, përballë nesh. Aty i bëri shenjë një djali të ri, i cili filloi të na shpërndante të gjithëve nga dy qirinj. U ndezën qirinjtë e vendosur në hunjtë e kasolles dhe u fikën dritat. Xhezairi na tha të ndiznim qirinjtë edhe ne dhe kështu ajo mbrëmje e çuditshme kishte filluar.

M'u mbush trupi me mornica. Nuk e kisha përfytyruar kurrë që ai mjedis, brenda një çasti, do të kthehej në mister, bukuri dhe mahnitje. Njerëzit rrinin të ulur në karriget e vendosura përpara kasolles me qirinj në duar me një solemnitet që s'e kisha përjetuar kurrë.

- Të nderuar zonja dhe zotërinj... - filloi Xhezairi.

U drodha si nga një valë e brendshme dhe instinktivisht pashë nga daja, fytyra e të cilit kishte marrë një pamje misteri dhe përvuajtjeje. Zonja e zotërinj!... përsërita vete, duke hedhur vështrimin rrotull. Vura re me habi se askujt nuk i kishte bërë përshtypje përdorimi i atij epiteti, me sa duket që përdorur edhe herë të tjera dhe njerëzit tashmë ishin mësuar. Daja e ndjeu shikimin tim, më vështroi dhe më buzëqeshi duke ma bërë lehtë me shenjë: "Shiko e dëgjo..."

- Ja ku u mblodhëm përsëri për të kremtuar së bashku këto

mbrëmje që i kemi titulluar "Mbrëmje Pikëllimi dhe Shprese..." Simbolikën e këtij titulli të gjithë e kemi të qartë. Por duke qenë se herë pas here na vijnë edhe mysafirë të rinj, po jap një shpjegim të shkurtër: nuk do të jetë e largët dita që epiteti "pikëllimi" do të hiqet për t'u zëvendësuar nga fjala "gëzimi"...

Heshti për një çast e vazhdoi:

- Ne mbledhemi për të reflektuar mbi pozitën e intelektualit, veçanërisht të artistit, në kushtet tona të sotme. Ne kemi marrë përsipër guximin qytetar për të shprehur lirisht mendimet dhe ndjenjat tona ashtu si i kemi, ashtu si i ndjejmë, jashtë çdo diktati dhe ndrydhjeje, jashtë çdo skeme dhe recete të gatshme. Jemi të vetëdijsëm se kjo është me rrezik, sepse diktatura nuk i fal përpjekjet për të medituar lirisht. Të gjithë e dimë mirë se deri ku shkon urrejtja e diktatorëve dhe e sistemeve diktatoriale për intelektualët në përgjithësi e për artistët në veçanti, pasi këta janë më të pashtuarit, më të pabindurit dhe më të guximshmit për të thënë fjalën e vërtetë... Sistemi diktatorial krijon botën absurde të urdhrit, të komandimit nga lart, dhe çdo mendim i lirë është një herezi, dhe janë artistët ata që përbëjnë shtresën më heretike të intelektualëve dhe që dënohen të parët në turrën e druve. Por çdo durim dhe nënshtrim ka një kufi, mendimin e lirë asgjë nuk e tremb, asgjë nuk e mposht, as edhe turra e druve... Në të gjitha vendet totalitare njerëzit kanë filluar ta shprehin hapur kundërshtimin e tyre ndaj diktaturës, dhe në këtë lëvizje ata i udhëheqin jo vetëm politikanët, por edhe artistët dhe intelektualët e vërtetë. Në këto mbrëmje, ku edhe ne kemi qëllim të shprehim kundërshtimin tonë, ne frymëzohemi jo vetëm nga guximi i tyre, po edhe nga brenga dhe mjerimi ynë... Nëqoftëse këtë nuk do ta bëjmë ne, jam i bindur që dikush tjetër do ta bëjë. Dhe le ta bëjë. Secili ka të drejtë të bëjë atë që mendon se është e drejtë. Edhe në Kinostudio kanë filluar të mbahen mbrëmje të tilla refleksionesh. Unë i përshëndes nga zemra ata njerëz mendjekthjellët që kanë filluar të përhapin një fjalë të re...

Përsëri shikova nga daja, por këtë radhë ai duket nuk e vuri re shikimin tim. Por dikush tjetër e vuri re - ajo vajza e bukur fytyrëhequr, e cila më pa në sy dhe më buzëqeshi. Qe një buzëqeshje e ngrohtë dhe e çiltër, që më detyroi edhe mua t'ia ktheja me buzëqeshje.

- Programi për sonte është ky: refleksione mbi pozitën e artistit në ditët tona, njohje me një pjesë të krijimtarisë së disa

artistëve tanë disidentë nga më të shquarit, të përndjekur apo të pushkatuar nga diktatura, si dhe interpretime dhe recitime nga disa shkrimtarë dhe poetë të huaj, të ndaluar deri më sot tek ne. Fjalën e ka zoti Adil Lamani, skenagraf, piktor dhe kritik arti, i dënuar me pesëmbëdhjetë vjet burgim dhe i liruar përpara pak kohe.

Nga rreshti i parë u ngrit një burrë i shkurtër, i dobët, me pak flokë, me një palë syza të errta. Xhezairi u ul në cepin e djathtë të kasolles dhe ndezi një qiri.

- Të nderuar pjesëmarrës, - tha ai. - Kjo që shikoni... - ai tregoi me dorë kasollen - është një nga përpjekjet e mija për të dhënë një imazh simbolik të atdheut tonë sot. Kjo flet vetë, nuk ka nevojë për koment... Atdheu ynë është katandisur kockë e lëkurë, por nesër nuk do të jetë i tillë. Nesër ai do të shndërrohet në një pallat, jo në piramidë, por në një pallat përrallor ku do të banojë i gjithë populli... Sot për këtë mjerim qajnë artistët, qajnë të gjitha zemrat që u dhëmb ky popull, qajnë të gjithë njerëzit e ndershëm. Këtu kam ekzpozuar dy tablo të Pikasos, të cilat mezi munda t'i siguroja: "Pëllumbin" dhe "Kitaristin e Verbër", simbole të cilët, që të dy, vlejné edhe për ne. Pëllumbi i bardhë është shpirti i pastër i çdo artisti, i çdo njeriu, kurse në kitarist të verbër diktatura ka kthyer cilindro artist të vërtetë... Mbi të është ushtruar një trysni shtypëse e përbindshme, tek ai është ndier zhgënjimi, udhëkryqi, gërmadha e ëndrrave krijuese, kllapia torturonjëse në ethet e shkaktuara nga indoktrinimi, kur ai donte të krijonte diçka të vërtetë, sipas urdhrit të shpirtit të vet, por që nuk mundej. Disa krijuan dhe u burgosën apo u pushkatuan, të tjerë heshtën duke pritur e shpresuar, të tjerë krijuan, por jo nga vetja, krijuan diçka të tjetërsuar, kurse një pjesë u konformuan dhe u mburrën me të... - Ai heshti, shkoi në njërën anë të kasolles, dhe u kthye përsëri me një tablo në dorë. - Kjo është një tablo e piktorit Vangjush Tushi, vdekur në burg përpara se të plotësonte dënimin. Paradoksalisht eshtrat nuk iu kthyen familjes: ato duhej të rrinin të varrosura në rrethinat e burgut për të plotësuar afatin e dënimit... E kam njohur atë njeri, ka qenë një personalitet i rrallë. Kur vdiq iu ndodha pranë. Mbi varrin e tij në një kodër të shkretë nuk u vu asnjë mbishkrim, por emrin ia shkruan në një copë letër, e futën në një shishe dhe shishen bashkë me trupin në varrin anonim...

Vura se nëpër sallë u end në një mërmërimë e ngjashme me një kuje vajtimtare të pazëshme, të fundbotshme. Dy tri gra pranë meje

filluan të qanin, pak më tej po qante një burrë, duke iu dridhur supet.

- Ja një nga tablotë e tij: e thjeshtë por edhe e madhërishme, si vetë ai.

Në dritën e disa qirinjve që u afruan tek tabloja ajo u duk qartë: një lëndinë dhe një pemë e lulëzuar, diçka që të kujtonte Van Gogun, ose më mirë një Van Gog krejt tjetër, me shpirtin dhe brengën e tij e pangjashme me asnjë shpirt dhe brengë tjetër.

- Kur të mblidhemi përsëri, - vazhdoi burri me syza të errëta, - do të mundohem të sjell ndonjë tablo tjetër nga ky piktor.

Ai u ul dhe Xhezairi njoftoi se tani do të njiheshim me dy artistë të tjerë disidentë.

- I pari është poeti Trifon Xhagjika, - tha ai, - i pushkatuar nga diktatura komuniste...

Trifon Xhagjika... jehoi ky emër brenda meje si një oshëtimë e shurdhër. Ku e kisha dëgjuar? Kush më kishte folur për të? Ah, po, Alekoja! Alekoja sot më kishte dhënë vjershat e tij! Sa mirë!

- Dhe i dyti, - vazhdoi Xhezairi, - është një poet tjetër i ri që ka vuajtur vite të tëra në burg, Visar Zhiti. Me ta do t'ju njohë më mirë zoti Lazër Nikolla.

U ngrit dramaturgu Lazër Nikolla, në fytyrën e të cilit më shumë se çdo gjë spikaste një brengë e thellë.

- Të nderuar pjesëmarrës, së pari do t'ju flas për poetin krejtësisht të panjohur, të pushkatuar nga dora e diktaturës komuniste 27 vjet më parë, dy ditë përpara Krishtlindjeve, më 23 Dhjetor 1963, për poetin që mbeti tridhjetenjë vjeçar, Trifon Xhagjikën...

Sallën e përshkoi një mërmërimë e zgjatur. U drodhën hijet e qirinjve dhe drita e tyre sikur u lëpi, duke vdekur, përgjatë mureve të sallës. U dëgjua një dënesë e pas saj një tjetër dhe, diku më larg, edhe të tjera e të tjera.

- Ky poet, - vazhdoi folësi, - u këput egërsisht në lulen e rinisë sepse diktatura njohu tek ai nje mendje e një zemër të madhe. Vargjet e këtij poeti, që ishin plumba, më vonë do të vazhdonin në vargje-predha, ndaj poeti nuk duhej lënë gjallë...

Folësi vazhdoi me disa të dhëna biografike nga jeta e poetit, tha se kishte qenë oficer dhe qysh në moshën më të re kishte filluar të shprehte protestën e tij ndaj regjimit me vargje të fuqishme, të thella në mendim e ndjenjë dhe me një figuracion të pasur simbolik dhe aluziv, figuracion që sa vinte e piquej duke

fituar përmasa të reja poetike. Në fund tha se nga ky poet kishte mundur të gjente vetëm dy poezi.

Pasi mbaroi folësi doli një djalë i ri, student, dhe nisi recitimin. Në sallë dëgjohej vetëm cërcëritja e qirinjve.

- Poezia e parë quhet "Atdhe", - tha ai.

*Një vend i ëndrrave pa fat
një vend latydësh të tërbuar
një vend i mendjeve sakate,
me turp e kusari mbuluar.*

*Një vend me fjalë kotësie,
ku vdekja e fshehtë është modë,
ku drita e Diellit u bë hije,
Atdhe i dashur ti je sot.*

Filluan duartrokitjet të ulta, të lehta, si të trembura, por që vazhduan gjatë.

- Poezia e dytë titullohet "Sot Jam I Shqetësuar":

*Jam zemërgjerë si dielli,
që ngroh të mirin dhe të ligun.
Jam gëzimplotë si natyra,
që çdo gjë rrit dhe përtërin.
Kështu si jam shoh jetën,
që armatoset me lirinë në duar,
Shoh ëndrrat e shekujve,
që janë zgjuar,
shoh ditët e pabindura,
që na afrojnë drejt qëllimit
dhe jam i shqetësuar:
A do të mund t'ia ngre
këngën më të bukur Botës së Re?!*

Studenti përsëri u duartrokit dhe u ul. U ngrit prapë dramaturgu Lazër Nikolla, i cili tha:

- Visar Zhitin e kam njohur në burg. Më gjeti atje, e lashë atje, në atë ferr të vërtetë. E arrestuan dhe e dënuan vetëm pse kishte botuar një libër modest. Tani ka dalë nga burgu, punon si punëtor në Lushnje. Shkova dhe e takova, u tregua bujar duke më

dhënë tri poezi. "Edhe po më arrestuan prapë, më tha, nuk besoj të vuaj më shumë nga ç'kam vuajtur". Poezitë e tij, të cilat i shkruante në kushte tepër të vështira, na bënin përshtypje të gjithëve, na dukej se duke i lexuar ato edhe ne shprehnim një pjesë të mllefrit tonë. I kemi mbrojtur ato poezi si shpirtin tonë, si dritën e syve. Ku nuk i ruanim: në kashtën e dyshekut, pranë pargjeve me mineral, në gropat e hapura në faqet e galerive... Poeti mezi mundi t'i nxirrte jashtë burgut, një fat i madh për të dhe poezinë tonë të vërtetë...

Doli një studente e cila, nën dritën e qirinjve që i afruan, filloi:

- Poezia e parë, - tha ajo, - titullohet "Burgu i Vogël, Burgu i Madh".

*I njeh ata dy vëllezër në burg?
Ka dhe tre vëllezër
dhe atë e bir.*

*Janë dhe nipi me gjyshin në burg,
vjehrrin me dhëndërin,
burri me të shoqen
(në burgun e grave dergjet dashuria e tij
me flokët e prera shkurt
si një shpend i zi
që ia shkurtojnë krahët për të mos fluturuar).*

*Është edhe një familje në burg,
më shumë se një shekull janë dënuar
të gjithë së bashku.*

*I gjithë atdheu ynë është burg
i thurur me tela me gjëmba.
3000 vjet i dënuar. Para Krishtit.
Burgu ynë është i vogël;
në barkun e burgut të madh
ndjehet si këlyshi në xhepin e kangurit
të dhunës.*

*Mund të dëshpërohesh,
por qëndro i fortë!*

Poezia u duartrokit. Kur duartrokitjet pushuan, vajza vazhdoi:
- Poezia tjetër, - tha ajo, - titullohet "Të Sëmurët".

*Të burgosurit
që u kthyen nga spitali
janë më të bardhë se ne.*

*Sa keq i vjen borës
kur sheh veten e saj në ato fytyra të braktisura,
kthen kokën mënjanë
dhe qan
si një njerke e mirë.*

*Prangat,
megjithëse me çelës mbyllur,
të shtrënguara,
u bien vetvetiu
nga krahët e holluara.*

Ehe kjo poezi u duartrokit. Në sallë vazhdonin dënesa të mbytura, psherëtima e ndonjë rënkim i lehtë. Me siguri disa nga pjesëmarrësit do të kishin ndonjë të dashurin e tyre në burg.
- Poezia e fundit titullohet "Rileximi i Don Kishotit".

*Ti, ti
hidalgo i mirë dhe i marrë,
ç'bëje ashtu?
Kacafyteshe me mullinjtë e erës
duke i ditur gjigandë.*

*Kthej fletët e librit
që fëshfërijnë si një buzëqeshje e fshehtë.*

*Edhe unë donkishotërisht
u talla me shtetin
si me mullinjtë e erës.
Krahët e tij më kapën
dhe as vetë s'e di ku do të më hedhin.
Dhe e dija që shteti s'është mulli ere,*

megjithëse bluan përditë kocka dëshirash.

Mjaft!

A do të shkruhen këto ndonjë ditë?

Të vijë një Servantes,

të cilit Mesjeta ia la të paktën një dorë,

një Servantes sakat

se duart e shkrimatarëve të realizmit socialist

i ka grumbulluar shteti

si kazma e lopata

që të hapë llogore për të ruajtur veten.

Don Kishoti tallet me ne

dhe qan në heshtje.

Edhe kjo poezi u duartrokit dhe vajza u ul.

U ngrit përsëri Xhezairi, i cili tha se radhën, sipas programit, e kishte një njohje e shkurtër me shkrimtarin anglez Xhejms Oruell, autorin e romanit të famshëm "1984" të shkruar qysh në vitin 1949.

U ngrit një djalë i ri simpatik, student i dramës, me një tufë letrash në dorë.

- Oruelli, - tha ai, - nuk ka jetuar në një vend diktatorial, e megjithatë romani i tij është një kryevepër përse i takon analizës artistike që i bëhet një sistemi të tillë. Ka marrë pjesë në Luftën e Spanjës i përfshirë nga vrulli romantik i utopisë komuniste por që shpejt e kuptoi falsitetin e saj. Për romanin në fjalë ka të ngjarë ta ketë marrë impulsin nga realiteti stalinist në Bashkimin Sovjetik, ndonëse vetë nuk jetonte në të. Megjithatë struktura e romanit është aq e pasur me detaje, sa të duket sikur autori ka jetuar vetë në një diktaturë të tillë. Paralelet që ai heq midis jetës së njerëzve në diktaturën e romanit të tij me atë të njerëzve në diktaturat reale janë jashtëzakonisht të ngjashme. Për këtë do të bindeni kur të dëgjoni fragmentin që kemi përkthyer.

Dy vajza i qëndruan anash, me qirinjë në duar, dhe djali filloi të lexonte. Qe vërtet në fragmant që më mrekulloi, si të qe shkruar për tek ne. Bëhej fjalë sesi Partia kishte punuar në atë mënyrë që anëtarët e vet të deseksualizoheshin, të kishin neveri për dashurinë, pra ta çrrënjosnin nga njeriu këtë ndjenjë të bukur e sublime. Në të përmendej Partia e Brendshme, ose Komiteti Qendror (kasta e të privilegjuarve), Bashkimi i Rinisë, si armë e bindur e

Partisë, aparatet e përgjimit, spiunët, të edukuar që në fëmijëri në Organizatën e Spiunëve të Vegjël, si dhe mendimet heretike apo mendikrimet, siç i quan autori. Po përmend vetëm disa fjali të shkëputura, të cilat më bënë më shumë përshtypje:

"Urrejta për seksin u që injektuar aq thellë, sa edhe besnikëria ndaj Partisë. Me anë të krijimit të kushteve që në fëmijëri, me anë të lojrave të ndryshme në ujë të ftohtë, me anë të gjepurave që u servirnin në shkollë, në Organizatën e Spiunëve apo Bashkimin e Rinisë, atyre u që hequr çdo lloj ndjenje e natyrshme..."

Të mahniste edhe përshkrimi që i bënte autori së shoqes së heroit, Katerinës, e cila ishte prototipi i njeriut të ftohtë, të akullt, të krijuar nga Partia: kurrfarë feminiteti, kurrfarë natyrshmërie dhe ngrohtësie ndjenje por vetëm ngurtësi, parime, slogane. Njerëz të neveritshëm, që edhe tek ne të rrethonin nga çdo anë. Që edhe kur flisnin e kishin humbur natyrshmërinë, pasi përdornin *newspeak*-un, një gjuhë e fabrikuar nga Partia e që konsistonte në reduktimin e fjalorit vetëm në nocionet më të domosdoshme për të shprehur ideologjinë e Partisë dhe që eliminonte në maksimum mundësinë e të menduarit në kundërshtim me vijën e saj. Njerëz si Ilir Karaj dhe Miranda Kolluri të klasës sime, thashë me vete.

Kur studenti e mbaroi së lexuari fragmentin vendosa të bëja çmos ta gjeja dorëshkrimin e atij romani (të përkthyer në shqip) për ta lexuar.

Pasi mbaroi njohja me Oruellin u ngrit një mesoburrë, i cili foli për një nga artistët më të përndjekur nga diktatura, për shkrimtarin Petro Marko. Ai tha se këtij shkrimtari i kishin bërë ftesë të veçantë, por nuk mund të vinte dot se ishte i sëmurë dhe se, nga ana e tij, i dërgonte përshëndetje të ngrohta auditorit.

- Diktatura është nervozuar disa herë me këtë shkrimtar të madh pothuaj pas çdo vepre që botonte, - tha oratori. - Një nga kulmet e nervozizmit ka qenë pikërisht pas botimit të romanit "Një Emër në Katër Rrugë", roman që e akuzuan për pornografi dhe, ndonëse romani bënte fjalë për një periudhë të kaluar, edhe për aluzion të hapët ndaj diktaturës së kohës sonë. Romani, gjithashtu, u akuzua se kishte përlyer Institutin Femëror të Tiranës, ku xhandarët zgjidhnin vajza nga ky Institut dhe ia dërgonin mbretit të bënte dashuri me to.

Oratori vazhdoi të fliste mbi vepra të tjera të këtij shkrimtari duke u ndalur te mjaft poezi të tij si dhe te drama "Niku i Martin

Gjinit", ku diktaturës i kishte djegur aluzioni se djemtë e udhëheqjes ishin imoralë, siç ishin në të vërtetë. Në fund ai recitoi poezinë "Loti i Fundit" nga cikli "Lot mërgimtari" të shkruar që më 1934:

*Rrokullisu me pahirë
në fytyrën tharë - petë
se kjo botë jetënxirë
s'të merr vesh o mor i shkretë!
Rrokullisu edhe lag
për të fundit herë o lot
se ndë rrugë ngrite varg
këngësh që nuk ndihen sot!*

Pas oratorisë për Petro Markon djem e vajza të reja, studentë të dramës, recituan poezi nga poetë të huaj të ndaluar. Poezinë "Vajzë" nga Ezra Paundi e recitoi një djalë.

*Pema më depërtoi në duar,
Limfa e saj më zbriti në krahë...
Pema m'u rrit në gjoks,
Degët e saj të thella
Shpërthejnë prej meje si krahë.*

*Ti je pema,
Ti je myshku,
Je lulevjollca që e merr era,
Krijesë aq e lartë ti je,
Sa dukesh si marrëzi për botën.*

Pas saj u recitua poezia "Muret" e Kavafisit, që ma kishte recituar edhe Selma, por që aty mësova disa hollësi për të, si fjala vjen se e kishte përkthyer Kadareja dhe se qe e botuar në një vëllim qysh përpara disa vjetësh. Edhe pse e njihja, prapë më mahniti. O zot ç'poezi që është! Çudi si i kishte shpëtuar syrit të censurës.

Një vajzë do të recitonte dy poezi të shkurtra nga Niçeja. Kur ajo përmendi emrin e këtij filozofi, më përshkoi një valë tmerri: vërtet do të recitoheshin poezi të tij? M'u bë se posa të fillonte, dikush do të ngrinte pushkën e do ta vriste në vend atë vajzë, aq i

papranueshëm ishte bërë ai emër për ndërgjegjen time. Por vajza, fare e qetë, tha titullin e poezisë së parë - " I Patrembur" - dhe filloi të recitonte me një zë të ngrohtë, të ëmbël:

*Aty ku je gropo thellë!
Poshtë është burimi!
Le të bërtasin njerëzit e kthjellë
"Poshtë është Ferri"!*

Poezia e dytë titullohej "Vade Mecum-Vade Tecum":

*Të ngashënejnë arti dhe gjuha ime?
Më ndjek, më vjen pas në mundime?
Veç veten tënde ndiq ti me besë,
Kështu më ndjek dhe mua. Ec, ec!*

Të dyja poezitë përmbanin mendime të thella. U recituan edhe poezi nga Jevtushenkoja dhe Salvadore Kuazimodo, por kopjet e tyre nuk munda t'i gjeja. Në fund Xhezairi tha se kush kishte ndonjë poezi të vetën, mund të ngrihej ta recitonte. U ngrit ajo vajza bukuroshe e cila, teksa kaloi pranë meje, më hodhi përsëri një vështrim të ngrohtë. Poezia e saj titullohej "S'Është Koha".

*Jo, s'është koha, e dashur
Për piknikë në lëndina të gjelbra,
S'është koha për të mbledhur lule,
Për të stolisur flokët me diadema.*

*E dashur, është kohë tjetër.
Është koha për t'i mbledhur lëndinat dhe për t'i palosur
si shami,*

*Thellë në xhepat e zemrës,
(Atje brenda le t'i çelin ato
Lulet e ëndrrave.)*

*Është koha që mjegullat dhe vesën e ndritshme,
Dhe lotët që pikojnë kristal
T'i fusim në pusët e kujtesës.
E di, do të na shqyhet gjoksi nga malli...*

*Veç nesër do t'i shtrydhim përsëri
Mbi ballin e së ardhmes,
Që do të çeli e freskët, si lule gjaku.*

*Mos më kërko, e dashur, lëndina dhe blerim.
Shtrihu, në vend të tyre, në ëndrrën time dhe tënden.
Blerimi dhe lulja dhe drita dhe ajri tani pikojnë gjak.
Prit, e dashur, sa të çelin këngët.
Prit dhe pak.*

Kur vajza u ul iu luta të më jepte një kopje të poezisë dhe ma dha. I buzëqesha gjithë mirënjohje.

- Tani, me volum të ulur, do të dëgjojmë këngën "The Wind of Change" - tha Xhezairi. - Mund ta luanim edhe me instrumente, por sado ulët të luash, përsëri nga jashtë dëgjoresh.

Ai shtypi një buton dhe ja ku nisi të dëgjoj melodia e mrekullueshme e kësaj kënge nga grupi që unë e doja aq shumë, "Skorpions"-at. Kur kënga mbaroi, Xhezairi kumtoi se mbrëmja mori fund. U shuan qirinjtë, u ndezën dritat dhe mua m'u duk se u ktheva në realitetin e zakonshëm pas një ëndrre në një botë të bukur e të mistershme. Pata rastin t'i buzëqeshja edhe një herë asaj vajzës simpatike, e cila ma ktheu po ashtu. Nuk m'u dha ta pyesja për emrin, dhe më erdhi keq që s'ia mësova dot kurrë, pasi nuk do ta shihja më: kjo mbrëmje do të ishte e fundit në serinë e tyre, pasi më vonë ato u ndaluan, dhe Xhezairi do të kalonte telashe të mëdha.

16

Xhezairi, daja dhe unë dolëm në fundit. Në rrugë bënte freskët.

- S'i t'u duk? - më pyeti Xhezairi.

- E mrekullueshme... - thashë me zjarr. - Kurrë nuk mund ta kisha përfytyruar se do të ishte një gjë aq e bukur.

- Në shkollën tuaj nuk mund të organizoni të tilla? - më pyeti.

- Ah, jo. Kemi ca spiunë atje, që...

- Ke të drejtë, - tha pas pak. - Edhe këtyre që bëjmë ne kam frikë se do t'u dali tymi shpejt. Megjithatë do të vazhdojmë sa të mundemi. Po na i ndaluan, dhe po dola pa u lagur, kam ndërmend të vë në skenë një pjesë teatrale të fortë.

- Cilën? - e pyeti daja.

- Kam disa variante. Më tërheq jashtëzakonisht "Duart e Ndyta" të Sartrit. Veç nuk di sa do të arrij të bind ca idiotë të Institutit, jo për pjesën, se jam i sigurt që mendja e tyre e ngushtë nuk do të arrijë t'i gjejë ndonjë gjë të gabuar, po për emrin e Sartrit. Gjithë puna është se emri i tij i tmerron.

- Vërtet, Xhezo: u ke besim të gjithëve sa vijnë aty?

- Tek ata nuk kam fare frikë, po gjithë puna është se kujt u tregojnë për këto mbrëmje... Le të vejë si të vejë, nuk do të ndalem. Koli, protesta ka filluar nga të gjitha anët, dhe mendja e diktaturës nuk është më e përqendruar si më parë. E kam të qartë se kjo s'do të thotë se dhe ne nuk do të vihem në shenjë...

- Unë e kam filluar protestën me një formë akoma më fillestare, - tha daja si me të qeshur, - duke i bërë pyetjen vetes: "A jam unë në rregull dhe gjithë të tjerët të çmendur, apo unë i çmendur dhe gjithë të tjerët në rregull?" Është protesta e parë e drejtuar kundrejt sistemit, por e pasigurt, gjithë dyshime, pasi është mundim ferri të depërtosh në maskat që njerëzit detyrohen të vënë në fytyrë.

- Dëgjo ç'kam lexuar te një shkrimtar disident lindor - tha Xhezairi. - "Gjithsecili e ndjente veten të futur në një gropë, por pa e ditur që edhe tjetri, edhe miliona të tjerë e ndjenin veten po ashtu. Uji nëntokësor filloi të ngrihej e të ngrihej derisa secili u detyrua të dilte nga gropa. Dhe të gjithë u habitën kur panë se kishin patur të njëjtin fat, se më kot secili kishte pandehur se vetëm ai kishte qenë i fundosur në gropë..."

- Kështu ai e përjashton apo e ligjëson fajin kolektiv? - pyeti daja.

- Më duket se e ligjëson. Vërtet secili shikon veten si viktimë, por përgjegjësia për këtë bie tek të gjithë. Megjithëse problemi nuk është kaq i thjeshtë, pasi për mua nuk ka faj kolektiv.

Unë duhej të isha ndarë me ta që në kryqëzimin e parë, por i tërhequr nga biseda vazhdova deri tek ura pranë hotel "Dajtit". Aty u zgjata dorën, në fillim Xhezairit, pastaj dajës.

- Mirton, javën tjetër do të bëjmë një tjetër mbrëmje si kjo. Po qe se do të vish, do të të them se kur do ta lëmë për të bërë mësim, dakord?

I thashë se do të shkoja patjetër, se sonte isha kënaqur pa masë, gjë që ishte e vërtetë. Daja më pyeti si i kisha hallet, duke mos munguar të më jepte dhe ndonjë këshillë, siç e kishte zakon.

Ndërsa i afrohesha shtëpisë pashë orën, po shkonte nëntë. Në

kohën që mora rrugicën për në shtëpi m'u kujtua ftesa që më kishte bërë Arditi dhe mbeta në vend. Shtëpia e tij ishte dy hapa larg, po a mund të shkoja kaq vonë? Ai më kishte thënë për në orën tetë. Ta zëmë se vonesa s'prishte punë, po kur do të arrija në shtëpi? Nuk dija ç'të bëja, luftoja me vete pa marrë dot asnjë vendim. Po shkoj, i dhashë karar më së fundi. Do të rri ndonjë gjysmë ore, jo më shumë. Në shtëpi do t'u këpusja ndonjë rrenë, do t'u thosha se kisha takuar dajën dhe isha vonuar me të, gjë që përmbante vetëm një grimcë së vërtete, por po të vinte puna mund të kapesha pas saj. Kështu, dy minuta më vonë trokita te shtëpia-barakë e Ardimit.

- Po ç'u bëre! - më tha. - Kujtova se s'do vije. Eja.

- Kush është tjetër? - e pyeta.

- Do ta marrësh vesh, po eja, - më tha duke më tërhequr nga krahu e duke më shkelur syrin. Nuk dukej më i nxirë e i murrëtyer siç më qe dukur para disa orësh, kur ishim takuar, përkundrazi ishte gjithë gjallëri e humor.

Unë e kam bezdi të jem në shoqërinë e njerëzve që s'i njoh. Që kur e kishin përjashtuar nga shkolla, Arditi e kishte zgjeruar rrethin të njohurve. E shikoja edhe me çapaçula, me ata që merreshin me lloto të fshehta apo kontrabandë. Me ç'dukej s'kishte nga ia mbante, tek ata do të përplasej.

Sapo hyra në kuzhinë gjëja e parë që më ra në sy ishin mysafirët e Ardimit, dy vajza të reja, të ulura në tryezë, me gotat e pijes përpara. Njëra ishte një bjonde mjaft e bukur, me flokë të gjatë, të drejtë, të lëshuar supeve dhe e veshur me mjaft finesë, kurse tjetra një brune që mund ta quaje simpatike po të mos kishte një pamje disi të ashpër. Kur hyra ato u çuan në këmbë.

- Ja gallofi që prisnim, - u tha Arditi me të qeshur. - Thoni të drejtën, nuk i ngjan Alen Delonit?

E ndjeva veten ngushtë nga këto profka.

- Kjo është Mira, - më prezantoi me bjonden, - kurse kjo Margita. Janë vajza të mira, mos ki frikë, - vazhdoi duke i bërë vajzat të kukurisnin. - Dhe tani ulu, - më tha me ton urdhërues - se na bëre t'i mbajmë sytë nga dera!

U ula dhe i hodha një sy tryezës. Qe mbushur me shishe të hapura, me ëmbëlsira, arra të qëruara, portokalle e ku di unë. Mbi një komodinë qe vendosur një magnetofon me bokse të mëdhenj, nga ku përhapej një muzikë ritmike. Arditi i ngriti volumin dhe dhoma buçiti. Hodha si padashur sytë nga bjondja, edhe ajo po më shikonte. Ishte nga ato tipe vajzash që të hanë me sy, si i thonë

një fjale. Nga dreqin e paska psonisur Ardit zullapi, mendova. E dija që për vajzat kishte shije, po që t'i binin në dorë edhe bukuri si kjo më çudiste ca. Dhe dukej e ndjente, garipi, që bjondja më kishte bërë vërtet përshtypje, se dukej i krekosur e shend e verë, me atë fytyrën esmere, si të Alberto Sordit, të mbushur me një buzëqeshje vesh më vesh.

- Ju goca mos u druani nga ky legen, - vazhdoi me të folurën e tij pak si zdrënkthi, me të cilën qeshë mësuar prej kohe. - Mos kujtoni se është nga ata që i bëjnë vajzat të marrosen pas tij.

- Mua po më duket pikërisht ashtu! - tha Mira, bjondja, me një buzëqeshje prej çapkëneje.

- Mos u nxito në gjykim, bukuroshe! - ia ktheu Arditi duke më mbushur një gotë verë nga një shishe ku lexohej "Kabërnë". Pastaj të gjithë ngritëm gotat. Vera ishte e mirë, po mua më ra në kokë menjëherë.

- Që ta dish edhe ti, - m'u drejtua Arditi, - programin e kemi të thjeshtë: do të hamë e do të pimë, po dhe do të kërcejmë. Dakord?

- Dakord që ç'ke me të! - ia ktheva unë me një gaz të vrullshëm e duke ndier në thellësi të stomakut një nxehtësi të këndshme, që sikur po më ngjitej deri në tru. Kjo është shkalla e parë e dehjes tek unë, pas saj vjen euforia e papërmbajtur e në fund të qarët. Vajzat pinin nga pak, duke çuçuritur ndonjë fjalë me njëra tjetrën. Pas gotës së dytë u bëra më i gjallë, sendet më dukeshin më të ndritshme, kurse zërat si krisma. Me sa dukej po hyja në fazën e dytë.

- E di pse ia shtrova sot? - më pyeti Arditi. - E merr me mend, bebush? - Dhe më nguli syrin e mavijosur, mbi të cilin, afër ballit, i kishin vënë manikoton prej lejkoplasti.

Kur dëgjua fjalën "bebush" vajzat ia dhanë të qeshurit me të madhe.

- Ej, boll, - u tha Arditi. - Nuk e merr me mend, Toni? Po mbrëmë kam marrë pjesë në ngjarjen më të madhe të jetës sime, mor gallof! Dhe kam shpëtuar për një qime... Nuk duhet festuar?

Na vështroi me radhë, në fillim mua, pastaj vajzat. Me siguri në sytë e tyre kishte filluar të dukej si hero, dhe të thuash të drejtën, e meritonte atë cilësim.

- Ardit, - e pyeti Margita, - ke dëgjuar ti të flitet se do të hapen ambasadat?

Mbeta i shtangur nga ato fjalë.

- Si do të hapen? - pyeta me një frymë.

- Për të hyrë kush të dojë. Pastaj do t'i çojnë me anije në secilin vend dhe do t'i futin në punë.

- Përralla! - tha Mira. - Vërtet i besoni këto? Sikur s'e dini që për vëllezërit Popaj u bë nami... apo s'qëndruan disa vjet në ambasadën italiane.

- Nuk i dihet, Mira, edhe mundet, - tha Arditi mendueshëm. - Thonë se do të hapet edhe kufiri me Greqinë.

- Ashtu? - u habit Margita. - Këtë s'e kisha dëgjuar.

- Giti, po janë ëndrra moj, nuk e kupton? - vazhdoi Mira. - Si u hapkan kufijtë dhe ambasadat? Këta të shtypin kokën, jo më të lejojnë të tilla gjëra... Sikur s'e more vesh ç'u bë dje tek sheshi!

- Vajza, e dini ç'keni? A nuk i lëmë këto dhe kërcejmë?

- Ti the se do të sillje një shok gazmor, - tha Mira për mua me shpoti. - Kurse ky qenka memec!

- Këto shoqet nga i kemi? - pyeta unë si për t'u mbrojtur nga sulmi i saj duke e parë, ndërkohë, drejt e në sy. - Se vetëm emrat na the.

- Së pari drejtoi me "zonjushe", i dashur profesor! - ma ktheu Arditi gazmor. - Boll me shoqe e shokë, lëri për në mbledhjet e Rinisë. - Ai heshti një grimë dhe vazhdoi: - Giti është fatorino urbani, - tha për brunen. - Kurse Mira shitëse në një kinkaleri, pa ndonjë pare të madhe.

- Ty s'të jam qarë, - tha Mira me ton shakaje duke mbajtur hijshëm, midis gishtave të gjatë me manikyrë, gotën e verës. - Punë është edhe ajo.

- Çdo punë është e nderuar, - ia këputa unë, pa e ditur aspak se që të tre do t'ia këpusnin gazit me të madhe.

- Ky na qenka kandidat për fillozof! - tha Margita duke vazhduar të qeshte.

- Mirë, mirë, e gjykoni pak më vonë, - tha Arditi, - po eja të kërcejmë.

E kapi nga dora dhe e tërhoqi. Kuptohej që Mira do të kërcente me mua, gjë që më kënaqi. Me siguri Arditi ma kishte lënë vetë. Ishte aq xhentil, dreqi, sa s'ia gjeje shokun.

Mira s'pritti ta ftoja, po u ngrit duke rregulluar bluzën dhe fundin. O zot, vajzë që të kërcente më bukur s'kisha ndeshur. E lehtë si flutur, e lakueshme dhe e epshme si ta kishte trupin prej llastiku. S'kishte nevojë ta drejtoje, vinte vetë pas teje, një

dreq e di si e ndiente. Apo s'të ngjishej duke të të mbushur me një kundërmim të këndshëm, si të ndodheshe midis degëve plot me lule. Në një çast u shkëput nga unë e nisi të kërcente në qejf të vet, me një hijeshi që të linte pa mend.

Vazhdova dhe unë të kërceja si ajo. O zot, kur gjej një partnere tamam siç duhet unë çmendem për të kërcyer. Ajo u ngjit sërish me mua dhe me ç'duket s'e interesonte shumë vallzimi, se më pyeti:

- Bëni mbrëmje vallzimi në shkollë?

- Ne maturantët fare, kemi hallin e mësimeve. Dëgjo, ku njihesh me Arditin?

- Pyet atë, - tha me një buzëqeshje enigmatike.

- Me siguri e ka tërhequr portreti yt, - i thashë. - Je krejt e veçantë, e denjë për top model...

- Për çfarë?

- Për top model, për reklamë veshjesh, për të dalë nëpër revista.

- Ej, çuno, po fluturon si shumë... Të kishin krahë ëndrrat ku do të më kishe çuar?

- Në fund të botës! - i thashë me zjarr. I dashur, pija po më zinte gjithnjë e më shumë. - Ku të dëshiroje ti!... - Këto fjalë ia bërtita mu tek veshi. - Ç'do të doje tjetër?

- Të çlodhesha pak, - tha ajo. - Sepse sot kam shitur një kamion të tërë me pluhur larës. Vdiqa. Le njerëzit e mjerë, u vranë e u dërrmuan...

M'u përfytyrua rrëmuja e zakonshme kur dilte në shitje pluhur larës, vezë, djathë. Eh, të gjorët njerëz...

- Ç'degë do të marrësh? - më pyeti.

- Them të bëhem veteriner, - ia këputa.

Muzika buçiste si dreqi, dhe ajo s'më dëgjoi.

- Çfarë? - më pyeti duke ma ngjitur gojën fare pranë simes.

- Veteriner! - i bërtita te veshi. - Doktor kafshësh!

Ajo qeshi.

- S'do bëke keq, - më tha, - se anëtarët e Partisë janë shtuar shumë. Dhe me ç'kam dëgjuar shumica vuajnë nga stomaku, mëlçia, veshkat... po dhe nga ndonjë sëmundje që nuk rrëfëhet.

Kur dëgjova fjalët e fundit qesha me të madhe. Kur më kaloi kriza e parë ia hodha përsëri duart dhe rifilluam kërcimin, por ende vazhdoja të qeshja.

- Qenke dreqi vetë! - i thashë me simpati të singertë. - Qenka e vërtetë që ne, shkollarët, nuk i njohim njerëzit e thjeshtë të

popullit...

- Çudi, se lëndë kryesore keni veprat e xhaxhit, - tha ajo krejt natyrshëm. - Me sa di unë ai në çdo faqe për ne flet, njerëzit e thjeshtë.

I shtrëngova dorën dhe i buzëqesha pa e fshehur admirimin që po ndieja për mendjemprehtësinë e saj. Arditi me Margitën u ulën, u ulëm edhe ne, pëmë pak dhe u ngritëm të kërcenim përsëri, këtë radhë duke ndërruar damat. Margita qe e tmerrshme, nuk kombinoja fare. Me atë trupin topolak u ngjesh fort pas meje, sa praktikisht më pengonte të hidhja këmbët, që i kam mjaft të gjata. O zot, damë më beterr për të kërcyer s'kisha parë kurrë. Ç'priste ajo, ta ngrija peshë si thes? U mbusha me djersë nga sikleti, me siguri i lashë përshtypjen se s'merrja erë nga kërcimi. Megjithatë bëra ç'munda që ta rregulloja hapin, le ta merrte ajo drejtimin, dhe u lumturova kur m'u shkëput për të kërcyer më vete, përballë meje. Më në fund, të djersitur e duke diatur, u ulëm e pas nesh u ulën edhe Arditi me Mirën.

Filluam përsëri të hanim e të pinin, duke bërë shakara e duke qeshur.

Dhoma dhe gjithçka më vinte rrotull. Ishte koha kur duhet ta ndaloja të pirët, ndryshe do të bëhesha tapë. Një mendje më thoshte të mos shkoja fare në shtëpi. Kot thosha ashtu, se e dija që do të shkoja edhe tapë të isha, përndryshe prindërit do të alarmoheshin, do të alarmonin edhe të tjerët.

Arditi me Margitën u ngritën dhe u drejtuan nga dera. Unë s'ua ndava vështrimin, duke i parë me habi.

- S'e ndien veten mirë, - më tha Arditi për Margitën, - po e çoj të freskohet pak.

Mbeta vetëm me Mirën. Ajo hoqi karficën dhe zuri të rregullonte flokët. Pastaj me një lëvizje të shpejtë u sul tek unë dhe më vuri duart mbi supe. S'pata kohë të tërhiqesha, se brenda një sekode fytyra e saj u ngjesh pas simes. Në buzë ndjeva një shije të lagët - po më puthte.

- Ç'rri si hu? - më tha dhe më puthi përsëri. - Lëviz! - dhe m'u lëshua e tëra, duke zbërthyer bluzën. Pashë një pjesë të gjinjve të saj, të bardhë e të bukur sa të merrnin sytë.

Mirëpo çdo gjë ndodhi aq papritur sa e humba krejt. Për më tepër që ishte hera e parë që më ndodhte një gjë e tillë - mundësia për të bërë dashuri pa u lodhur fare për ta gjetur, duke të ardhur vetë në dorë. Gjithnjë kisha pasur bindjen se të arrije deri këtu me një

femër dukej të rropateshe me javë e mbase me muaj të tërë. Kurse tani çdo gjë po më nderej përpara sa hap e mbyll sytë. Deri më atë kohë s'kisha prekur buzë femre. Më parë kisha patur rastin të puthja Selmën - një herë në klasë, kur ishte larguar mësuesi i fizkulturës, dhe një herë tjetër në plazh, kur ishim kthyer nga kinemaja - por nuk kisha guxuar. Kurse tani e puthura kishte ndodhur, veçse në kahun e kundërt - nuk e kisha dhënë, ma kishin dhënë. Dhe me pasion, thujse me tërbim, vetëm që unë s'kisha ndier asgjë. Ose më mirë kisha ndier vetëm fytyrën e nxehtë të Mirës ngjeshur pas fytyrës sime dhe fjalët e saj të shqiptuara shpejt e shpejt, me pëshpërimë:

- Hajde, pra...

Duke më tërhequr me vrull nga dora më çoi te divani ku, pa m'u ndarë, po duke më tërhequr me të dyja duart, u shtri duke ngritur fustanin deri në rrëzë të kofshëve. O zot, ç'kofshë të bukura që kishte!

- Ec! - më tha përsëri, e skuqur a nga epshi a nga inati që s'po reagoja. - Nuk ke shkuar ndonjëherë me ndonjë vajzë?

I turbulluar, si idiot, bëra një përpjekje të shkëputesha prej saj. Mendja më vinte rrotull dhe ndonëse ajo seksualisht më tërhiqte, aq sa ndjeja një si zjarr të më ngrihej duke më përshkuar të gjithë trupin, përsëri u përmbajta dhe iu shkëputa gati me forcë. Nuk e di pse drejtin kam frikë nga ca gjëra që më vijnë krejt papritur. Ajo më pa si e topitur, gjithnjë me fustanin të ngritur deri në mes.

- Ç'ke? Nuk je djalë?!

- Jo, po... Po sikur? Po ata?... - bërbëlita unë për Arditin me Margitën.

- Edhe ata për këtë punë shkuan, budalla... Eja.

- Më fal, po...

Në tru më vetëtiu alarmi i babait, që mund të ishte kthyer në shtëpi prej kohe, por dhe i mamasë, që mund të qe kthyer tani. Ata alarmoheshin edhe për vonesa më të vogla.

- Më fal, por duhet të iki. Do të kisha ndënjur me gjithë qejf, po kam ikur që në mëngjes nga shtëpia, dhe...

Ç'pamje të fyer që mori, i dashur! Uli fustanin, rregulloi bluzën te gjoksi i hapur e pastaj flokët, duke thënë:

- Shko, se të pret mamaja! Buzëqumësht!

Mezi qëndroja në këmbë, aq shumë më mirreshin mendtë. Kërkoja me sy xhakoventon, që drejti e di nga qe hedhur. Ajo e gjeti dhe ma

zgjati, madje më ndihmoi që ta vishja, se njëri krah s'hynte që s'hynte në mëngë.

- Sidoqoftë do të takohemi, apo jo?

Më përkëdheli në faqe dhe u ngjesh përsëri tek unë, gati t'ia plaste të qarit, nuk e di pse.

- Patjetër, - i thashë me nxitim. - Pse jo? - Dhe dola në korridor. Nga dera e dhomës tjetër bëri ballë Arditi, që siç duket kishte dëgjuar zhurmë. Më shikoi me habi.

- Ç'pate? Pse po ikën?

- Shkoi vonë, Ardit. Nuk...

- Qenke fare idiot! Ku do ta gjesh më një rast si ky?!

- E kuptoj, po... Ç'do t'u them në shtëpi? Jo se ajo nuk më pëlqeu, singerisht ta them, po... këto gjëra... Nuk ndihem as mirë... - Qeshë vërtet si më tym, s'lidhja dot fjalët e, ç'ishte më e keqja, më vinte për të vjellë. Më vinte aq shumë sa rrezik të nxirrja zorrët mu aty, në korridor.

- Po deshe fli këtu, ç'thua?

- Jo, Ardit, nuk mundem.

- Dëgjo, do të vish nesër në Durrës? Me motor.

- Jo. Po shkolla? - Bëra të ecja e për pak u rrëzova.

- U pordhe? Prit, se po të shoqëroj.

Hapi derën e jashtme e në çast ndjeva ajrin e ftohtë të më rrihte fytyrën dhe krahërorin. Më bëri mirë, se ma largoi disi ndjenjën e të vjellit.

- Bebush, rri sonte, nuk bëhet qameti!

- Jo, jo. Ika, Ardit, natën... natën e mirë.

Mezi i hidhja këmbët në oborr. Arditi më shoqëroi deri te porta duke më mbajtur për krahu. Unë sesi ktheva kokën dhe në katërkëndëshin e derës pashë siluetën e Mirës.

- Natën e mirë! - i thashë me zë të lartë, por nuk m'u përgjigj. I tunda dorën dhe vazhova të ecja. Arditi më shoqëroi deri jashtë portës, më tha të më shoqëronte deri në shtëpi, po nuk e lashë. S'ishte mirë t'i linte të dyja vajzat vetëm. Ai u kthye dhe mbylli portën, kurse unë vazhova të ecja duke u çapitur.